

**Republika e Serbisë**  
**Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Serbisë**

**DORACAK PËR MËSIMDHËNËS**

**EDUKATA QYTETARE**

**Për klasën e 3-të të shkollës së mesme**

**Beograd, 2011**

Udhëzuesin për mësimdhënës e kanë përgatitur dhe përshtatur për programin mësimor të Edukatës qytetare:

**Prof. dr Dragan Popadiq**

**Prof. dr Ilija Vujaçiq**

**Mr Danijela Petroviq**

**Milenko Dereta**

**Zagorka Aksentijeviq**

**Radmila Goshoviq**

**Marija Rudiq**

**Tanja Azanjac**

**Natasha Gjuriçiq**

**Vera Ociqд**

## Përmbajtja

1. ORA E HYRJES
2. Demokracia dhe vendosja demokratike
3. Jeta qytetare, politika dhe pushteti
4. Pushteti i përkufizuar
5. Ndarja e pushtetit
6. Nocioni qytetarë/qytetare
7. Qytetarët/qytetaret dhe respektimi i ligjeve (përgatitja për debat dhe debati)
8. Njohja me punën e pushtetit lokal dhe vetëqeverisjen (vizita në komunë)
9. Shoqëria qytetare dhe civile
10. Karakteristikat e shoqërisë civile
11. Raporti i shoqërisë civile dhe shtetit
12. Aktivizmi qytetar pro dhe kundër (përgatitja për debat dhe debati)
13. Supozimet e shoqërisë qytetare
14. Të drejtat e njeriut - 1
15. Të drejtat e njeriut - 2
16. Qytetarët e komunës time - 1
17. Qytetarët e komunës time - 2
18. Iniciativa qytetare
19. Iniciativa qytetare – formulimi
20. Iniciativa qytetare – prezantimi dhe analiza e punës nëpër grupe
21. Iniciativa qytetare - propozimi formal
22. Kuvendi – përgatitja për seancë
23. Kuvendi – seanca
24. Shoqatat e qytetarëve – e drejta për vetorganizim
25. Shoqatat e qytetarëve – njohja me punën e shoqatave lokale të qytetarëve
26. Planifikimi i aksionit lokal – zgjedhja e problemit
27. Planifikimi i aksionit lokal – hapat në planifikim
28. Planifikimi i aksionit lokal – grumbullimi i të dhënave, formulimi i problemit, i objektivave dhe detyrave
29. Planifikimi i aksionit lokal - plani i mbikëqyrjes dhe nota e suksesit
30. Planifikimi i aksionit lokal –përcaktimi i grupeve të fokusit, analiza e ambientit dhe ndërtimi i mbështetjes
31. Planifikimi i aksionit lokal – projektimi i mesazhit dhe përzgjedhja e kanalit të komunikimit
32. Planifikimi i aksionit lokal – grumbullimi i mjeteve dhe plani i aktiviteteve
33. Planifikimi i aksionit lokal –përgatitja për prezantim publik
34. Planifikimi i aksionit lokal – prezantimet publike në shkollë
35. ORA PËRFUNDIMTARE – ÇFARË BARTI ME VETE?

## Udhëzime për mësimdhënësit

Programi i “Edukatës qytetare 3” i cili në vitin shkollor 2003/4 e ka statusin e lëndës fakultative, është menduar si *vazhdim i natyrshëm* i dy programeve të mëparshme.

**EQ 1** merret me çështjet e natyrës dhe të mënyrës së rregullimit të raporteve në grup/bashkësi, me natyrën e qëndrimeve që kemi ndaj njerëzve dhe grupeve të tjera, mënyrat e shprehjes së mendimit vetjak dhe të komunikimit me njerëzit e tjerë. Ky program stërvit komunikimin pa dhunë dhe teknikat e zgjidhjes paqësore të konflikteve.

**EQ 2** i njeh nxënësit me fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtat e fëmijës dhe i përgatit e nxit ata si për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, ashtu edhe të tjerëve.

Programi i **EQ 3** i njeh nxënësit me të drejtat qytetare e politike dhe shfrytëzimin e tyre nga ana e qytetarëve, dhe i përgatit e nxit ata për participim politik dhe iniciativë qytetare.

**Metoda e punës.** Në programin e EQ 3, si dhe në programet e mëparshme, është zbatuar qasja e aktivitetit në punëtori, që mundëson participimin e nxënësve, aktivitetin e tyre dhe bashkëpunimin e të gjithë pjesëmarrësve në procesin e arsimit. Punëtoritë e EQ 3 gjithashtu janë skenar i përpunuar në hollësi për orët shkollore, objektivi i të cilave është t’u mundësojë nxënësve të fitojnë dijeni, të zhvillojnë shkathtësi dhe aftësi, të ndërtojnë qëndrime autonome.

Natyra e punëtorisë në EQ nuk është e njëjtë në të gjitha klasat. Derisa në klasën e parë punëtoritë janë të orientuara, para se gjithash në zhvillimin e shkathtësive sociale dhe mund të thuhet se në to theksi është në dimensionin efektiv të arsimit, në klasën e dytë objektivi tyre kryesor lëviz kah fitimi i dijenive dhe shkathtësive konkrete, që në klasën e tretë punëtoritë të marrin, para se gjithash, karakter kognitiv, me ç’ rast nuk është lënë anash dimensionin efektiv.

Pavarësisht nga këto dallime, të gjitha punëtoritë kanë një varg karakteristikash të përbashkëta (principet, strukturën, formën e punës).

“Edukata qytetare 3”, pra mbështetet në EQ 1 dhe EQ 2, por nga ato dallon për shkak të theksit të posaçëm në **dijeninë** që duhet ta fitojnë nxënësit. Është me rëndësi që mësimdhënësit të tregojnë kujdes pasi fjala është për përmbajtjen e ndërlikuar, të cilën nxënësit duhet ta pushtojnë në procedimin interaktiv dhe ta kuptojnë rëndësinë e saj në jetën e përditshme.

Ashtu si edhe në dy programet e mëparshme, edhe këtu Punëtorja është si formë e punës më e pranishme dhe është parashikuar shfrytëzimi më i shpeshtë të aktiviteteve të lojërave. Ajo që vazhdimisht duhet pasur parasysh, është se të tilla forma dhe teknika të punës nuk janë qëllim në vetvete, por janë në funksion të përfitimit dhe zhvillimit të dijenisë. Përveç kësaj, duhet pasur parasysh se nxënësve iu duhet mundësuar që të mendojnë çdo ditë rreth përmbajtjeve të përpunuara dhe të nxjerrin përfundimet e veta, gjatë të cilave do të “mësojnë” gradualisht përmbajtjen e caktuar apo lëndën mësimore. Në “Edukatën qytetare” nuk kërkohet nga nxënësit mbajtja në mend dhe riprodhimi i fakteve, as të zhvillohet shqyrtimi klasik i dijenisë. Nga nxënësit pritet që nëpërmjet punëtorive dhe në komunikim interaktiv të fitojnë dijeni lidhur me kuptimin e fenomeneve të rëndësishme, si bazë për zhvillimin e raportit aktiv dhe të përgjegjshëm ndaj dukurive shoqërore, të mbështetur në të drejtat e njeriut.

Programi i EQ 3 është konceptuar në mënyrë të tillë që nxënësit në gjysmëvjetorin e parë të fitojnë dijeni themelore mbi demokracinë, që në gjysmëvjetorin e dytë praktikisht të aftësohen për përgatitjet dhe zhvillimin e pavarur dhe sistematik të aksioneve qytetare, dhe në këtë mënyrë praktikisht të mësojnë çfarë është demokracia dhe si merret pjesë në të.

Arsimi/edukimi qytetar është i ndërlidhur ekskluzivisht me demokracinë dhe sistemin demokratik, sepse paraqet arsimimin që është në funksion të aftësimit të qytetarëve për të marrë rolin e **pjesëmarrësit** në jetën publike. Prandaj, fati i demokracisë në fund të fundit varet nga pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhjen dhe kontrollin e pushtetit. Atje ku nuk është kjo pjesëmarrje, institucionet dhe procedurat demokratike e humbin funksionin e vet, dhe bëhen vetëm gëzhgjë boshe apo fasadë prapa së cilës gradualisht vendoset sistemi jodemokratik, kurse vendimmarrja dhe drejtimi në shoqëri përqendrohet në duart e pakicës, e cila nis të sundojë arbitrarisht, duke mos përfillur kërkesat, nevojat dhe interesat e qytetarëve. Në sistemet e tilla arsimimi qytetar as që nevojitet, sepse atje individët nuk kanë rol aktiv në jetën publike.

Në këtë kuptim, tërësia e “Edukatës qytetare 3” ka të bëjë me arsimimin për **demokraci**, prandaj punëtoritë janë të organizuara në mënyrë që të sigurojnë fitimin gradual dhe paralel të dijenisë mbi demokracinë dhe të shkathtësive të nevojshme për pjesëmarrje në zhvillimin e demokracisë. Me një dinamikë të tillë të zotërimit të përmbajtjes, arrihet që nxënësit të “pushtojnë” gradualisht nocionet gjithnjë e më të ndërlikuara. Në punëtorinë e parë (“Demokracia dhe vendimmarrja demokratike”) jepet definicioni minimal i demokracisë, që nxënësit të kuptojnë rëndësinë elementare të rregullave dhe procedurave në demokraci. Pastaj, në punëtorinë tjetër (“Jeta qytetare, politika dhe pushteti”), gradualisht përpunohen nocionet, sqarimi i të cilave është i domosdoshëm që të kuptohet esenca dhe funksionimi i demokracisë. Pas kësaj kalohet në njohjen me institucionet themelore demokratike, mekanizmat e qeverisjes dhe me aktorët e demokracisë (punëtoritë “Pushteti i përkufizuar”, “Ndarja e pushtetit”, “Nocioni qytetar/qytetare” dhe Qytetari/qytetarja dhe respektimi i ligjit”). Është parashikuar edhe që nxënësit të njihen direkt me punën e vetëqeverisjes lokale, në mënyrë që me mësimdhënësin/ mësimdhënësen e Edukatës qytetare, do ta vizitojnë komunën dhe do të bisedojnë me përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale.

Në vazhdim të programit shqyrtohen nocionet, shpjegimi i të cilëve është i domosdoshëm për të kuptuar kushtet e gjëra shoqërore që lypset të kënaqën që demokracia të mund të ndikojë (“Shoqëria qytetare dhe civile”, “Karakteristikat e shoqërisë civile”, “Raporti i shoqërisë civile dhe shtetit”, dhe “Aktivizmi qytetar pro dhe kundër”). Pas këtyre, Punëtoria “Premisat e shoqërisë demokratike”, bënë rezyrenë e supozimeve, të institucioneve dhe principeve, të cilët demokracinë e bëjnë të mundshme dhe çojnë në zhvillimin e saj (sistemi shumëpartiak, sundimi i ligjit, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, ndarja e pushtetit, garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, zgjedhjet e lira e të ndershme, shoqëria e zhvilluar qytetare e civile, ekonomia e tregut, e tjetër). Ky rrumbullakim i të mësuarit më përpara, shërben njëkohësisht që nxënësve t’u vihet në pah rëndësia e gjerë e nocionit të demokracisë dhe në fakt se demokracia, krahas rregullave dhe procedurave elementare, nënkupton edhe shumë kushte dhe supozime të tjera, që duhet të ekzistojnë, që ajo të mund të funksionojë dhe të zhvillohet.

Në punëtoritë “Të drejtat e njeriut 1 e 2”, caktohet afërsisht nocioni i të drejtave të njeriut, vihet në pah rëndësia dhe universalizmi i tyre, nxënësit njihen me përmbajtjen e të drejtave të caktuara dhe nxiten që, në mjedisin e vet, të angazhohen për respektimin e të drejtave të njeriut. Me anë të punëtorisë “Qytetarët e komunës time 1 e 2”, nxënësit e shqyrtojnë sa janë të udhëzuar vetë në punën e komunës dhe gatishmërinë për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve ekzistuese shoqërore, e pastaj i anketojnë bashkëqytetarët e tyre, dhe në bazë të analizës së përgjigjeve të marra e shqyrtojnë shkallën e informimit dhe të aktivizmit të bashkëqytetarëve të tyre.

Gjashtë punëtoritë i janë kushtuar iniciativës qytetare, si një nga format imediate të pjesëmarrjes së qytetarëve në punët publike. Në këtë bllok, detyra e nxënësve është që më parë të ndërmarrin vetë një iniciativë qytetare, në mënyrë që ta zgjedhin problemin në bashkësinë lokale të cilin duan të zgjidhin, e që pastaj të kalojnë nëpër të gjitha fazat e

formulimit të iniciativës qytetare. Pasi ta kenë formuluar propozimin formal të iniciativës qytetare, nxënësit njihen me procedurën në bazë të së cilës në Kuvend vendoset mbi propozimet e qytetarëve, në mënyrë që të marrin pjesë në simulimin e sesionit të Kuvendit.

Pasi krahas iniciativave qytetare, edhe shoqatat e qytetarëve janë segment i rëndësishëm i shoqërisë civile, me program është paraparë që nxënësit të njihen me nocionin, rolin dhe llojin e shoqatës së qytetarëve, dhe që me anë të takimit me përfaqësuesit e shoqatës lokale të qytetarëve, të informohen mbi shembujt e praktikës së mirë (punëtoritë “Shoqatat e qytetarëve - e drejta për vetëvendosje” dhe “Shoqatat e qytetarëve – njohja me punën e shoqatave lokale të qytetarëve.”)

Blloku i fundit prej nëntë punëtorive i është kushtuar aksioneve lokale, si një nga mënyrat në të cilën qytetarët mund të marrin pjesë aktive në jetën e bashkësisë së tyre. Nxënësit njihen me hapat në planifikimin e aksionit lokal, e pastaj vetë marrin pjesë në planifikimin e aksionit për zgjidhjen e problemit të cilin e kanë zgjedhur. Me program është parashikuar që nxënësit, aksionin që e kanë planifikuar, t’ua shfaqin organizatave dhe individëve të interesuar, që nga ata të marrin ndihmë të nevojshme dhe të mund ta realizojnë aksionin e planifikuar.

Në orën përfundimtare, nxënësit kanë rastin që bashkë me mësimdhënësin t’i rikapitulojnë përmbajtjet që i kanë përpunuar me anë të programit “Edukata qytetare 3” dhe ta thonë mendimin e vet mbi programin.

Që nga fillimi, nxënësve iu duhet vënë në pah se demokracia nuk është model i gatshëm, i cili vetëm duhet zbatuar dhe që jep rezultate ideale menjëherë, por fjala është mbi **procesin e demokratizimit** i cili zhvillohet gradualisht dhe në të cilin, në këtë apo atë mënyrë, marrin pjesë të gjithë qytetarët.

Nxënësve gjithashtu nga fillimi iu duhet përmendur dallimi mes **normativës dhe reales**, domethënë, mes përshkrimit si duhet të duket shoqëria demokratike në formën “ideale”, dhe përshkrimit të asaj që ekziston në realitet në një shoqëri. Meqë fjala është për procesin afatgjatë të demokratizimit, ideali normativ shërben të orientojë në cilin drejtim, duhet të zhvillohet gradualisht shoqëria e cila mëton të jetë demokratike, dhe si për krahasim, ajo që ekziston sa largohet nga ajo që dëshirohet. Kjo vënie në pah e dallimit midis idealit dhe realitetit, është me rëndësi veçanërisht që nxënësit të mos fitojnë përshtypje të gabuar, se ekziston qëllimi që për tua zbukuroar tablonë e realitetit. Përkundrazi, arsimimi për jetën në shoqërinë qytetare, synon t’u ndihmojë nxënësve të zhvillohen në qytetarë kritikë, të cilët janë të gatshëm dhe kompetentë të mendojnë dhe veprojnë në mënyrë konstruktive në shtetin me strukturë demokratike. Prandaj, është me rëndësi të mbështetet të menduarit e tyre **kritik**, t’i referohen dallimit midis reales dhe të proklamuarës dhe të vihet në pah se premiset e proklamuarat të demokracisë duhet të perfeksionohen dhe të rishikohen vazhdimisht. Në këtë kuptim, është e dëshirueshme që nxënësve t’u tërhiqet vërejtja për ngjarjet në jetën politike dhe në pushtimin gradual, konsolidimin dhe zhvillimin e institucioneve dhe principeve demokratike, por edhe në shkeljen e tyre.

Pjesët e programit të “Edukatës qytetare 3”, janë adoptuar nga programi “Bëhu qytetar,” të cilin Iniciativat qytetare – shoqatat e qytetarëve për demokraci dhe arsimin civil e jetësojnë me sukses mbi katër vjet. Përpos kësaj, autorët dhe autoret në hartimin e programit i kanë përfshirë edhe përvojat e punës në programe të tjera të ndryshme nga kjo fushë, sikurse janë programi “Abeceda e demokracisë” i Grupit 484, “Dialogu është çelës”, i Grupit MOST dhe “Të drejtat e njeriut për mësimdhënës” i Qendrës së Beogradit për të Drejtat e Njeriut.

# **PROGRAMI MËSIMOR I EDUKATËS QYTETARE III <sup>1</sup>**

**Klasa e 3-të e shkollës së mesme**  
(1 orë në javë, 37 orë në vjet)

## **Objektivi dhe detyrat:**

**Objektivi i përgjithshëm** i lëndës është që nxënësit e shkollave të mesme të fitojnë dijeni, të zhvillojnë aftësi dhe shkathtësi duke u bazuar në vlerat e tyre që janë premisa për zhvillim të tërësishëm të personalitetit dhe për jetë kompetente, të përgjegjshme dhe të angazhuar në shoqërinë bashkëkohore qytetare, në frymën e respektimit të drejtave dhe lirive elementare të njeriut, të paqes, tolerancës, barazisë së gjinive, mirëkuptimit dhe të miqësisë midis popujve, grupeve etnike, kombëtare e fetare.

## **Detyrat e mësimit të lëndës janë:**

- që nxënësit të njihen me konceptet bazike nga kjo fushë: demokracia, shoqëria demokratike, politika dhe të drejtat e njeriut.
- që nxënësit të fitojnë dijeni elementare mbi institucionet e shoqërisë demokratike dhe rolin e qytetarit në shoqërinë demokratike.
- që tek nxënësit të zhvillohet aftësia e të gjykuarit kritik dhe e vendimmarrjes dhe veprimit të përgjegjshëm, si në shkollë ashtu edhe në mjedisin e gjerë.
- që nxënësit të zotërojnë shkathtësitë e domosdoshme, që dijenia e fituar të aplikohet në jetën e përditshme për marrjen e nismave të domosdoshme e të aksioneve konkrete.
- që, duke marrë parasysh përmbajtjen dhe mënyrën e tërësishme të punës në kuadër të kësaj lënde, të respektohen dhe praktikohen vlerat themelore demokratike dhe të nxitet miratimi i tyre.

## **PËRMBAJTJA E PROGRAMIT:**

**Hyrja:** Njohja e nxënësve me programin dhe mënyrën e punës.

### **I DEMOKRACIA DHE POLITIKA**

Kjo tërësi tematike i është kushtuar përcaktimit të nocionit të demokracisë dhe politikës, si parakushte të participimit politik të qytetarëve. Përpunohen mekanizmat e funksionimit dhe institucionet e demokracisë, si dhe mënyra e kontrollit dhe e kufizimit të pushtetit në sistemin demokratik.

### **II QYTETARI I SHOQËRISË QYTETARE**

Tërësia tematike i kushtohet nocionit, karakteristikave dhe vlerave të shoqërisë demokratike. Temat qendrore janë: raporti i shtetit dhe i shoqërisë qytetare, nocioni i qytetarit dhe rëndësia e mënyra e pjesëmarrjes së tyre në politikë.

### **III TË DREJTAT QYTETARE E POLITIKE DHE E DREJTA PËR INICIATIVË QYTETARE**

Pjesa hyrëse e kësaj tërësie i është kushtuar nocionit dhe kulturës së të drejtave të njeriut, si dhe rolit të qytetarëve dhe angazhimit për realizimin e këtyre të drejtave. Përpunohet në hollësi e drejta për iniciativën qytetare e cila mundëson participimin e

---

<sup>1</sup> nga Fletorja zyrtare

qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve dhe të drejtën për vetorganizimin e qytetarëve, me anë të cilit nxënësit njihen me rolin e organizatave joqeveritare.

#### **IV PLANIFIKIMI I AKSIONIT KONKRET**

Tërësia e fundit tematike u ofron nxënësve dijeni dhe shkathtësi elementare, që janë të domosdoshme për zgjidhjen e problemeve për ata të rëndësishme dhe të afërta, me anë të realizimit të aksioneve konkrete lokale. Në këtë mënyrë, nxënësit kanë rastin që të marrin pjesë aktive, duke aplikuar paraprakisht dijenitë e fituara. Në kuadër të kësaj tërësie, janë parashikuar prezantimet publike të projekt - aksionit, dhe të rezultateve në shkollë.

#### **MËNYRA E REALIZIMIT TË PROGRAMIT (UDHËZIMI)**

Pikënisjen dhe materialin themelor për konceptimin dhe hartimin e programit të lëndës Edukata qytetare, e përbëjnë një varg programesh me këtë problematikë, të cilët i kanë zhvilluar ekspertët vendorë, që janë provuar në komunitetin e nxënësve të shkollave të mesme, dhe janë vlerësuar pozitivisht si nga nxënësit e mësimdhënësit, ashtu edhe nga ekspertët e pavarur, si dhe rezultatet e hulumtimit të mendimeve dhe të përvojave të nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve, mbi sistemin tonë të arsimit. Përmbajtjet programore janë përzgjedhur në harmoni me të dhënat e hulumtimit dhe vlerësimin e përgjithshëm mbi funksionin e dobësuar edukativ të shkollës. Gjithashtu, janë konsultuar përvojat dhe zgjidhjet e një numri të vendeve evropiane në fushën e arsimit për demokraci dhe jetë, në shoqërinë qytetare.

Duke qenë se bëhet fjalë mbi lëndën e re, është hartuar doracaku për mësimdhënës me programin e përpunuar në hollësi dhe me udhëzimet metodike për secilën temë/orë. Njëkohësisht, mësimdhënësit të cilët përzgjidhen për të punuar në këtë lëndë, kanë mundësi që temat e njëjta t'i përpunojnë duke shfrytëzuar material tjetër (shembujt aktualë dhe situatat nga klasa apo shkolla), eventualisht ta shkurtojnë programin në qoftë se rrethanat e kërkojnë këtë, dhe t'ua adoptojnë mënyrën e punës kushteve konkrete, duke mos ndryshuar qasjen themelore metodike. Nga mësimdhënësit, si dhe nga nxënësit pritet që, në bazë të instrumenteve të ofruara, ta vlerësojnë edhe vetë programin dhe mënyrën e parashikuar të zhvillimit të mësimin.

Një mënyrë e tillë e zhvillimit të mësimin kërkon stërvitjen paraprake të mësimdhënësve, përvojë për zhvillimin e programeve të ngjashme, dhe sigurimin e kushteve të caktuara organizative e teknike. Madhësia e grupit/klasës nuk guxon të jetë më e vogël se 12, as më e madhe se 30 nxënës (optimal 16 deri 24). Orët mund të organizohen në mësimin e rregullt, dhe sipas nevojës të shtunën dhe si dy-orësh. (Kjo e fundit, posaçërisht është e volitshme për realizimin e pjesës së dytë të programit).

Qasja themelore metodike në zhvillimin e mësimin të Edukatës qytetare, është mënyra e punës në punëtori. Punëtoritë edukative mbështeten në principet e të mësuarit aktiv dhe të barazisë së gjithë pjesëmarrësve, në të mësuarit me përvojë dhe me strategjitë interaktive e kooperative të të mësuarit. Kjo do të thotë se mësimdhënësi nuk është vetëm burim i njohurisë, por edhe ndërmjetës e udhëheqës (moderator) i cili krijon kushte dhe i nxit nxënësit që me anë të shkëmbimit reciprok dhe interaksionit me mësimdhënësin, të fitojnë dijeni, ndërtojnë qëndrime pozitive dhe të zhvillojnë shkathtësi e aftësi.

Format më të shpeshta të shfrytëzuara të punës janë: aktiviteti simultan individual, puna në çifte ose grupe të vogla, këmbimi ose biseda në rreth, diskutimi grupor dhe ekspozimi para gjithë grupit (qoftë të mësimdhënësve ose nxënësve). Varësisht nga tema dhe detyrat e shtruar, aplikohen teknika të shumta të mësimin aktiv e kooperativ: nxjerrja e ideve, klasifikimi dhe gradimi, lozja e roleve dhe e lojës së simulimit të zgjidhjes së problemeve me



anë të shfrytëzimit të mjeteve të ndryshme të shprehjes dhe komunikimit: verbal (me gojë e me shkrim), me vizatim e lëvizje dhe me përdorimin e mediave.

Pasi mënyra e punës në punëtori nënkupton strukturën e caktuar dhe respektimin e rregullave të punës, që dalin nga principet e përmendura, nevojitet që ora e hyrjes në mësimin e kësaj lënde, t'i kushtohet njohjes me lëndën dhe mënyrën e punës.

Gjithashtu është detyrim i mësimit në mësimdhënës, duke pasur parasysh funksionin e përgjithshëm edukativ të shkollës, dhe pritjen se do të ndodhë transferimi i përvojave nga kjo lëndë në lëndët e tjera dhe format e punës në shkollë, të kujdeset që procesi mësimor në klasë, gjatë gjithë vitit shkollor, të zhvillohet në harmoni me atë që mësohet (krijimi i atmosferës demokratike, respektimi i të drejtave të nxënësve...), të angazhohet që rregulla të tilla të vlejnjë edhe jashtë klasës, edhe në lëndët tjera.

Nxënësit kanë në dispozicion materialet punuese dhe instruktive, dhe udhëzohen në shfrytëzimin e literaturës e të informatave nga burimet e ndryshme (literatura, shtypi, mediat elektronike).

Në përputhje me natyrën e lëndës, objektivin e saj dhe detyrat e mësimit, nxënësit nuk cilësohen me nota klasike shkollore. Vlerësimi përshkruar i punës dhe i avancimit të nxënësve (qoftë të individit apo punës së grupit) nga ana e mësimit në mësimdhënës, lypset të ketë funksion informativ dhe me këtë u ndihmohet nxënësve që të aftësohen për rishikim kritik të sjelljes dhe punës së tyre, dhe vet-evolucion. Vlerësohet shkalla e angazhimit dhe e interesimit të nxënësve, rregullsia e vijimit, bashkëpunimi i realizuar dhe respektimi reciprok, rezultatet e punës grupore duke marrë parasysh detyrat e shtruarra dhe jo suksesin individual dhe arritjet e nxënësve që nxisin raporte garuese.

Në bazë të përkujtuesve/instrumenteve të ofruara, nxënësit nxiten dhe stërviten për përcjelljen e vlerësimit të punës së tyre, dhe për vlerësimin e argumentuar të punës së të tjerëve.

## HAPËSIRA, PAJISJA DHE MJETET MËSIMORE

Hapësira në të cilën zhvillohet mësimi/mësonjëtorja për dedikim të përgjithshëm, duhet të ofrojë mundësi që të ulen rreth tavolinës dhe të bëjnë punë të ndarë në grupe të vogla (prej 4 deri 6 nxënës). Është e dëshirueshme që për mësimin e kësaj lënde të shfrytëzohet hapësira e veçantë dhe/ose materialet dhe produktet e punës së nxënësve të ruhen në një vend, dhe mund të ekspozohen në mësonjëtorje.

### *Mjetet mësimore:*

Kompletet e materialit shpenzues dhe didaktik për nxënës: materialet e shumëzuara në shumë kopje për punën e nxënësve, shtojcat që u jepen nxënësve dhe materialet shpenzuese (letrat, stilolapsat, ngjitësi, letrat për pankartat...).

### *Doracakët dhe literatura për mësimitdhënës:*

Grupi i autorëve: Udhëzuesi për mësimitdhënës "Edukata qytetare" për klasën e 3-të të shkollës së mesme

Grupi i autorëve: Udhëzuesi për mësimitdhënës – zgjedhja e teksteve "Edukata qytetare" për klasën e 3-të të shkollës së mesme.

## **Punëtorja: HYRJE**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të informohen mbi programin e lëndës, objektivat dhe detyrat e saj, mënyrën e punës dhe të njihen mes tyre.

### **DETYRAT:**

- Njohja e nxënësve me përmbajtjen dhe objektivat e lëndës
- Njohja me mënyrën e punës
- Prezantimi mes tyre

### **Materiali për punë:**

- letrat e formatit A 4, me rregullat e shkruara (Shtojca nr 1)
- letrat e formatit A 4, për secilin nxënës
- stilolapsat

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

### **Hapi parë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja ua bën me dije nxënësve se lënda “Edukata qytetare”, ka për objektiv t’i aftësojë nxënësit për një jetë kompetente, të angazhuar dhe të përgjegjshme, në bashkësinë bashkëkohore demokratike. Në orët e “Edukatës qytetare,” nxënësit do të njihen me konceptet bazike nga kjo fushë, sikurse janë demokracia, politika, qytetari dhe shoqëria qytetare. Do të kenë rastin të fitojnë dijenitë themelore mbi institucionet e shoqërisë demokratike, dhe rolin e qytetarëve në shoqërinë demokratike, si dhe t’i zotërojnë shkathtësitë e domosdoshme në mënyrë që dijenia e fituar të aplikohet për ngritjen e iniciativave qytetare dhe të aksioneve konkrete.

Në orët e “Edukatës qytetare”, nxënësit nuk do të rrinë ulur e të dëgjojnë ligjëratat, por kryesisht do të diskutojnë dhe do të këmbëjnë mendime.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja u thotë nxënësve se do ta kenë rastin për ta shprehur mendimin e tyre, qysh në aktivitetet e radhës.

### **Vërejtje:**

Ky është rast që nxënësit të shtrojnë pyetje lidhur me lëndën.

### **Hapi dytë:**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja u thotë nxënësve se është me rëndësi të merren vesh edhe mbi rregullat e punës që do të vlejné në orët e “Edukatës qytetare”. Letrat në të cilat janë shkruar këto rregulla: RESPEKTIMI I MENDIMIT, PJESËMARRJA dhe DËGJIMI, vendosi në pjesë të ndryshme të mësonjëtores dhe lusni nxënësit t’i afrohen atij rregulli të cilin e konsiderojné të domosdoshëm për punë të suksesshme në këto orë. Nxënësve u ofrohet mundësia që krahas rregullit që është ofruar, të fusin edhe rregulla të tjera në mënyrë që t’i shkruajë ato në faqet e zbrazëta të letrës. Kur nxënësit grupohen rreth rregullit, me ta

zhvillohet biseda se përse e kanë zgjedhur pikërisht këtë rregull, dhe pse mendojnë se respektimi i këtij rregulli është e rëndësishme për punë në orët e “Edukatës qytetare”

**Hapi tretë:**  
(20 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja u thotë nxënësve se në vazhdim të orës, do të kenë rastin të njihen më mirë mes veti. Në këtë aktivitet, detyra e nxënësit është ta vizatojë autoportretin e vet dhe në portret, pranë emrit të tij, ta shkruajë edhe moton e vet jetësore (këto mund të jenë fjalë të ndonjë vjershe, ndonjë thënie, apo cilado fjali që e dallon si “idenë e tij prijëse”). Pason prezantimi gjatë së cilit nxënësi e thotë emrin e tij, e tregon portretin e tij dhe e sqaron moton e tij jetësore.

**Vërejtje:**

Mësimdhënësi/mësimdhënësja merr pjesë në këtë aktivitet dhe sipas nevojës do të prezantohet i pari/e para.

## Shtojca nr. 1

<p><b>RESPEKTIMI I MENDIMIT</b></p> <p>Secili mendim është i çmueshëm Të gjithë marrin pjesë, s'ka pavarësisht sa dallon nga të tjerët. vëzhgues, ndonëse secili ka të tjerët.</p>	<p><b>PJESËMARRJA</b></p> <p>Është me rëndësi që të shqiptohet drejtë për përjashtim (rregulla sipas mënyrës që nuk ofendon të (“tutje”)</p>
<p><b>DËGJIMI</b></p> <p>Dëgjojmë me kujdes atë që flet. Të gjithë pjesëmarrësit kanë të drejtë të barabartë të dëgohen. Derisa njëri nga pjesëmarrësit flet, të tjerët nuk e pengojnë.</p>	

## **Punëtorja: DEMOKRACIA DHE VENDIMARRJA DEMOKRATIKE**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që t'u ndihmojë nxënësve të kuptojnë se mënyra e marrjes së vendimeve është një nga veçoritë e rëndësishme të demokracisë.

### **DETYRAT:**

- Rikujtimi i rëndësisë së rregullave (normave dhe procedurave) për funksionimin e bashkësisë shoqërore
- Dallimi i vendimmarrjes demokratike nga jodemokratike
- Dallimi i demokracisë të drejtpërdrejtë dhe indirekte
- Vënia në pah e faktorëve të cilët e përcaktojnë shkallën e karakterit demokratik të vendimmarrjes

### **Materiali për punë:**

- Pyetëtori për nxënës (Shtojca nr 1)
- Teksti “Demokracia dhe vendimmarrja demokratike” për mësimdhënës (Shtojca nr. 2)
- Teksti “Kanë thënë mbi demokracinë” (Shtojca nr 3)
- Letra e madhe

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i fton nxënësit ta imagjinojnë këtë situatë. Për nxënësit e vitit të fundit të gjimnazit është planifikuar shkuarja në ekskursion. Në shkollë ekzistojnë 6 paralele me gjithsej 180 nxënës. Secili nga ata ka idenë e vet, ku do të ishte më mirë të shkohet në ekskursion. Shtrohet pyetja SI do të duhej të merret vendimi mbi vendin e ekskursionit.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja paraqet para klasës këto zgjidhje të mundshme.

1. drejtori i shkollës do ta merrte vetë vendimin pa e pyetur askënd tjetër
2. do të vendosej në takimin me drejtorin dhe mësimdhënësit, ku do të merrnin pjesë vetëm djemtë
3. do të vendosej në takimin me drejtorin dhe mësimdhënësit në të cilin do të marrin pjesë të gjithë nxënësit/nxënëset (që janë gjithsej 180)
4. do të vendosej në takimin e drejtorit, mësimdhënësve dhe të përfaqësuesve të nxënësve

Në këtë pjesë të aktivitetit, mësimdhënësi/mësimdhënësja do t'i lusë nxënësit që, sipas ndjenjës personale, të caktojnë se në cilat nga situatat e përmendura, mund të thuhet se vendimi është marrë në mënyrë demokratike, e në cilën nuk mund të thuhet një gjë e tillë.

Diskusimin e shkurtër mësimdhënësi/mësimdhënësja e përmbledh duke përfunduar se vetëm mënyra e tretë dhe e katërt e vendimmarrjes mund të konsiderohen demokratike. Në këtë rast, niset nga fakti se demokratike është ajo vendimmarrje në të cilën të gjithë të interesuarit mund të ndikojnë në vendimin e marrë. Në këtë kuptim, opsioni nën 2 (vetëm djelmohat) nuk mund të konsiderohet demokratike, sepse nuk shihet përse do të futej një

pjesëmarrje e tillë përzgjedhëse, respektivisht t'i lihej vetëm një pjese të interesuar për të ndikuar në vendimin, dhe atë në bazë të kriterit që është i parëndësishëm për objektin e vendimmarrjes.

As opsioni 1 (drejtori) nuk i përmbush këto elemente të demokracisë (pjesëmarrje më të gjerë të mundshme të personave të interesuar). Mbetet se legjitime dhe demokratike është që, mbi propozimin e nxënësve, të vendosin ose të gjithë ose disa nga nxënësit.

Në vazhdim të aktivitetit, mësimitdhënësi/mësimitdhënësja thotë se atëherë kur të gjithë anëtarët e grupit mund të marrin pjesë drejtpërdrejtë në marrjen e vendimit, flasim mbi **demokracinë e drejtpërdrejtë (immediate)**. Mirëpo, demokracia e drejtpërdrejtë nuk është përherë e mundshme, sidomos në grupet tepër të mëdha. Edhe në shembullin tonë, është çështja nëse do të mund të gjendet hapësira ku do të mblidheshin dhe dëgjonin të gjithë nxënësit, dhe koha e nevojshme që të gjithë të paraqesin propozimet dhe diskutimet e veta. Prandaj, është më reale që vendimet t'i marrin përfaqësuesit e nxënësve. Një marrje e tillë e vendimeve quhet **demokrati përfaqësuese**.

### **Vërejte:**

Komentet e veta që i jep në këtë punëtori, mësimitdhënësi/mësimitdhënësja i mbështetet në tekstin “Demokracia dhe vendimmarrja demokratike” (Shtojca 2).

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Duke bërë përmbledhjen e aktivitetit të mëparshëm mësimitdhënësi/ mësimitdhënësja thekson se vendimin për vendin e ekskursionit mund ta marrin përfaqësuesit të cilët më parë i zgjedhin nxënësit e interesuar për të shkuar në ekskursion, grupet e interesuara, dhe se ky është kusht i nevojshëm, por edhe jo i mjaftueshëm për vendimmarrje demokratike. Me këtë rast, theksohet se çdo zgjedhje e përfaqësuesit, në të njëjtën kohë nuk është edhe demokratike.

Pastaj, i ndanë nxënësinë në grupe të vogla (4-5 nxënës) dhe secilit nga ato ua shpërndanë tabelën e cila përmban situata të ndryshme, ku për marrjen e vendimit janë autorizuar disa nga përfaqësuesit e grupit të interesuar (Shtojca nr 1). Nxënësit kanë detyrë, që në grupe të vogla, të diskutojnë sa është demokratike procedura në secilën nga këto situata, kurse mendimin e vet ta shprehin me një numër prej 1 deri 5 (1= nuk është fare demokratike. 5= është plotësisht demokratike). Nxënësit pastaj e plotësojnë tabelën duke i vlerësuar me notë disa zgjidhje (prej 1 deri 5)

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimitdhënësi/mësimitdhënësja i fton përfaqësuesit e grupeve që për situatën e parë, ta japin notën e vet të karakterit demokratik dhe ta arsyetojnë shkurt, dhe notën e tyre ta shkruajnë në tabelën e përgatitur, të vizatuar në tabelë (dërrasën e zezë). Pasi që grupet ta notojnë situatën e parë, kalohet në situatën tjetrën, dhe ashtu me radhë kalohen të gjitha situatat.

Duke bërë rezymenë e diskutimit, mësimitdhënësi/mësimitdhënësja përfundon se nuk ka kriteret e zakonshme në bazë të të cilave do të vërtetohej nëse ndonjë vendimmarrje është demokratike apo jo. Ndonjë vendimmarrje është më pak e ndonjë më shumë demokratike, kurse ndonjë paraqet vetëm fantazmën e demokracisë.

Që të mund të flasim mbi karakterin demokratik të vendimeve të caktuara, është e domosdoshme të vërtetojmë edhe se në çfarë mënyre zgjidhen njerëzit që i marrin ato vendime. Procedura e zgjedhjes së atyre të cilët do të vendosin, duhet të rregullohet (në mënyrë ku të gjithë të kenë mundësi të kandidohen, të marrin pjesë në zgjedhjen e tyre, më

mënyrë që përfaqësuesit të zgjidhen me shumicën e votave, dhe se procedura e zgjedhjes të jetë e kontrolluar, përfaqësuesi duhet t'i përfaqësojë interesat e atyre të cilët e kanë zgjedhur).

Mësimdhënësi/mësimdhënësja përmend pyetjet e domethënies së demokracisë që janë hapur në këtë punëtori teksta , dhe se mbi këtë do të flitet gjatë gjithë lëndës së Edukatës qytetare. Propozohet që definicioni fillestar (hyrës, pikënisës ose minimal) i demokracisë që është arritur në këtë punëtori, është se demokracia është grumbull i rregullave procedurale për marrjen e vendimeve kolektive që mundëson pjesëmarrjen më të gjerë të mundshme të të interesuarve, apo atyre të cilëve u përkasin ato vendime (duke nënkuptuar edhe kontrollin e tyre të procesit të vendimmarrjes).

Vendimmarrja demokratike/jodemokratike, mund të zhvillohet në të gjitha bashkësitë njerëzore. Megjithatë, çështja e vendimmarrjes demokratike shpesh është e ndërlidhur me shtetin. Kjo është pasojë e faktit se shteti (pushteti) merr vendimet, që janë të rëndësishme për shoqërinë në tërësi, dhe ka fuqi më të madhe për të vendosur. Është me interes më të përgjithshëm, që pushteti të jetë demokratik - që vendimet të cilat i merr pushteti të jenë nën kontrollin publik të atyre, me të cilët kanë të bëjnë.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se në këtë punëtori, nuk shtrohet pyetja e CILËSISË së vendimeve që merren, por vetëm e MËNYRËS se si merren (rëndësia e rregullave dhe e procedurave). Cilësia e vendimeve të marra demokratike është e lidhur me çështjen e përparësisë dhe të mungesës së demokracisë. Duke përmendur se mbi këtë do të bisedohet qysh në orët e ardhshme, mësimdhënësi/mësimdhënësja ua shpërndan nxënësve tekstin “Kanë thënë mbi demokracinë” (Shtojca 3), i cili duhet t'u ndihmojë në mendimet mbi domethënien dhe vlerat e demokracisë.

## Materiali për punë:

### Shtojca nr. 1

Në ç' masë do të jetë demokratike vendosja e përfaqësuesve të nxënësve mbi vendin e ekskursionit? Rrumbullakoni ndonjë numër prej **1** (nuk do të jetë fare demokratike) deri **5** (do të jetë plotësisht demokratike):

Të gjithë nxënësit kanë mundur të jenë përfaqësues. Përfaqësuesit janë zgjedhur me votime në orën e Edukatës qytetare, të cilën e vijon gjysma nga numri i përgjithshëm i nxënësve. Nxënësit që kanë dëshiruar të jenë përfaqësues, kanë paraqitur propozimin e vendit të ekskursionit, kurse për përfaqësues janë zgjedhur ata të cilët në votime kanë marrë më shumë vota.	<b>1 2 3 4 5</b>
Përfaqësuesit kanë mundur të jenë të zgjedhur vetëm nga radhët e nxënësve të shkëlqyeshëm e shumë të mirë, sepse të tjerëve nuk u është lejuar të kandidohen. Nxënësit që kanë dashur të jenë përfaqësues, para gjithë klasës kanë paraqitur propozimin e vendit të ekskursionit. Përfaqësuesit me votim i kanë zgjedhur të gjithë nxënësit klasë.	<b>1 2 3 4 5</b>
Të gjithë nxënësit kanë mundur të jenë përfaqësues. Secila paralele me votim i ka zgjedhur nga dy Përfaqësues, të cilët tek lypset të gjejnë se cili do të jetë propozimi i tyre mbi vendin e ekskursionit.	<b>1 2 3 4 5</b>
Të gjithë nxënësit kanë mundur të jenë përfaqësues. Nxënësit që kanë dashur të jenë përfaqësues para gjithë klasës e kanë paraqitur propozimin e vendit të ekskursionit, dhe për përfaqësues i kanë zgjedhur ata të cilët në votim kanë fituar më shumë vota.	<b>1 2 3 4 5</b>
Përfaqësuesit e nxënësve i kanë caktuar kujdestarët1 e klasave të secilës paralele.	<b>1 2 3 4 5</b>



## Shtojca nr. 2 (për mësimdhënës)

### DEMOKRACIA DHE VENDOSJA DEMOKRATIKE

Definicioni fillestar (hyrës, pikënisës ose minimal) i demokracisë nga i cili nisemi në këtë punëtori, është se demokracia është grumbull i **rregullave** procedurale për marrjen e **vendimeve kolektive** që mundëson **pjesëmarrjen** më të **gjerë** të mundshme të të interesuarve, apo të atyre me të cilët kanë të bëjnë ato vendime (duke nënkuptuar edhe kontrollin e procesit të vendimmarrjes nga ata). Fjala është mbi definicionin “minimal”, sepse ajo ka të bëjë me kushtet minimale që ndonjë vendimmarrje të mund të quhet demokratike. Ai quhet edhe definicion **formal**, sepse demokracia në të caktohet me **formën** në të cilën zhvillohet vendosja demokratike, ose me mënyrën që kanë të bëjnë ato vendime. Atë formë e përfaqësojnë rregullat e procedurës të cilat duhet të jenë të tilla që ndonjë vendim të merret në **mënyrë** demokratike (ose në formën demokratike). Pasi aty, para se gjithash, janë të rëndësishme procedurat (pra procedimet) prandaj ky definicion quhet edhe definicion **procedural** i demokracisë. Që ndonjë vendimmarrje të quhet demokratike, është e rëndësishme që vendimi të jetë marrë në mënyrë demokratike (me respektimin e rregullave të procedurës), pavarësisht përmbajtjes dhe cilësisë së vendimeve që merren. Për këto arsye bëhet fjalë mbi definicionin **minimal** të demokracisë.

Kjo procedurë është kusht i **nevojshëm**, por **jo edhe i mjaftueshëm** që të flasim mbi demokracinë dhe prandaj, demokracia nuk duhet të reduktohet vetëm në procedurë. Por, nuk duhet të harrohet se **pa** rregulla demokratike **s’ ka** demokraci. Ajo që nevojitet më së shumti që procedura demokratike të sjellë demokracinë në kuptimin e gjerë (deri tek shkalla e juaj e demokracisë), janë kushtet shtesë, supozimet dhe institucionet. Kur në shoqëri të instalohen edhe ata elemente shtesë, atëherë e fitojmë **nocionin e gjerë** të demokracisë (për ato kushte shtesë shikoje punëtorinë “Premisat në demokraci”).

Me përcaktimin minimal të demokracisë, fitojmë mundësi që demokracinë ta dallojmë nga autokracia ku vendimet i merr një njeri (ose pakica) në mënyrë autoritare (duke mos përfillur çfarëdo rregulli) dhe arbitrarisht (sipas qejfit të vet), pa mundësi të çfarëdo pjesëmarrjeje të atyre me të cilët kanë të bëjnë ato vendime.

Ekzistimi i rregullave dhe procedurave demokratike që duhet të pasojnë me rastin e vendimmarrjes, si dhe ekzistimi i kontrollit të respektimit të tyre, paraqet garancinë se ata të cilët i marrin vendimet kolektive nuk do të vendosin në mënyrë autoritare, as arbitrarisht.

Kur flitet për grumbullin e rregullave **procedurale**, mendohet në grumbullin e rregullave themelore (primare) me të cilat vërtetohet **kush është i autorizuar** të marrë vendime kolektive dhe në bazë të cilave **procedura**, domethënë në çfarë mënyre të normuar paraprakisht. Në ato procedura demokratike bëjnë pjesë, midis të tjerash: e drejta e përgjithshme e votës, zgjedhjet e lira dhe të ndershme, principi i përfaqësimeve (përfaqësim shumicë ose proporcional) sundimi i drejtësisë, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, garantimi dhe mbrojtja gjyqësore të drejtave dhe lirive elementare të njeriut, etj.

Kur në këtë mënyrë e kemi veçuar demokracinë nga mënyra jodemokratike e vendimmarrjes dhe e drejtimit (autokracisë), atëherë mbi demokracinë mund të flitet vetëm si mbi diçka që dallon në shkallën e zhvillimit, e jo mbi diçka që ka apo nuk ka (sepse në rastin e fundit fare nuk kemi të bëjmë me demokracinë). Tjetër gjë që duhet pasur ndërmend është se, demokracia nuk është kurrfarë modeli apo shablloni i cili duhet aplikuar njëherë e përgjithmonë, por fjala është mbi **procesin e demokratizimit**. Kjo sidomos është e rëndësishme për shoqëritë në tranzicion ose të ashtuquajtura shoqëri tranzite në të cilat po lind demokracia. Tranzicioni paraqet procesin e kalimit nga sistemi jodemokratik në atë demokratik, me anë të procesit afatgjatë të demokratizimit. Fillimin e demokratizimit, ose shkallën fillestare të zhvillimit të demokracisë, e paraqesin të ashtuquajturat demokraci

**zgjedhore** në të cilat janë instaluar vetëm disa parakushte fillestare dhe disa procedura elementare (pluralizmi politik, sistemi me shumë parti, zgjedhjet e lira dhe të ndershme). Instalimi i premisave dhe i institucioneve të mëtejshme të demokracisë (sundimi i drejtësisë, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, ndarja e pushtetit, mediat e pavarura, ekonomia e tregut, shoqëria e zhvilluar qytetare, etj.) janë elemente të demokratizimit të mëtejshëm që çon në demokracinë e **konsoliduar**, që do të thotë se demokracia si sistem, është konsoliduar dhe se zhvillimi i saj i mëtejshëm, në shkallë më të larta të demokracisë, po zhvillohet pa rrezik që serish të bjerë në sistem jodemokratik.

### Shtojca nr. 3

#### Kanë thënë për demokracinë...<sup>2</sup>

Mendimi i njeriut për demokraci e bënë demokracinë të mundshme. Prirja e tij nga padrejtësia e bënë demokracinë të domosdoshme. (Rejnhold Nibur, teolog)	Pyetja “Kush duhet të qeverisë?” është shtruar gabimisht. Mjafton nëse qeveria e keqe mund të revokohet. Kjo është demokraci. (Karl Poper, filozof)
Demokrati nuk duhet të besojë se shumica gjithmonë do të marrë vendim të mençur. Ajo në çka duhet të besojë ai është se vendimet e shumicës – të mençura a jo- duhet t’i përqafojë, derisa shumica nuk merr ndonjë vendim tjetër. (Bertran Rasel, filozof britanik)	Masa më e madhe e demokracisë nuk nënkupton as masën më të madhe të lirisë, as masën më të madhe të barazisë, por masën më të madhe të pjesëmarrjes. (A. D. Benoist, politikan)
Demokracia është proces që na garanton se ne nuk do të qeverisemi më mirë sesa meritojmë këtë. (Xhorxh Bernard Shou, shkrimtar)	Fryma e demokracisë nuk mund të imponohet nga jashtë. Ajo duhet të rritet e nga brendia e popullit. (Mahatma Gandi, shtetar)
Demokraci do të thotë marrje e vendimit nga ata të cilëve iu përket ai vendim. (Karl Fridrih von Vajceker, shtetar)	Demokracia do të thotë të kesh zgjidhje. Diktatura nënkupton të vihesh para zgjidhjes. (Zhanin Luzak)
Demokracia nuk nënkupton: “Unë jam njësoj i mirë si edhe ti,” por “Ti je njësoj i mirë si edhe unë” Teodor Parker, reformator shoqëror)	Demokracia nuk e bën lidhjen e forte midis njerëzve. Mirëpo, ajo ua lehtëson raportin mes tyre. (Aleksis de Tokvil, shkrimtar e shtetar)
Demokraci do të thotë: të respektosh rregullat e lojës, madje edhe kur gjykatësi nuk është aty. (Manfred Hausman)	Demokracia është forma më e keqe e shtetit- nëse i përjashtojmë të gjitha të tjerat. (Vinston Çerçil, shtetar)

<sup>2</sup> marrë nga [www.dadalus.org](http://www.dadalus.org)

## **Punëtorja: JETA QYTETARE, POLITIKA DHE PUSHTETI**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që jeta qytetare, politika dhe pushteti të dallohen si veprimtari të ndryshme, por të gërshetuara publike.

### **DETYRAT:**

- Ndarja e veprës personale të jetës së qytetarëve nga veprimtaria e tyre publike.
- Caktimi i nocioneve jeta qytetare, politika dhe pushteti
- Dallimi i politikës dhe pushtetit

### **Materiali për punë:**

- Kuptimori për nxënës (Shtojca nr. 1)
- Tabela me shembuj (Shtojca nr. 2)
- Tabela me shembuj e renditur drejtë ( Shtojca nr. 3)

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i ndan nxënësit në grupe me nga katër veta, dhe i lut që në grupe të vogla të përpiqen të caktojnë se çfarë nënkuptojnë me nocionin: jeta qytetare, politika dhe pushteti.

#### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja u shpërndan nxënësve përcaktimet e nocionit jeta qytetare, politika dhe pushteti (Shtojca nr. 1). Nxënësit i krahasojnë mendimet e veta mbi jetën qytetare, politikën e pushtetin me përcaktimet që i përmban kjo shtojcë.

Është me rëndësi që mësimdhënësi/mësimdhënësja të përmendë se për nocionet jeta qytetare, politika dhe pushteti, si dhe për kuptimet e tjera që ndeshen në këtë lëndë (demokracia, shoqëria civile, të drejtat e njeriut), nuk është lehtë të jepet definicioni i saktë dhe i thjeshtë, i cili do të ishte i gjithë-pranueshëm. Me të gjitha këto kuptime “Edukata qytetare” merret në numrin më të madh të orëve, duke ju qasur me atë rast nga kënde të ndryshme dhe duke i sqaruar gradualisht.

#### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i ndan nxënësit për punë në çifte. Secili çift e merr tabelën të cilën e plotëson bashkërisht (Shtojca nr 2). Për secilën fjalë, informatë, përshkrim të personit, përkatësisht të aktivitetit të tij, nxënësi lypset të shënjojnë me yll se cilës kategori i takon, në tabelë pranë fjalive. Kategoritë e ofruara janë: jeta qytetare, politika, pushteti, etj. Nxënësit duhet ta shqyrtojnë çdo fjalë, të bisedojnë mes veti dhe të vendosin.

Për shembull, fjali është: Petri vazhdimisht del në zgjedhje. Nxënësit nevojitet ta shënjojnë a është kjo informatë për Petrin e atillë që na flet mbi pjesëmarrjen e Petrit në jetën qytetare, në politikë apo në pushtet. Në qoftë se nxënësit mendojnë se një informatë mund të gjendet në shumë kategori, mund të vënë yll në të gjitha vendet për të cilat janë përcaktuar.

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Tabela e njëjtë, që e kanë nxënësit, ndodhet në format të madh në tabelë (dërrasë të zezë). Në këtë tabelë mësimitdhënësi/mësimitdhënësja i shkruan përgjigjet e çifteve.

Me këtë rast, secili çift jep përgjigje për nga një fjali. Kur çifti i parë përgjigjet në detyrën e parë, mësimitdhënësi/mësimitdhënësja këtë e shënon në tabelë. Pastaj i fton të tjerët që, nëse dikush nuk patohet, të thonë mendimin e vet, kurse përgjigjen ndryshe, gjithashtu e regjistron në tabelë. Pastaj, nxënësit diskutojnë rreth zgjidhjeve të propozuara. Në qoftë se edhe më tutje ekziston mospajtimi, mësimitdhënësi/mësimitdhënësja i lë të gjitha përgjigjet e propozuara në të kundërtën, e mban përgjigjen rreth së cilës janë pajtuar nxënësit. Çifti tjetër jep përgjigje në pyetjen e dytë, dhe procedura përsëritet. Kështu klasa i kalon të gjitha 14 fjalitë.

Mësimitdhënësi/mësimitdhënësja, në fund e komenton rezultatin e punës së përbashkët dhe çfarë, ku është renditur. Si orientim për komentin i shërben tabela me shembujt e renditur drejt (Shtojca nr 3.)

### **Vërejte:**

Pasi kuptimi i këtyre nocioneve, i arritur me anë të harmonizimit të pjesëmarrësve në punëtori për momentin është i kënaqshëm, është e pranueshme që ndonjëra prej fjalive nga Shtojca 1, të gjendet në rubrikën ku nuk i takon, kur e krahasojmë me caktimin e datës në Shtojcën nr 2, dhe përgjigjeve në shënuara në tabelën, nga Shtojca 3. Është më me rëndësi t'u lejohet nxënësve liria për rezonim në qoftë se me interpretimin e tyre e mbrojnë bindshëm klasifikimin e bërë.

## Materiali për punë:

### Shtojca nr. 1 (për nxënës)

#### SQARIMI I NOCIONEVE JETA QYTETARE, POLITIKA DHE PUSHTETI

Mbi **jetën qytetare** mund të flasim në kuptimin e gjerë dhe të ngushtë. Jeta qytetare në kuptimin e gjerë është njëjtë që edhe “jeta shoqërore”, e kap tërësinë e aktiviteteve dhe proceseve të lira (ekonomike, kulturore, shkencore, sportive, fetare, etj.), që zhvillohen **jashtë** sferës së politikës dhe pushtetit. Aty futet ajo pjesë e jetës së individit i cili i është kushtuar realizimit të planeve personale. Kur qytetarët veprojnë vullnetarisht, duke u bashkuar dhe duke u organizuar për realizimin e disa objektivave dhe interesave të përbashkëta që i tejkalojnë planet e tyre, duke vepruar **publikisht** dhe duke u përpjekur të **ndikojnë në pushtetin**, atëherë flasim mbi jetën qytetare në kuptimin e ngushtë.

**Politika** si aktivitet i organizuar (veprimtari) është e orientuar në:

- vendosjen mbi format e mundshme të jetës së përbashkët
- marrjen e pozicionit në pushtet
- ndikimin në procesin e vendimmarrjeve të pushtetit

Me politikë kryesisht merren partitë politike, por edhe organizatat joqeveritare dhe grupet e qytetarëve, kur me aktivitetet e veta ndikojnë mbi pushtetin, si dhe qytetarët kur dalin në zgjedhje, protestojnë, marrin pjesë në fushatë, nënshkruajnë peticione, e ngjashëm.

**Pushteti** merr vendime që janë të detyrueshme për të gjithë pjesëtarët e bashkësisë. Me këto vendime, rregullohen marrëdhëniet reciproke të qytetarëve dhe përdorimi i resurseve në territorin e caktuar (komuna, qyteti, rrethi, shteti). Procesi i marrjes së vendimeve zhvillohet në institucione, dhe sipas rregullave të përcaktuara paraprakisht.

**Shtojca nr. 2: Tabela me shembujt**

	JETAPOLITIKA	PUSHTETI	PUSHTETI
Janoshi e plotëson fletëpagesën për pagimin e tatimit			
Mirsada vazhdimisht voton për të njejtën parti politike			
Janoshi është kryetar i Kuvendit të komunës			
Sllavica është anëtare e partisë Politike- NNS.			
Janosh e inicion fushatën për luftën kundër duhanit			
Ollga është anëtare e OJQ “T”i respektojmë të drejtat e fëmijëve”			
Mirsada është drejtoreshë e ndërmarrjes			
Deputetët e Kuvendit Republikan e kanë votuar Ligjin mbi arsimimin e mesëm			
Banuesit e godinës kanë bërë marrëveshje për kujdesin e përbashkët mbi qentë endacakë			
Boshko në shesh e nënshkruan petitionin			
Boshko është pronar i ndërmarrjes për prodhimin e spiraleve të metalta			

**Shtojca nr. 3: Tabela me shembujt e renditur drejtë**

	JETAPOLITIKA	PUSHTETI	PUSHTETI
Janoshi e plotëson fletëpagesën për pagimin e tatimit	✓		
Mirsada vazhdimisht voton për të njëjtën parti politike	✓	✓	
Janoshi është kryetar i Kuvendit të komunës			✓
Sllavica është anëtare e partisë Politike- NNS.		✓	
Janosh e inicion fushatën për luftën kundër duhanit	✓		
Ollga është anëtare e OJQ “T”i respektojmë të drejtat e fëmijëve”	✓		
Mirsada është drejtoreshë e ndërmarrjes	✓		
Deputetët e Kuvendit Republikan e kanë votuar Ligjin mbi arsimimin e mesëm			✓
Banuesit e godinës kanë bërë marrëveshje për kujdesin e përbashkët mbi qentë endacakë	✓		
Boshko në shesh e nënshkruan petitionin	✓		
Boshko është pronar i ndërmarrjes për prodhimin e spiraleve të metalta	✓		



## **Punëtorja: PUSHTETI I KUFIZUAR**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen me domosdoshmërinë e qëllimit të kufizimit të pushtetit.

### **DETYRAT:**

- Sqarimi përse është e rëndësishme që pushteti të jetë i kufizuar
- Analizimi i mënyrave të ndryshme të kufizimit të pushtetit

### **Materiali për punë:**

- Kartelet me detyrat për nxënës (Shtojca nr. 1)
- Kartelet me detyrat për mësimdhënës (Shtojca nr. 2)
- Teksti: “Mënyra e kufizimit të pushtetit” – shtojca për mësimdhënës dhe nxënës (Shtojca nr. 3)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e nis orën duke i ftuar nxënësit që ta kujtojnë fjalën popullore “**Kadiu të padit, kadiu të gjykon**” dhe e inicion diskutimin mbi domethënien e kësaj fjale duke shtruar këto pyetje:

1. Çfarë është ajo shoqëri në të cilën njeriu i njëjtë edhe të padit edhe të gjykon?
2. Cila ka qenë pozita e tij në atë shoqëri, të cilin njeriu i njëjtë edhe e padit edhe e gjykon?
3. A ka pasur ai të drejtë të marrë pjesë në pushtet, dhe si?
4. Cila ka qenë pozita e sundimtarit?
5. Çfarë i mundëson sundimtarit një shoqëri e tillë?

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e bën rezymenë e diskutimit të mëparshëm, duke cekur këtë:

Njerëzit kanë besuar me shekuj se më me rëndësi është **KUSH** qeveris në një shoqëri, prandaj janë zgjedhur njerëz më të aftë ose më të mençur ose më të arsimuarit fetarë, ose më të guximshëm ose më të ndershëm, etj. Por zakonisht ka ndodhur që ata, të gjithë njëjtë, e kanë tradhtuar besimin që u është dhënë, dhe gradualisht e kanë përqendruar gjithë pushtetin në duart e veta, duke u shndërruar në tiranë, diktatorë, uzurpatorë. Andaj, përvoja shekullore i ka mësuar gradualisht njerëzit se më e rëndësishme është **SI** qeveriset, se sa **KUSH** qeveris. Është kuptuar se është e nevojshme të **kufizohet** pushteti, nëpërmjet përcaktimit të rregullave dhe procedurave të cilat çdo pushtet duhet t'i respektojë. Nëse qeveriset sipas rregullave të dakorduara dhe procedurave të normuara që i nxjerr shoqëria, atëherë fjala është për pushtetin e **kufizuar** por nëse, megjithatë, nuk ka rregulla dhe procedura, ose ato shkelen, atëherë fjala është për pushtetin e **pakufizuar**, dhe qeverisjen arbitrare, sikurse ia ka ënda sundimtarit.

Në qoftë se nisemi nga ajo se më e rëndësishme është se **KUSH** qeveris, respektivisht, se personat që janë më të mençur, më të aftë ose më guximtarë janë më të thirrura për të

qeverisur, atëherë mund të shtrohet edhe pyetja nëse dikush tjetër mund të marrë pjesë, në çfarëdo mënyre, në proceset e vendimmarrjes, kur na drejtojnë më të mirët. E kjo pastaj e përjashton vetë idenë e demokracisë. Pasoja e kësaj zakonisht është uzurpimi i pushtetit nga ana e një personi, apo grupi të njerëzve, që çon në pushtetin e pakufizuar dhe në tirani.

Pasi që në demokraci populli e posedon pushtetin më të lartë (sovrani) dhe **autorizon** me anë të zgjedhjes së përfaqësuesve që do ta **ushtrojnë** atë pushtet, pushteti i përfaqësuesve të popullit duhet të jetë i **kufizuar**.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i lë anash kartelet me tekstet (Shtojca nr. 1) që janë të kthyer ashtu që të shihet teksti. I njëjti tekst duhet të përsëritet dy deri tri herë. Është me rëndësi që numri i teksteve t'i përgjigjet numrit të nxënësve. Nxënësve u thuhet t'i shikojnë tekstet dhe ta zgjedhin fjalinë/ tekstin që e duan.

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i lut nxënësit ta gjejnë qiftin e vet (ndonëse varësisht nga numri i nxënësve mund të jenë edhe tre në grup), ashtu që do ta gjejnë atë i cili e ka zgjedhur tekstin e njëjtë.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i sqaron nxënësit se në pusullat që i kanë zgjedhur, janë shkruar mënyra të ndryshme të kufizimit të pushtetit. Pastaj i lut nxënësit që brenda grupeve të vogla, të bisedojnë mbi tekstin që e kanë zgjedhur, dhe të përgjigjen në pyetjen se në çfarë mënyrë kufizohet pushteti, me aksion apo rregullin e shkruar në pusullë.

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në vazhdim të aktivitetit, çiftet kumtojnë se në çfarë mënyre, sipas mendimit të tyre, aktiviteti apo rregulli i shkruar në kartelet kontribuon në kufizimin e pushtetit. Është e dëshirueshme që nxënësit të nxjerrin përfundimin vetë, përse janë të domosdoshme të gjithë ato mekanizma. Mësimdhënësi/mësimdhënësja i numëron format e kufizimit të pushtetit duke u thirrur në masën më të madhe të mundshme në përgjigjet që i kanë dhënë grupet, kurse punëtorinë e përmbledh edhe në bazë të tekstit “Mënyra e kufizimit të pushtetit” (Shtojca nr. 3).

### **Vërejte:**

Disa nga kartelet që u shpërndahen nxënësve (Shtojca nr. 1) janë të thjeshtësuara, krahasuar me tekstet në shtojcën që e kanë mësimdhënësit (Shtojca nr. 2). Kur mësimdhënësi/mësimdhënësja e bën rezyrenë dhe i komenton përgjigjet e nxënësve, është e rëndësishme të theksojë se kufizimet përkatëse të pushtetit të shkruar në pusulla gjenden në Kushtetutën e Serbisë.

Pas përfundimit të aktiviteteve, mësimdhënësi/mësimdhënësja ua ndan nxënësve tekstin “Mënyra e kufizimit të pushtetit” (Shtojca nr. 3)

## Materiali për punë:

### Shtojca nr. 1: Kartelat me detyra për nxënës

<p>Askush nuk mund të nënshkruajë kapitullimin e vendit, pa vendim të trupit më të lartë përfaqësues.</p>
<p>Mbi ndryshimin e kufijve vendosin qytetarët me referendum.</p>
<p>“Të gjithë gjykatësit të gjykojnë sipas ligjit, e drejtë e shkruar në ligj, e jo të gjykojnë sipas frikës nga mbretëria” (neni 172 i Kanunit të Dushanit)</p>
<p>“Ligji është i detyrueshëm për të gjithë, aristokracinë, familjen mbretërore dhe për vet mbretin” (sipas nenit 136 të Kanunit të Dushanit).</p>
<p>“Në mbretërinë time, zotëria nuk ka të drejtë që t’i bëjë keq çifçiu, përpos asaj që është shkruar në ligjin tim. Nëse bënë diçka kundër ligjit, mbretëria ime urdhëron që secili çifçi të ketë të drejtë për kontest me zotërinë e vet, ose me mbretërinë time dhe këdoqoftë. Askush të mos jetë i autorizuar ta ndalojë gjyqin e mbretërisë sime, por gjyqtarët duhet të gjykojnë drejt. Nëse çifçiu e fiton kontestin kundër zotërisë, gjyqtari i mbretërisë sime le t’i garantojë që t’ia paguajë në afat dëmshpërblimin, por zotëria të jetë i detyruar të mos i bëjë keq çifçiu.” (neni 139 i Kanunit të Dushanit)</p>
<p>Në pushtet vihet me zgjedhje që mbahen rregullisht çdo katër vjet.</p>
<p>Është shpallur tender për shitjen e fabrikës “Hipek”. Mediat kanë njoftuar se kush është paraqitur si blerës potencial, dhe cilat çmime janë ofruar. Gazetarëve u është mundësuar vrojtimi në gjithë dokumentacionin. Opinioni është informuar mbi procedurën e vendimmarrjes, mbi kriteret që janë marrë në konsideratë dhe mbi vendimin përfundimtar që fabrika t’i shitet Pavle Pavloviqit.</p>
<p>Liria e shtypit është e garantuar.</p>
<p>Puna e organeve të shtetit është e qasshme për opinionin.</p>
<p>Garantohet e drejta e pronës dhe liria e ndërmarrjes, në harmoni me Kushtetutën.</p>
<p>Garantohet liria e bashkimit dhe veprimit politik, sindikal etj.</p>

Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut është miratuar dhe proklamuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor të vitit 1948. Ka gjithsej 30 nene.

Këto janë disa nene:

Neni 12

Askush nuk mund t'i ekspozohet ndërhyrjes arbitrare në jetën private, familje, banesë ose këmbim letrash, as me atakime në nder dhe prestigj.

Neni 19

Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes, përfshirë edhe të drejtën që të mos shqetësohet për shkak të mendimit...

Neni 20

Secili ka të drejtë në lirinë e tubimit dhe bashkimit të qetë.

Liritë dhe të drejtat e njeriut janë të kufizuara vetëm me liritë dhe të drejtat e të tjerëve, dhe kur kjo është përcaktuar me Kushtetutë.

Komuna është njësi territoriale në të cilën realizohet vetëqeverisja lokale.

Pushteti legjislativ i takon Kuvendit Popullor. Pushteti ekzekutiv i takon Qeverisë. Pushteti gjyqësor u takon gjyqtarëve.

Fjala **kushtetutë** vjen nga fjala diga ose mburoja.

## Shtojca nr. 2: Kartelat me detyrat për mësimdhënës

**Vërejtje:** Krahasuar me kartelat nga kjo shtojcë, disa nga kartelat që u ndahen nxënësve janë thjeshtësuar. Pjesët që nuk përmbahen në kartelat për nxënës, janë treguar në këtë shtojcë me *shkronja të pjerrëta*.

Askush nuk mund ta nënshkruajë kapitullimin e vendit pa vendimin e trupit më të lartë përfaqësues.
Mbi ndryshimin e kufijve vendosin qytetarët me referendum.
“Të gjithë gjyqtarët të gjykojnë sipas ligjit, e drejtë e garantuar në ligj, e të mos gjykojnë sipas frikës nga para mbretërinë.” (neni 172 i Kanunit të Dushanit)
“Ligji është i detyrueshëm për të gjithë, aristokratët, familjen mbretërore dhe për vetë mbretin” (sipas nenit 136 të Kanunit të Dushanit).
“Në mbretërinë time, zotëria nuk ka të drejtë që t’i bëjë keq çifçiut, përpos asaj që është shkruar në ligjin tim. Nëse bënë diçka kundër ligjit, mbretëria ime urdhëron që secili çifçi të ketë të drejtë për kontest me zotërinë e vet, ose me mbretërinë time dhe këdoqoftë. Askush të mos jetë i autorizuar ta ndalojë gjyqin e mbretërisë sime, por gjyqtarët duhet të gjykojnë drejt. Nëse çifçi e fiton kontestin kundër zotërisë, gjyqtari i mbretërisë sime le t’i garantojë që t’ia paguajë në afat dëmshpërblimin, por zotëria të jetë i detyruar të mos i bëjë keq çifçiut.” (neni 139 i Kanunit të Dushanit)
Në pushtet arrihet me zgjedhje të cilat mbahen rregullisht çdo katër vjet.
Është shpallur tender për shitjen e fabrikës “Hipek”. Mediat kanë njoftuar se kush është paraqitur si blerës potencial dhe cilat çmime janë ofruar. Gazetarëve u është mundësuar vrojtimi në gjithë dokumentacionin. Opinioni është informuar mbi procedurën e vendimmarrjes, mbi kriteret që janë marrë në konsideratë dhe mbi vendimin përfundimtar që fabrika t’i shitet Pavle Pavloviqit.
Liria e shtypit është e garantuar.
Puna e organeve të shtetit është a arritshme (ka qasje ) për opinionin. (neni 10 i Kushtetutës së Serbisë).
Garantohet e drejta e pronës në harmoni me Kushtetutën dhe liria e afarizmit (neni 34 i Kushtetutës së Serbisë)

Garantohet liria e bashkimit dhe e veprimit politik, sindikal e tjetër edhe pa leje, me regjistrim në regjistër tek organi kompetent (Neni 44 i Kushtetutës së Serbisë).

Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut është miratuar dhe proklamuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor të vitit 1948. Ka gjithsej 30 nene.

Këto janë disa nene:

Neni 12

Askush nuk mund t'i ekspozohet ndërhyrjes arbitrare në jetën private, familje, banesë ose këmbim letrash, as me atakime në nder dhe prestigj.

Neni 19

Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes, përfshirë edhe të drejtën që të mos shqetësohet për shkak të mendimit...

Neni 20

Secili ka të drejtë në lirinë e tubimit dhe bashkimit të qetë.

Liritë dhe të drejtat e njeriut janë të kufizuara vetëm me liritë dhe të drejtat e tjerëve, dhe kur kjo është përcaktuar me Kushtetutë. (Neni 11 i Kushtetutës së Serbisë).

Komuna është njësi territoriale në të cilën realizohet vetëqeverisja lokale. (neni 7 i Kushtetutës së Serbisë).

Pushteti kushtetues dhe legjislativ i takon Kuvendit Popullor. Pushteti ekzekutiv i takon Qeverisë. Pushteti gjyqësor u takon gjyqtarëve.

Fjala **kushtetutë** vjen nga fjala diga ose mburoja

### Shtojca nr. 3: Mënyra e kufizimit të pushtetit (për mësimdhënës dhe nxënës)

#### MËNYRAT E KUFIZIMIT TË PUSHTETIT:

- 1.) **Sundimi i drejtësisë** (nënkupton sundimin e ligjit e jo të njerëzve, pra, respektimin dhe aplikimin e ligjit, dhe askush në shtet nuk mund të jetë mbi to dhe të qeverisë në kundërshtim me ligjet).
- 2.) **Ndarja e pushtetit.** Tri funksione të pushtetit- nxjerrja e ligjeve, zbatimi i tyre (respektivisht drejtimi i punëve të përbashkëta) dhe zgjidhja e kontesteve në shoqëri – ndahen dhe u jepen në dorë organeve të ndryshme: autorizimi për nxjerrjen e ligjeve ose pushteti legjislativ **Parlamentit**, respektivisht Kuvendit Popullor, zbatimi i tyre, **pushteti ekzekutiv (Qeverisë)** i cili edhe drejton sipas atyre ligjeve, kurse zgjidhja e kontesteve **pushtetit gjyqësor** apo gjykatave. Me ndarjen e funksioneve secila degë e pushtetit i kufizon dy të tjerat.
- 3.) **Rregullat dhe procedurat demokratike** (nënkuptojnë “rregullat e lojës” të cilat të gjithë duhet t’i respektojnë dhe në atë mënyrë rregullat dhe procedurat i kufizojnë ata në pushtet, që të mos mund të qeverisin jashtë atyre rregullave dhe procedurave).
- 4.) **Opinionit – Mediat** (mediat dhe opinionit publik paraqesin kufizimin dhe kontrollin e pushtetit me vetë faktin se janë “sy” që me vigjilencë i vëzhgojnë veprimet e pushtetit).
- 5.) **Shoqëria qytetare** (vetvetiu që vepron lirshëm dhe relativisht autonome në raport me shtetin – pushteti i shoqërisë qytetare paraqet kufizimin e pushtetit që ai të mos mund të përzihet në ekonomi, shkencë, kulturë etj).
- 6.) **Shoqëria civile** (vetorganizim i qytetarëve për realizimin e interesave dhe nevojave të ndryshme, me të cilat shteti nuk është i gatshëm ose nuk ka mundësi të merret, si dhe ndikimi aktiv në pushtetin që e ushtrojnë qytetarët, nëpërmjet iniciativës qytetare, petitionit, kontrollit të pushtetit dhe mënyrat tjera të ndikimit politik e jopolitik, paraqesin kufizimin e pushtetit).
- 7.) **Të drejtat e njeriut** (pasi që janë të garantuara edhe me shumë instrumente ndërkombëtare dhe me kushtetutë, e të mbrojtura me mekanizma të ndryshëm, pushteti nuk guxon t’i cenojë dhe së këndejmi paraqesin kufizimin e pushtetit).
- 8.) **Kushtetutshmëria** ose kufizimi kushtetues i pushtetit (“konstitucionalizmi”) e kufizon pushtetin me objektivat (me kompetencat që i janë ndarë me kushtetutë) dhe me mjetet (mënyrat të cilat prapë me kushtetutë mund t’i realizojë).
- 9.) **Pluralizmi social** (një numër i madh i shoqatave dhe organizatave që veprojnë në shoqëritë qytetare të pavarura nga shteti) dhe **politik** (sistemi me shumë parti) pengon që shoqërisë t’i imponohet një parim i organizimit ose madje monopoli i një partie, dhe me këtë paraqesin kufizimin e pushtetit.
- 10.) **Regjionalizimi dhe decentralizimi i pushtetit** (veçmas vetëqeverisja lokale) paraqesin kufizimin me atë që me decentralizimin është bërë përhapja ose shpërndarja e pushtetit në shumë qendra të vendosjes (në shkallë krahinore, rajonale, komunale) dhe me këtë është pamundësuar që gjithë pushteti të jetë i përqendruar në një qendër.

## **Punëtorja: NDARJA E PUSHTETIT**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtore është që nxënësit të njihen me njërin nga mënyrat e kufizimit të pushtetit – ndarjen e pushtetit.

### **DETYRAT:**

- Vënia në pah se ndarja e pushtetit është një nga mënyrat e kufizimit të tij
- Përvetësimi i dijenisë mbi ndarjen e pushtetit në ekzekutiv, gjyqësor dhe legjislativ
- Shpjegimi i kompetencave të secilit institucion (degët e pushtetit) dhe i mekanizmave të kufizimit të ndërsjellë

### **Materiali për punë:**

- Teksti “Kompetencat e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor” (Shtojca nr. 1)
- Kartelet me instruksione (Shtojca nr. 1)
- Skema “Ndarja e pushtetit si formë e kufizimit të pushtetit (Shtojca 2)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e nis orën duke i thirrur nxënësit të thonë çfarë është kreu e domosdoshme për luajtjen e një ndeshje (“të vërtetë”) të futbollit.

Përgjigjet shënohen në tabelë: lojtarët, trajnerët, gjyqtarët, publiku, mjeku, sigurimi, kushtet e motit, etj. Në qoftë se askujt nuk i kujtohen institucionet e futbollit, nevojitet që mësimdhënësi/mësimdhënësja t'i rikujtoj ato (FIFA, UEFA): Ato nxjerrin rregullat e lojës. Të bëhet mirë dallimi midis elementeve që janë të domosdoshëm, dhe atyre pa të cilat mundet, që vëmendja të fokusohet në të parët. Për shembull, ndeshja mund të luhet pa trajner, publik por është e pamundshme pa minimum të lojtarëve, gjyqtarëve, ekzistimin dhe respektimin e rregullave të caktuara.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja më tutje tërheq paralelen midis kushteve të domosdoshme për zhvillimin e ndeshjes së futbollit, dhe organizimit të pushtetit. Elementet e domosdoshëm komentohen:

- *institucionet e futbollit që nxjerrin rregulla të lojës*
- *lojtarët*
- *gjyqtarët*

Mësimdhënësi/mësimdhënësja përmend edhe shembujt e tjerë ku është e mundur të nxirren analogji të ngjashme, dhe i thërret nxënësit të mendojnë mbi këtë ose në orë (nëse ka kohë) ose në shtëpi. Shembujt janë: trafiku, zgjedhje për miss (bukuroshe), shkolla etj.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja përmend se analogjia midis shembujve të përmendur të ndarjes së roleve dhe të vlerave nga njëra anë, dhe ndarja e pushtetit në shtet nga ana tjetër, është jo e plotë dhe provizore, se nuk duhet kuptuar tekstualisht. Ajo që po e vërejmë këtu është domosdoshmëria se ekzistojnë rregullat (mbi të cilat u bë fjalë në orën e dytë) dhe të ndahen rolet, kompetencat – madje edhe sikur të luhej në ndeshje e futbollit. Aq më shumë, kjo është e domosdoshme kur është fjala për pushtetin...

Mësimdhënësi/mësimdhënësja inicion bisedën mbi kompetencat e degëve të caktuara të pushtetit në shtet, duke i pyetur nxënësit si i shohin ato. Pas kësaj, diskutimin e plotëson me



shpjegime të hollësishme të secilës nga këto degë të pushtetit, me ç’ rast si ndihmë i shërben teksti “Kompetencat e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor” (Shtojca nr. 1).

Vëmendje të veçantë u kushtohet *mekanizmave të kontrollit të ndërsjellë të disa degëve të pushtetit*.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e përfundon këtë hap duke ua rikujtuar nxënësve përfundimet më të rëndësishme tek të cilat kanë arritur.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i ndan nxënësit në katër grupe, dhe u thotë të rrinë në katër qoshe të ndryshme të klasës. Pastaj, secilit grup ia jep kartelën përkatëse me instruksione (Shtojca nr. 2) dhe u thotë ta lexojnë tekstin që e kanë marrë.

Kur nxënësit e lexojnë tekstin, u drejtohet me këto fjalë: “Të gjithë jeni njoftuar me nenet e Ligjit mbi punësimin në vendin e quajtur Qytetariana (emri i vendit është i trilluar dhe quhet ashtu sepse në të jetojnë qytetarët) dhe me faktin se Qeveria nuk ia ka dalë ta zbatojë. Mendoni edhe pak mbi problemin, dhe pastaj do të marrim pjesë në seancën e cila mbahet një vjet pas miratimit të ligjit.”

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i lut grupet që i përfaqësojnë anëtarët e Parlamentit dhe të Qeverisë, që të tubohen në mes të mësonjëtores dhe ta mbajnë seancën e përbashkët që është publike dhe në të cilën ata duhet të këmbëjnë qëndrimet dhe argumentet. Derisa anëtarët e Parlamentit e të Qeverisë diskutojnë në seancën e përbashkët, dy grupet tjera (gjykata kushtetuese dhe qytetarët) e përcjellin diskutimin.

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e ndërpret seancën në çastin kur argumentet dhe qëndrimet e të dy palëve janë të qarta, dhe thotë se “rasti” ka përfunduar në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata duhet të vërtetojë nëse janë të sakta pohimet e Qeverisë se Parlamenti e ka miratuar ligjin jo kushtetues.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e lut Gjykatën që ta mbajë seancën e fshehtë, kurse rekomandimi është që ata të largohen nga hapësira derisa diskutohet.

Derisa gjykata mban seancën, qytetarët kanë mundësi të thonë se çfarë mendojnë mbi këtë problem. (Në minutat e ardhshme Gjykata vendos paralelisht mbi rastin, kurse mësimdhënësi/mësimdhënësja ua jep fjalën nxënësve – qytetarëve të cilët e kanë mendimin e tyre.

Në vazhdim të aktivitetit fjalën e merr Gjykata e cila e kumton vendimin e saj.

### **Hapi pestë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Në pjesën përfundimtare të aktivitetëve, mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se kjo është njëra nga situatat e shumta, ku të tri palët iu përgjigjen thirrjes. Mbi të njëjtën çështje është lajmëruar edhe opinioni, dhe se qëllimi i aktivitetit ka qenë që të shihet se si njerëzit, nga pozicione të ndryshme, mendojnë ndryshe dhe deklarohen ndryshe. Për këtë shkak është e rëndësishme se pushtetet e ndryshme nuk mund të vendosin të pavarur dhe se duhet të kontrollohen mesveti. Për këtë pjesë të aktivitetit mund të jenë me dobi Shtojca nr. 1 dhe Shtojca nr. 3, të cilat iu duhen shpërndarë nxënësve.

Nëse ka kohë, skemën dhe tekstin e lexojnë dhe e komentojnë të gjithë.

## Materiali për punë:

### Shtojca nr. 1

#### KOMPETENCAT E PUSHTETIT LEGJISLATIV, EKZEKUTIV E GJYËSOR

Funksionet themelore të pushtetit janë nxjerrja e ligjeve, zbatimi i tyre (respektivisht drejtim i punëve të përbashkëta) dhe zgjidhja e kontesteve në shoqëri. Sikur të tri këto funksione të pushtetit do të përqendroheshin në duart e njëjta, atëherë pushteti do të ishte tiran ose diktatorial (“**Kadiu të padit, kadiu të gjykon**”). Për këtë shkak, këto tri funksione të pushtetit ndahen dhe u jepen në dorë organeve të ndryshme: autorizimi për nxjerrjen e ligjeve apo pushteti ligjdhënës- **Parlamentit**, respektivisht Kuvendit Popullor, zbatimi i tyre - **pushtetit ekzekutiv (Qeveria)** e cila qeveris dhe drejton sipas atyre ligjeve, kurse zgjidhja e kontesteve - **pushtetit gjyqësor** ose **gjykatave**. Sikurse që nënkupton edhe fjala jonë e urtë, qëllimi i fundit i ndarjes së pushtetit është që të **mbrohen liritë dhe të drejtat** e qytetarëve prej cenimit nga ana e pushtetit. Arma kryesore për këtë janë **kushtetuta** dhe ligjet. Së këndejmi, me kushtetutë definohehen të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve, si bartës të pushtetit suprem në demokraci (sovrانيتi popullor), e pastaj edhe të rregullohen raportet ndërmjet këtyre dy pushteteve, në mënyrë që asnjëri nuk do të prekte në fushën e tjetrit, dhe në atë mënyrë i ka përvetësuar dhe bashkuar në një dorë funksionet që duhet të mbeten të ndara.

Ky rregullim i raporteve të ndërsjella të tri degëve të pushtetit, ose ndarja e tyre, bëhet me kompetencat e ndryshme me të cilat pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor autorizohen me kushtetutë.

Kompetencat e pushtetit **legjislativ** janë:

- të miratojë kushtetutën dhe vendosë mbi zbatimin e saj
- të nxjerrë ligje (përfshirë tatimet dhe buxhetin)
- të zgjedh pushtetin ekzekutiv
- të kontrollojë pushtetin ekzekutiv (me anë të pyetjeve të deputetëve, me miratimin ose mosmiratimin e buxhetit e ngjashëm)
- të vendosë mbi ndryshimin e kufijve, luftën e paqen, ratifikon traktatet ndërkombëtare etj.

Kompetencat e pushtetit **ekzekutiv** (qeveria dhe kryetari i shtetit) janë:

- të udhëheqë politikën e shtetit dhe t’i kryejë ligjet e dispozitat
- të marrë vendime të përditshme për ekzekutimin e ligjeve dhe i zbaton direkt
- të propozojë kuvendit ligjet dhe dispozitat e tjera
- të paraqesë kuvendit buxhetin për konfirmim
- të formojë shërbime profesionale e tjera, për realizimin e kompetencave të veta
- të bëjë kontrollin mbi punën e ministrive dhe organeve të tjera të administratës

Kompetencat e pushtetit **gjyqësor**:

- mbron liritë dhe të drejtat e qytetarëve
- siguron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë
- zgjidh mosmarrëveshjet e palëve në kontest
- gjykon shkelësit e ligjeve

Pushtetit gjyqësor i është garantuar me kushtetutë, në veçanti autonomi dhe pavarësi nga dy pushtet tjera. Pasi që qëllimi i fundit është kufizimi i pushtetit, pra ashtu edhe ndarja e tij, garantimi dhe ruajtja e të drejtave dhe lirive elementare të qytetarëve, për këtë pavarësia e pushtetit gjyqësor është mekanizëm më i rëndësishëm me të cilën arrihet kjo.

Kompetencat e veçanta të **Gjykatës Kushtetuese**, si rojtare e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë:

- vendos mbi harmonizimin e ligjit dhe të dispozitave të tjera me Kushtetutën (kontrolli i akteve të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv)
- vendos mbi konfliktin e kompetencave midis organeve
- interpreton Kushtetutën

Mekanizmat e **kontrollit dhe të baraspeshës** së pushtetit:

Me këtë ndarje të kompetencave vendoset **baraspesha** midis tri degëve të pushtetit. Kjo, para se gjithash, nënkupton se secila e ka kompetencën e vet të caktuar me kushtetutë, dhe nuk guxon të marrë mbi vete autorizimet të pushteteve tjera, por edhe i mbron autorizimet nga përpjekja e dy pushteteve të tjera që t'i marrin. Kjo do të thotë se secila degë e verifikon dhe ushtron kontrollin e pushteteve të tjera, që siguron kufizimin e tyre të ndërsjellë. Kuvendi e kontrollon Qeverinë me vetë faktin që e zgjedh dhe shkarkon, si edhe në mënyrat e tjera të përmendura. Pjesë të veçanta të pushtetit ekzekutiv paraqet **kryetari** (presidenti) i republikës. Përpos funksionit të përfaqësimit të shtetit në botën e jashtme, kompetencat e tij paraqesin elementin e baraspeshës së pushtetit, e përbëhen nga këto: pas votimit të ligjit në Kuvend, kryetari e nënshkruan dhe me këtë e shpall, me ç' rast mund edhe të mos e nënshkruajë dhe t'ia kthejë Kuvendit në rivotim (kontrolli i pushtetit legjislativ). Mund të kërkojë nga Qeveria të sqarojë disa vendime të veta (kontrolli i pushtetit ekzekutiv). Kur zgjidhet në zgjedhjet direkt, ka fuqi të njëjtë ashtu si pushteti legjislativ, sepse është zgjedhur nga populli si edhe ai. Nga ana tjetër, pushteti legjislativ ka të drejtë të iniciojë shkarkimin e tij, nëse konsideron se e ka shkelur Kushtetutën.

Formë të veçantë të kontrollit të pushtetit paraqet Gjykata Kushtetuese, me anë të kompetencave të veta, e cila është e autorizuar të kontrollojë vendimet e të gjitha organeve tjera të pushtetit, lidhur me pajtueshmërinë e tyre me kushtetutën dhe ligjet, dhe me këtë i mban në kufijtë e kompetencave të tyre.

Megjithatë, edhe pse kompetencat i kanë të ndara dhe i kundërvihen njëra-tjetrës, këto degë të pushtetit e ushtrojnë **bashkë** funksionin e qeverisjes, që siguron **unitet të drejtimit** të vendit.

## Shtojca nr. 2: Kartelat me instruksione

1. Ju jeni **Parlament** - pushteti legjislativ i vendit Qytetariana. E keni votuar Ligjin mbi marrëdhëniet e punës, i cili pos të tjerash përmban këto nene:

*Neni 31*

*Të gjithë qytetarët duhet të jenë të arsimuar në momentin e themelimit të marrëdhënies së punës.*

*Neni 32*

*Ata që nuk janë të arsimuar janë të obliguar t'i vijojnë kurset për shkollim dhe ta japin provimin e arsimimit themelor në afatin prej një viti, nga dita e nxjerrjes së këtij ligji.*

*Neni 33*

*Pas skadimit të afatit të parashikuar me nenin 32 të këtij ligji, nuk do të mund të punësohet askush që nuk e ka të dhënë provimin e arsimimit – që është minimumi i përgatitjes shkollore për vendosjen e çfarëdo marrëdhënie pune.*

Një vit më vonë mbahet seanca e Parlamentit ku marrin pjesë edhe anëtarët e Qeverisë. Qeveria nuk e ka zbatuar Ligjin, analfabetizmi ka mbetur problem i Qytetarianës. Ju e kërkon dorëheqjen e ministrit të resorit (ministri për Punë dhe Çështje Sociale dhe ministri i Arsimit), e më radikalët, midis jush, edhe dorëheqjen e Qeverisë.

Detyra juaj është që të përgatiteni për seancë:

Çfarë do t'i thoni ministrit dhe anëtarëve të Qeverisë mbi punën e tyre?

Përse konsideroni se duhet të japin dorëheqje?

Argumenti juaj themelor është se Qeveria duhet ta realizojë ligjin, pra edhe këtë për të cilin është fjala. As ata nuk do të heshtin, prandaj përgatituni që t'ju përgjigjen.

2. Ju jeni **Qeveria** e vendit Qytetariana. Jeni të njohur me Ligjin mbi marrëdhëniet në punë, që e ka miratuar Parlamenti, i cili pos të tjerash parashikon:

*Neni 31*

*Të gjithë qytetarianët duhet të jenë të arsimuar në momentin e themelimit të marrëdhënies së punës.*

*Neni 32*

*Ata që nuk janë të arsimuar, janë të detyruar t'i vijojnë kurset për arsimim dhe ta japin provimin e arsimimit themelor në afatin prej një viti, nga dita e nxjerrjes së këtij ligji.*

*Neni 33*

*Pas skadimit të afatit të parashikuar me nenin 32 të këtij ligji, nuk do të mund të punësohet askush që nuk e ka të dhënë provimin e arsimimit – që është minimumi i përgatitjes shkollore për themelimin e çfarëdo marrëdhënie pune.*

Ju, si Qeveria, veçanërisht Ministria për Punë dhe Çështje Sociale dhe Ministria për Arsim, keni ndërmarrë çdo gjë që qytetarët të arsimohen në afatin e parashikuar: e keni bërë programin e shkollimit, i keni organizuar shkollat. U konstatua se kjo është më e vështirë sesa dukej në shikim të parë: Qytetarianët nuk duan të mësojnë, s'kanë kohë, konsiderojnë se kjo është e panevojshme...

Një vit më vonë mbahet seanca e përbashkët e Parlamentit dhe Qeverisë. Ju e dini se do të jeni “në bankën e të akuzuarve”, për shkak që nuk ia keni dalë ta realizoni programin e shkollimit. Përgatitni mbrojtjen tuaj në mënyrë të tillë që të dëshmoni se keni bërë gjithçka që është në fuqinë dhe kompetencën tuaj që ta realizoni ligjin. Pohoni se gjatë realizimit të ligjit keni hasur në pengesa të pakapërcyeshme, dhe nuk jeni fajtor që një numër i madh i qytetarëve duhet të pushohet nga puna, sepse nuk e kanë dhënë provimin e arsimimit. Kërkon ndryshimin e nenit 33 dhe vazhdimin e afatit për fitimin e arsimimit.

3. Ju jeni **qytetar** i vendit **Qytetaria**. Përcillni në televizion se çfarë po ndodh në vend, veçanërisht çfarë po bën pushteti.

Jeni të njohur me Ligjin mbi punësimin, të cilin e ka miratuar Parlamenti i Qytetarianës i cili pos të tjerash parashikon:

*Neni 31*

*Të gjithë qytetarianët duhet të jenë të arsimuar në momentin e themelimit të marrëdhënies së punës.*

*Neni 32*

*Ata që nuk janë të arsimuar janë të obliguar t'i vijojnë kurset për arsimim dhe ta japin provimin e arsimimit themelor në afatin prej një viti nga dita e nxjerrjes së këtij ligji.*

*Neni 33*

*Pas skadimit të afatit të parashikuar me nenin 32 të këtij ligji, nuk do të mund të punësohet askush që nuk e ka të dhënë provimin e arsimimit –që është minimum i përgatitjes shkollore për themelimin e çfarëdo marrëdhënie pune.*

Jeni të njohur me faktin se Qeveria nuk ia ka dalë në afatin e parashikuar ta realizojë programin e shkollimit elementar dhe se qytetarianët kanë mbetur analfabetë në numër të madh. Shumë nga ju keni mbetur pa punë, ose nuk mund të punësoheni sepse nuk dini shkrim e lexim.

Një vit më vonë mbahet seanca e përbashkët e Qeverisë dhe Parlamentit. Ju do ta shikoni transmetimin publik të asaj seance. Derisa e përcillni seancën, mendohuni për tërë problemin nga këndvështrimi juaj.

4. Ju jeni **Gjykata Kushtetuese** e vendit Qytetaria. Jeni të njohur me Ligjin mbi punësimin që e ka miratuar Parlamenti, i cili pos të tjerash parashikon:

*Neni 31*

*Të gjithë qytetarianët duhet të jenë të arsimuar në momentin e themelimit të marrëdhënies së punës.*

*Neni 32*

*Ata që nuk janë të arsimuar janë të obliguar t'i vijojnë kurset për shkollim fillestar dhe ta japin provimin e arsimimit themelor në afatin prej një viti nga dita e nxjerrjes së këtij ligji.*

*Neni 33*

*Pas skadimit të afatit të parashikuar me nenin 32 të këtij ligji, nuk do të mund të punësohet askush që nuk e ka të dhënë provimin e arsimimit –që është minimum i përgatitjes shkollore për vendosjen e çfarëdo marrëdhënie pune.*


Jeni të njohur me faktin se Qeveria nuk ia ka dalë në afatin e parashikuar ta realizojë programin e shkollimit fillestar dhe se qytetarianët kanë mbetur analfabetë në numër të madh. E keni marrë iniciativën për ngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit ku pohohet se Ligji është jo-kushtetues, se i shkel të drejtat e njeriut: ua shkurton njerëzve të drejtën për punë. Të drejtën për punë e kushtëzon me shkollimin elementar, shkel parimin themelor të barazisë së qytetarëve, etj.

- Ju mbani seancë dhe i përmbaheni kompetencës tuaj. Nuk ua veni veshin argumenteve të anëtarëve të Qeverisë respektivisht të Parlamentit, as që arbitroni midis tyre, por ekskluzivisht e vlerësoni nëse Ligji është kushtetues apo jo.

Kini parasysh se nuk mund ta tejkaloni kompetencën tuaj.

### Shtojca nr. 3

#### NDARJA E PUSHTETIT SI NJË NGA FORMAT E KUFIZIMIT TË PUSHTETIT



Raporti midis formave të ndryshme të pushtetit:  
baraspesha dhe kontrolli i ndërsjellë

## **Punëtorja: NOCIONI QYTETARI/QYTETARJA**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen me përcaktimin politik të nocionit qytetari/qytetarja.

### **DETYRAT:**

- dallimi dhe veçimi i përcaktimit të nocionit të nocionit qytetari/qytetarja nga domethëniet e tjera të këtij nocioni
- Kuptimi i përcaktimit politik të nocionit qytetari/qytetarja

### **Materiali për punë:**

- Teksti “Çfarë nënkupton fjala qytetar? (Shtojca nr. 1)
- Teksti “Kuptimi politik i qytetarit” (Shtojca nr. 2)
- Letër A 4 dhe stilolapsa

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Në fillim të orës mësimdhënësi/mësimdhënësja ua shpërndan nxënësve tekstin me definicionet e fjalorit të fjalës qytetar (Shtojca nr. 1) dhe kërkon nga nxënësit të mendohen mbi domethëniet e ndryshme të fjalës qytetar. Pasi u jep kohë të mjaftueshme që ta lexojnë tekstin, mësimdhënësi/ mësimdhënësja i fton nxënësit e caktuar, të thonë se cilat domethënie i kanë pasur të njohura e cilat jo, dhe në cilat domethënie ata e kanë shfrytëzuar deri më tani fjalën qytetar.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja pastaj vë në pah dy domethënie të fjalës qytetari/qytetarja, që paraqiten më së shpeshti.

1. Qytetari/qytetarja si banor i qytetit. Kjo është domethënie e ngushtë e nocionit, dhe për lëndën “Edukata qytetare” nuk është me rëndësi.

2. Qytetari/qytetarja si shtetas, respektivisht pjesëtar i një shteti. Kjo është domethënia politike e nocionit. Secili qytetar/qytetare i ka të garantuara me ligj të drejtat dhe liritë në shtetin në të cilin jeton. Në këtë domethënie, njerëzit që jetojnë në katund dhe njerëzit që jetojnë në qytet, njësoj janë qytetarë – bartës të të drejtave dhe lirive.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se të dy këto përdorime të fjalës qytetari/qytetarja janë të drejta, por për shkak të natyrës së lëndës “Edukata qytetare” në këtë punëtori kujdesi do të orientohet në domethënien politike të kësaj fjale.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja u thotë nxënësve se tani do të merren hollësisht me domethënien politike të nocionit qytetari/qytetarja, i cili për shumicën nga ata ndoshta është i ri dhe jo i njohur sa duhet.

Secili nxënës/nxënëse e merr tekstin “Nocioni politik i qytetarit” (Shtojca nr. 2), kurse mësimdhënësi/mësimdhënësja i lut nxënësit ta lexojnë me vëmendje. Gjatë leximit të tekstit,

nxënësit lypset që në marginat e tekstit të shkruajnë dy shenja të ndryshme (“+”, “?”) varësisht nga njohuria e tyre paraprake mbi atë për çfarë flet teksti. Nxënësi/nxënësja mund ta shënjojë një pasus të tërë, fjalinë ose vetëm ndonjë pjesë të saj. Simbolet që i propozon mësimdhënësi/ mësimdhënësja kanë këtë domethënie:

“+” - në qoftë se fjala mbi informatën është e re për ta.

“?”, - në qoftë se është fjala për informatën është e paqartë e cila i huton ose informata është e ndryshme nga ajo që kanë menduar se e dinë.

Nxënësit lexojnë individualisht dhe e shënjojnë tekstin. Në vazhdim të aktiviteteve, vëmendja u kushtohet atyre pjesëve të tekstit që i kanë shënuar nxënësit me “?”.

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Në grupe më të vogla, nxënësit i krahasojnë pjesët e tekstit që i kanë shënuar me “?”. Detyra e secilit grup është që, në bazë të analizës së këtyre pjesëve, të veçojë dy pyetje/dilema kyçe lidhur me tekstin që e kanë lexuar. Përfaqësuesit e grupeve i shkruajnë këto pyetje në pusulla dhe ia japin mësimdhënësit/mësimdhënëses.

Varësisht nga përmbajtja e pyetjes, mësimdhënësi/mësimdhënësja jep shpjegime të nevojshme, i fton nxënësit që ta paraqesin mendimin e tyre, ose ua kumton se përgjigjet në pyetjen e shtruar do t’i marrin në njërin nga orët e ardhshme.

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në këtë hap secili grup merr detyrë të hartojë një mesazh propagandistik në temën QYTETARI. Këto mesazhe të PE (propagandës ekonomike) duhet të flasin mbi atë përse është e dëshirueshme të jesh qytetar dhe çfarë fitohet me atë.

Ato u adresohen moshatarëve dhe duhet të shprehen me gjuhën e komunikimit për bashkëmoshatarë.



## Materiali për punë Shtojca nr. 1.

### ÇFARË DO TË THOTË FJALA: QYTETAR?

#### QYTETARI (SH. QYTEATRËT)=

**1. a. banor i qytetit, qytetar.** – Unë jam njeri qytetar i qytetit të njohur në Kiliki (nga Dhiata e Re, përkthim V. Karaxhiq). Qytetarët dhe bregdetasit, të gjithë lundrojnë, tregtojnë dhe garojnë (S. M. Ljubisha, 1875). Ne qytetarët, ende s’kemi mësuar të vuajmë për ushqim si katundarët (V. Novak, 1911). Tani më shumë pikëllues është bërë muhabeti se si qytetarët e qytetit tonë, verës vështirë e kanë të depërtojnë deri në Savë (S. Batushiq 3, 40) **b. Historik:** banor i **kështjellës, qytetit** – Vrapon Gjorgje nga qyteti në qytet, /Dhe qytetarët gjithkrah i thërret: /!Dëgjoni o ju turq qytetarë!/Në qytete hapni dyert” (Këngë popullore serbe, Vuka Karaxhiq), **c. historikisht, krahinore: myslimani banor i Nikshiqit.** – Në Mal të Zi të gjithë turqit e Nikshiqit quhen qytetarë: Dhe neve slivojanëve nga qytetarët po na ruajnë (V. Karaxhiq, Fjalori serb).

**2. vasal, shtetas, banor në përgjithësi (ndonjëherë edhe me drejtim të sjellshëm me emrin).** Donë që me anë të ligjit, nga ai të bëjë një qytetar të mirë (L. Lazareviq, 1899). Të gjithë do të bëhemi qytetarë, secili do të posedojë pjesë të barabartë të tokës (A. Kovaçiq, 1910). Është detyrë e edukimit moral që ta përgatisë fëmijën për njeri të ndershëm dhe qytetar të mirë (Napredak, 1901). Para ligjit të gjithë qytetarët serb janë të barabartë (S. Novakoviq, 1912). Nuk është i zoti t’i përmbush rolet e veta si qytetar në shoqëri (Mujori i shoqërisë juridike, 1926). Secili qytetar që është i aftë për veprim juridik, në përgjithësi, konsiderohet i aftë për zgjedhës (S. Jovanoviq, 1922).

**3. krahinor: emri ledhatues me të cilin nusja i drejtohet mashkullit të ri në familjen e burrit ose në fqinjësi.-** Nusët në Ribare me qejf duan t’ua japin ofiqet nga rinia: “qytetari” ose “qytetarja” (S. Trojanoviq, 1902). Nusja ia ngjet emrin kunatit: kunat, qatip, qytetar, zotëri, vëllaçko (S. Grbiq, 1909)

Shprehjet: *qytetar akademik (universitar) dëgjues i universitetit ose i ndonjë shkolle tjetër sipërore, student.* – Me këtë do të plotësohej dëshira që nëna vetëmbrojtëse (Alma) serbe të bëhet e fuqishme me numrin e qytetarëve të vet akademik (Porota, 1881). *qytetar i botës ai i cili tërë botën e konsideron atdhe të vetin, kurse të gjithë njerëzit bashkëqytetar të vet, kozmopolit.* - Unë jam qytetar i botës (S. Matavul, 1904).

(Përshtatur nga: FJALORI I GJUHËS LETRARE DHE POPULLORE SERBOKROATE,  
Libri III, Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve, Beograd 1965)

## Shtojca nr. 2

### NOCIONI POLITIK I QYTETARIT

Si **pjesëtar** i moshës madhore të një bashkësie politike **demokratike**, nën ligjit e së cilës jetoj, dhe në jetën e përbashkët të së cilës marr pjesë, unë jam **qytetar** i saj. Kjo ma mundëson **lirinë dhe të drejtat** që i posedoj dhe shfrytëzoj, **përgjegjësitë** që i marr dhe **detyrimet** që i përmbush.

Me ligjet e asaj bashkësie jam i **mbrojtur** nga dhuna dhe mashtrimi, më është garantuar **liria** e qarkullimit, e zgjedhjes së profesionit, e formimit të ndërmarrjes, e punës dhe e fitimit, si dhe ndërveprimi me të tjerët në kënaqjen e interesave dhe nevojave më të llojllojshme (thënë thjeshtë, jetoj **jetën** e lirë dhe autonome **qytetare**). Por kam edhe diçka më shumë: të drejtën të zgjedh dhe të ndikoj në pushtet, të organizoj fushatën politike dhe partinë, të bashkëpunoj në përcaktimin e kushteve të jetës së përbashkët (thënë thjeshtë, bëj **jetë politike**). Ky segmenti tjetër i cilësisë time të qytetarit, më bën **qytetar në kuptimin politik**, domethënë **shtetas**. E si qytetar/shtetas i një bashkësie të caktuar, kam edhe të drejta të tjera: të drejtën për shkollimin pa pagesë të fëmijëve të mi, për ndihmë sociale në rast të papunësisë, për mbrojtjen elementare mjekësore dhe shërim pa pagesë.

Por, kam edhe **përgjegjësi e detyrime** ndaj bashkësisë: të respektoj ligjin, të paguaj tatimin, ta shërbej afatin ushtarak. Vetëm **tërësia** e këtyre të drejtave dhe detyrimeve, ma siguron **pozitën ose statusin** i cili, si pjesëtar i bashkësisë demokratike, më bën qytetar.

Qytetari mund të jetojë në katund, në qytezë, qytet, rreth, krahinë. Qytetarët janë të këtij apo atij nacionaliteti, feje, race, profesioni, të varfër ose të pasur, të arsimuar ose paarsimuar, të punësuar ose papunësuar, të aftë ose të paaftë për punë, pjesëtarë të shoqatave dhe organizatave të ndryshme. Por megjithatë, pavarësisht nga numri i dallimeve midis tyre, të **gjithë** ne kemi të drejta dhe detyrimeve të **njëjta** ( nuk mund të jesh më pak a më shumë qytetar).

**Qytetarët** e zgjedhin pushtetin i cili nxjerr ligje dhe e drejton bashkësinë. Dhe vetëm qytetarët të cilët dinë si të marrin pjesë në qeverisje, janë të aftë t'i mbrojnë të drejtat e veta, dhe ta kontrollojnë pushtetin, duke shfaqur kujdes që pushteti të punojë në interesin më të mirë të mbarë popullit. Pa qytetar të tillë të **përgjegjshëm**, nuk ka as pushtet të përgjegjshëm.

Qytetari do të duhet:

- të respektojë ligjet e bashkësisë dhe të kontribuojë në prosperitetin e saj
- të respektojë të drejtat e tjerëve dhe të përmbushë detyrimet ndaj bashkësisë
- të fitojë dhe zhvillojë shprehi të tolerancës, ndjenjën e drejtësisë, kujdesin për të mirën e përgjithshme, dhe është i gatshëm për bashkëpunim
- të jetë **aktiv** dhe të angazhohet në caktimin e kushteve të jetës së përbashkët

## **Punëtorja: QYTETARËT/QYTETARET DHE RESPEKTIMI I LIGJIT**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i punëtorisë është që nxënësit të mendohen mbi rolin e ligjit në shtetin demokratik, dhe mbi rëndësinë e respektimit të ligjit si element të rolit të qytetarit/qytetares.

### **DETYRAT:**

- Gjetja e argumenteve për pikëpamjen që e përfaqëson
- Analiza dhe zgjedhja e argumenteve
- Përfaqësimi publik i qëndrimeve
- Praktikimi i teknikave dhe shkathtësive teknike

### **Materiali për punë:**

- Letra A 4
- Lapsa
- Përgatitja për debat (Shtojca nr. 1)
- Mbishkrimet “Pajtohem” dhe “nuk pajtohem”
- Teksti “A mundet individi ta shkelë ligjin në mënyrë demokratike në demokraci?”

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

#### **Vërejte:**

Përshkrimi i aktivitetit që pason, ka të bëjë me organizimin e dy orëve të njëpasnjëshme, nga të cilat njëra është përgatitore e tjetra është ora e organizuar në formë debati. Është rekomandim për mësimdhënësin se nëse këtë e lejojnë rrethanat, të organizojë dy-orëshin (90 minuta).

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në dy muret e kundërta të klasës, mësimdhënësi/mësimdhënësja e var mbishkrimet “pajtohem” dhe “nuk pajtohem”. Pastaj u kumton nxënësve se do t’ua lexojë 10 pohime të cilat shprehin mendime të ndryshme lidhur me ligjet, kurse detyra e tyre do të jetë që për secilin nga pohimet ta tregojnë nëse pajtohen ose jo me atë. Pajtimin ose mospajtimin e vet me pohimin, nxënësit e shprehin duke iu afrohen murit ku gjendet mbishkrimi përkatës. Kur nxënësit grupohen, mësimdhënësi/mësimdhënësja i fton nga disa përfaqësues prej secilit grup që ta arsyetojnë qëndrimin e tyre (të cekin argumentet për pajtim, respektivisht mospajtim me pohimin).

#### **Vërejte:**

Procedura e njëjtë përsëritet për secilin pohim. Nxënësit ndërmjet leximit të pohimeve mbeten në grupet e formuara, dhe kthehen në vendin e vet vetëm pas përfundimit të aktivitetit.

1. Ligjet bëjnë pjesë në të arriturat më të mëdha të njerëzimit
2. Mosrespektimi i ligjit e çon vendin në kaos dhe rrënim.
3. Nuk ka kurrfarë të keqe dhe është krejt e natyrshme nëse njeriu kohë pas kohe e shkel ligjin.

4. Individu i cili nuk do t'i respektojë ligjet, është i dëmshëm për çdo shoqëri.
5. Njeriu duhet t'i respektojë vetëm ato ligje të cilat i duken të arsyeshme.
6. Është e arsyeshme shkelja e ligjit për mbrojtjen e principit të rëndësishëm, ose mbrojtjen e interesave jetike

Kur nxënësit i paraqesin argumentet për pohimin e fundit, mësuesi/ mësuesja ua kumton se në vazhdim të orës do të merren pikërisht me këtë temë.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 25 minuta)

Në hapin vijues mësuesi/mësuesja i lut nxënësit të imagjinojnë se janë pjesëmarrës në debatin publik, që organizohet në TV lokal. Tema e debatit publik është A DUHEN RESPEKTUAR EDHE LIGJET TË CILAT NA DUKEN TË KËQIJA? Mësuesi/ mësuesja i njofton nxënësit se në këtë orë, vetëm do të përgatiten për debat publik, kurse debati në studion e TV do të mbahet orën tjetër.

Nxënësit pastaj ndahen në tri grupe (A, B, C) të cilët sistemohen në tri qoshe të mësonjëtores. Mësuesi/mësuesja i njofton mbi detyrat që i kanë, ashtu që të gjitha grupet e dinë çfarë është detyra e secilit nga ato.

Grupi A ka detyrë që, në debatin publik, të ndërojë dhe ekspozojë argumentet për qëndrimin se qytetarët duhet t'i respektojnë të gjitha ligjet, pra edhe ato që nuk iu duken të mira dhe të drejta dhe se, sikur qytetarët të mos i respektonin ligjet, të cilat i konsiderojnë të padrejta ose të parregullta, kjo do ta çonte vendin në rrënim dhe do t'i rrezikonte themelet e demokracisë.

Grupi B ka rolin e vëzhguesit, anëtarët e tij janë “gjyqtarë”, ata e përcjellin debatin dhe vlerësojnë se cila nga palët në debat, e ka argumentuar tezën e vet më me sukses.

Ata do të merren me atë çfarë është e mirë në argumentimin që e ka paraqitur një grup, dhe çfarë duhet avancuar.

Në vazhdim të aktivitetit, mësuesi/mësuesja ua shpërndan grupeve A dhe B shtojcën “Përgatitja për debat” (Shtojca nr. 1). Me këtë rast ai/ajo thekson se përgatitja për debat, zakonisht zhvillohet sipas procedurës së caktuar, dhe se njëri nga ato procedura e kanë të përshkruar në shtojcën që e kanë marrë, dhe i rikujton se këto procedura veç i kanë shfrytëzuar. Detyra e të dy grupeve është që, deri në fund të orës në përgatitje, të kalojnë hapin prej 1 deri në 3, respektivisht ta përpilojnë listën e argumenteve për qëndrimin që e mbrojnë, dhe listën e kundër-argumenteve të mundshme për pozicionin e kundërt.

Grupi C merr detyrën të mendohet mbi atë çfarë e bën argumentimin të fortë ose të dobët. Anëtarët e këtij grupi duhet të përcaktojnë kriteret, në bazë të së cilave do t'i vlerësojnë argumentimet e të dy grupeve që marrin pjesë në debat. Nxënësit e cekin fillimisht atë çfarë mendojnë se është veçori e argumentimit të mirë, rreth së cilit pajtohen, p.sh. numri i argumenteve të cekura: relativiteti i argumentit/kundër-argumentit, pra nëse ka të bëjë me pohimin e shqiptuar ose jo; a e shpreh faktin objektiv ose qëndrimin subjektiv e ngjashëm si kjo.

Mësuesi/mësuesja, gjatë kësaj pjese të aktivitetit, i frekuenton grupet dhe i nxit ata t'i japin kuptim argumentimit për pikëpamjen që e përfaqësojnë, kurse grupi C ndihmon t'i formulojë kriteret për vlerësimin e suksesit të argumentimit të pozicionit, të cilin e përfaqësojnë përfaqësuesit në debat.

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Në fund të orës, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja ua tërheq vërejtjen nxënësve të mbajnë mend në cilat grupe janë përgatitur për debat, sepse në orën tjetër do ta vazhdojnë punën në formacion të njëjtë.

Gjithashtu nevojitet të rikujtohen nxënësit e grupit A dhe B që ta ruajnë listën me argumente/kundër argumente për orën e ardhshme, e mund t'u jepet edhe detyra që deri në orën e ardhshme t'i lexojnë tekstet përkatëse mbi këtë temë, me qëllim të gjejnë argumente shtesë për pikëpamjen që përfaqësojnë.

Nxënësit nga grupi C, duhet rikujtuar se kriteret për notimin e argumentimit në debat, tek të cilët kanë ardhur në punë e përbashkët, gjithashtu do t'i shfrytëzojnë në orën e ardhshme.

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Në fillim të orës së ardhshme, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i fton nxënësit që të tubohen sërish në grupe të njëjta në të cilat janë përgatitur në orën e përparshme. Në grupet A e B, nxënësit e studiojnë listën e argumenteve që e kanë përpiluar. Pastaj, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i lut që në kuadër të grupeve të veta, të merren vesh mbi atë se kush janë tre anëtarët e grupit të tyre, që do të parashtrojë argumentet deri tek të cilët kanë ardhur bashkë.

Derisa nxënësit përgatiten për debat, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i rend në mes të mësonjëtores karriget për mysafirët e ardhshëm në studio – pjesëmarrësit në debat (grupet që i përfaqësojnë pikëpamjet e kundërta në studio janë ulur përballë njëri- tjetrit) dhe të gjithë të tjerët që e përbëjnë publikun (që janë ulur nga njëra anë).

### **Hapi pestë**

(Kohëzgjatja: 25 minuta –nga 10.12 minuta për secilin nga dy grupet)

Mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i lut nxënësit të sillen sikur vërtetë gjenden në ndonjë studio TV. Ai/ajo ka rolin e drejtuesit të emisionit TV, i cili “shikuesve pranë ekraneve të vogla” ua prezanton mysafirët dhe temën e debatit, dhe i kumton rregullat e debatit.

Grupi A e B do të kenë mundësi ta ekspozojnë pikëpamjen e tyre në tre rrahë nga 3 minuta: më parë përfaqësuesi i grupit A i ekspozon argumentet për qëndrimin se qytetarët duhet t'i respektojnë të gjitha ligjet, pra edhe ato që nuk u duken të mira e të drejta, dhe e argumentojnë ekspozenë për aktivizëm qytetar. Në tre minutat e ardhshëm, qëndrimin e kundërt e arsyeton grupi B.

Në rrethin e dytë, përfaqësuesit e grupeve (më parë A, pastaj B) theksojnë kundërargumentet për qëndrimet që kanë dëgjuar nga kundërshtarët.

Në fund, përfaqësuesit e grupeve e bëjnë rezymenë e argumenteve të veta.

Gjatë debatit mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja tregon kujdes në renditjen e ekspozëve, mbi kohën që një diskutues e ka në dispozicion (maksimalisht 3 minuta).

Vëzhguesit (grupi C) secili për vete, shënojnë anët e mira e të këqija të argumentimit të ofruar, sipas kriterëve të përcaktuara. Pas debatit të përfunduar, ato i kumtojnë gjetjet e veta në formën që e ekspozon drejtuesi i emisionit:

Në argumentimin e grupit A, ishte mirë ...por do të mund të avancohet...

Në argumentimin e grupit B, ishte mirë...do të mund të avancohet...

## **Hapi gjashtë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja në pjesën përfundimtare të punëtorisë ua shpërndan nxënësve tekstin “A mundet individi të shkelë në mënyrë legjitime ligjin në demokraci?” (Shtojca nr. 2) dhe me nxënësit zhvillojnë bisedë mbi atë çfarë kanë mësuar për arsyet e respektimit të ligjit në shoqërinë demokratike, dhe mbi anët e mira e të këqija të mosbindjes qytetare.

## **Materiali për punë:**

### **Shtojca nr. 1 (për nxënës)**

#### **Përgatitja për debat**

Grupet përgatiten për debat të ndarë, dhe zakonisht përgatitja për debat zhvillohet sipas procedurës së përcaktuar. Në rastet më të shpeshta ndiqen këto hapa:

1. **KRIJIMI I IDESË** - Secili person në grup duhet të shkruajë në heshtje për vete, sa më shumë gjëra lidhur me temën/problemin që i bie ndërmend: argumentet, shembujt dhe kundër argumentet e mundshme me të cilat do të paraqitet pala tjetër.
2. **LISTA E PRIORITETEVE** – Kur secili anëtar i grupit e përpilon listën e vet të ideve, pason këmbimi në nivel të grupit. Të gjithë me radhë i paraqesin propozimet e veta. Diskutohet pesha relative e secilit argument të paraqitur, dhe nëse shumica në grup deklaron sa ai është i fuqishëm, duhet të ruhet. Në të kundërtën nëse të gjithë pajtohen se është tepër i dobët, argumentet hidhen poshtë. Rekomandohet orientimi i grupit në gjetjen e argumentimit më të mirë, si dhe të shembujve që do ta forcojnë, e jo fokusimin në vlerësimin e kujt, cili, argument është. Kur është përpiluar lista e argumenteve, kalohet në **NDARJEN E ROLEVE**: Përpunohet në hollësi mbi çfarë do të flasë secili anëtar i grupit, dhe me cilën renditje do të ekspozojë.
3. **PËRGATITJA INDIVIDUALE PËR PREZANTIM** – Secili folës duhet ta përpilojë konceptin e vet si do të ekspozojë në debat. Në këtë fazë rekomandohet shkrimi i konceptit në formë të **FJALIMIT** final, veçse kjo rezime e planifikuar mund të dallohet më vonë nga vetë paraqitja, që do të varet nga rrjedha konkrete e vetë debatit dhe argumenteve, dhe nga paraqitja e anëtarëve të tjerë. Në këtë kuptim, duhet të jenë fleksibël, por megjithatë të skicohet renditja me të cilën paraqiten argumentet, cilat janë dobësitë potenciale të asaj që dëshirohet të kumtohet...Të tregohet kujdes mbi gjatësinë e ekspozesë dhe mbi strukturën. Me fjalë tjera, në minutën e parë zakonisht ekspozohet esenca e asaj që dëshirohet të thuhet, kurse në minutën e fundit, bëhet përmbledhja e argumenteve. Folësi mund të mendojë mbi përfundimin e rastit, për të lënë mbresë me fjalimin e tij në formën e ndonjë citati relevant ose fjalie përmblylëse.
4. **KONFIRMIMIT E TË DAKORDUARËS** – Në fund i tërë grupi kalon nëpër konceptin final të ekspozesë, planit të debatit, duke vështruar faktin si është definuar tema, në ndarjen e roleve, dhe krejt çfarë është planifikuar ta kumtojë grupi, me planifikimin e strategjisë globale të paraqitjes grupore dhe individuale.

## **Shtojca nr. 2 (për nxënës)**

### **A mundet individi ta shkelë në mënyrë legjitime ligjin në demokraci?\***

Mosbindja qytetare - shkelje publike dhe pa dhunë e ligjit për hir të mbrojtjes së ndonjë parimi apo interesi jetik - e ka vendin e nderit në historinë e demokracisë. Ajo mund të dallohet nga shkelja kriminale e ligjit me transparencën e vet, me objektivat e veta politike dhe me faktin se ata që marrin pjesë në të nuk orvatën t'i shmangen gjykimit apo dënimit për kundërvajtjet e veta. Objektivi i mosbindjes qytetare zakonisht është që të tërheqë vëmendjen ndaj ndonjë padrejtësie apo keqpërdorimi që e kanë bërë pushtetet publike ose trupat të fuqishme private, për të sjellë ndryshimin e politikës në rastet kur metodat e tjera të publicitetit dhe të bindjes janë treguar joefektive. Disi më rrallë, objektivi i saj është që masat që e kanë nxitur, t'i bëjë të perealizueshme me anë të organizimit të rezistencës masive. Mirëpo, pasi kështu shkelet parimi i reciprocitetit me të cilin në demokraci mbështetet pajtimi me ligjin, kjo masë duhet shqyrtuar vetëm në rastet e jashtëzakonshme, por edhe atëherë vetëm si rrugëdalja të fundit.

#### **Integriteti i ligjit**

Kritikët e mosbindjes qytetare pohojnë se shkelja e ligjit kurrë nuk mund të jetë e justifikueshme. Ligji është baza e shoqërisë së civilizuar dhe në qoftë se një person apo grup e shkel, kjo vetëm nxit dhe tjerët të veprojnë njëjtë. Sikur secili të zgjidhte se cilat ligje do t'i respektonte, korniza ligjore nga e cila varemi të gjithë, do të shkatërrohej shpejt. Aq më tepër, në shoqëritë demokratike njerëzit kanë në dispozicion rrugët kushtetuese me anë të së cilave mund t'i ndërrojnë ligjet: votimi në zgjedhje, lobimi i përfaqësuesve, fushatat e ligjshme të bindjes së qytetarëve dhe të qeverisë për domosdonë e ndryshimit të ligjit apo të politikës mbi të cilat është fjala. Vet akti i pjesëmarrjes në zgjedhje shënjon pajtimin me epilogun, si dhe pajtimin që të përqafohet ajo për të cilën është angazhuar pala fitimtare. Mosbindja qytetare kështu paraqet fyerjen jo vetëm të sundimit të drejtësisë por edhe të demokracisë.

#### **Ligji dhe drejtësia**

Kritikët e mosbindjes qytetare pohojnë se shkelja e ligjit kurrë nuk mund të jetë e justifikueshme. Ligji është baza e shoqërisë së civilizuar dhe në qoftë se një person apo grup e shkel, kjo vetëm nxit dhe tjerët të veprojnë njëjtë. Sikur secili të zgjidhte se cilat ligje do t'i respektonte, korniza ligjore nga e cila varemi të gjithë, do të shkatërrohej shpejt. Aq më tepër, në shoqëritë demokratike njerëzit kanë në dispozicion rrugët kushtetuese me anë të së cilave mund t'i ndërrojnë ligjet: votimi në zgjedhje, lobimi i përfaqësuesve, fushatat e ligjshme të bindjes së qytetarëve dhe të qeverisë për domosdonë e ndryshimit të ligjit apo të politikës mbi të cilat është fjala. Vet akti i pjesëmarrjes në zgjedhje shënjon pajtimin me epilogun, si dhe pajtimin që të përqafohet ajo për të cilën është angazhuar pala fitimtare. Mosbindja qytetare kështu paraqet fyerjen jo vetëm të sundimit të drejtësisë por edhe të demokracisë.

#### **Ndërgjegjja e individit**

Këto pikëpamje të ndryshme, nuk mund të zgjidhen lehtë duke iu referuar shqyrtimeve të përgjithshme. Shumë varet nga rrethanat konkrete të secilit rast, nga baraspesha midis parimeve kundërshtuese dhe nga vlerësimi i pasojave të secilit nga ata. Përfundimisht, këtë çështje mund ta zgjidhë vetëm individi vetë. Njëra nga fushat në të cilat rëndësia e ndërgjegjes të individit pranohet tani zyrtarisht, është e drejta për kundërshtimin e ndërgjegjes për shërbimin e afatit ushtarak; shumë shtete, me parashikimin e formave alternative të shërbimit e njohin forcën morale të një kundërshtimi të tillë.

---

\*Teksti është marrë nga libri: Dejvid Biten dhe Kevin Bojl, "Hyrje në demokraci", Kreativni centar (Qendra kreative), Beograd, 1997, 20-22.



## **Punëtorja: NJOHJA ME PUNËN E VETËQEVERISJES LOKALE**

### **OBJEKTIVI:**

Me anë të përvojës imediate të njiheni me punën e vetëqeverisjes lokale në mjedisin vetjak

### **DETYRAT:**

- frekuentimi i lokaleve ku zhvillohet puna e vetëqeverisjes lokale
- njohja me llojet e veprimtarisë që zhvillohen aty
- bisedë me bartësit e vetëqeverisjes lokale mbi punën e tyre

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e kontraktos takimin e nxënësve me përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale, dhe siguron frekuentimin e lokaleve ku zhvillohet puna e organeve komunale të pushtetit. Nikoqir do të duhej të ishte dikush që ka vullnet të mirë dhe kohë për t'i çuar nxënësit nëpër lokal, jep njoftime të nevojshme dhe u përgjigjet pyetjeve të tyre.

## **Punëtorja: SHOQËRIA QYTETARE DHE CIVILE**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të fitojnë dijeni elementare mbi shoqërinë civile dhe qytetare.

### **DETYRAT:**

- përcaktimi themelor i nocionit: shoqëri qytetare dhe civile
- njohja me raportet midis shoqërisë qytetare dhe civile

### **Materiali për punë:**

- teksti: “Shoqëria qytetare dhe civile” – versioni i shkurtër për nxënës (Shtojca nr. 1)
- teksti “Shoqëria qytetare dhe civile” – versioni i gjatë për mësimdhënës (Shtojca nr. 2)
- grafika “Raporti i shoqërisë qytetare dhe civile” (Shtojca nr. 3)
- letrat e paketimit dhe stilolapsat

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e paralajmëron temën e punëtorisë dhe u shpjegon nxënësve se nocionet shoqëri qytetare dhe civile mund të përdoren si sinonime. Sot është praktikë që midis këtyre nocioneve të bëhet dallimi prandaj mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet t’ua vë në pah nxënësve se objektivi i kësaj punëtorie që ta vërejë këtë dallim.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja në vazhdim të këtij aktiviteti ua shpërndanë nxënësve tekstin “Shoqëria qytetare dhe civile” (Shtojca nr. 1) duke i lutur që tekstin ta lexojnë me kujdes dhe t’i nënvizojnë informatat më të rëndësishme në të. Nxënësit individualisht e lexojnë dhe e nënvizojnë tekstin.

#### **Vërejte:**

Mësimdhënësi/mësimdhënësja për përgatitjen e mbajtjes së kësaj ore shfrytëzon tekstin (Shtojca nr. 2) që është më voluminoz dhe më i ndërlikuar nga ai që e marrin nxënësit.

#### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja në këtë pjesë të aktivitetit i ndan nxënësit në grupe më të vogla (më së shumti 3-4 anëtarë) dhe u thotë se detyra e tyre është që si grup të bëjnë rezymenë e tekstit të cilin e kanë lexuar, që duhet të përmbajë të gjitha informatat kryesore mbi shoqërinë qytetare dhe civile dhe të mos jetë më i gjatë se 10 fjali, e që me atë rast në të njëjtat grupe në mënyrë figurative të prezantojnë raportin midis shoqërisë qytetare dhe civile ashtu siç e kanë kuptuar ata. Mësimdhënësi/mësimdhënësja i nxit nxënësit për kreativitet dhe për tu shprehur.

## **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Pastaj secili grup e tregon vizatimin e vet dhe i ekspozon shkurt informatat kryesore që i kanë veçuar nga teksti. Mësimdhënësi/mësimdhënësja e bën rezymenë duke vënë në pah faktin se *Shoqëria qytetare*, domethënë, është shoqëri e qytetarëve të cilën e përbëjmë NE kur si individë, qytetarë ose pjesëtarë të shoqatave të ndryshme, grupeve, organizatave dhe institucioneve autonom dhe në bashkëpunim prodhojmë, krijojmë, blejmë e shesim, investojmë, vlerësojmë, simpatizojmë, argëtohemi, shpikim, hulumtojmë, mësojmë, besojmë, garojmë...gjithë këtë duke e bërë pa dhunë, me tolerancë, në mënyrë të civilizuar për kënaqjen e *nevojave dhe interesave private* nga më të ndryshmet në jetën (qytetare) e rregulluar bashkërisht.

*Shoqëria civile* ose *sektorit (jo-profit) civil*, është pjesë e shoqërisë qytetare, domethënë NE si individë dhe qytetarë e pjesëtarë të shoqatave të ndryshme, grupeve, organizatave dhe institucioneve, kur veprojmë vullnetarisht në *funkcion të së mirës së përgjithshme*, me anë të iniciativave qytetare dhe në kuadër të shoqatave të qytetarëve (organizatave joqeveritare). Kjo është ajo sferë me të cilën do të merremi në punën e mëtejshme në kuadër të lëndës “Edukata qytetare”.

### **Vërejte:**

Duke prezantuar dhe shpjeguar raportin ndërmjet shoqërisë qytetare dhe civile, mësimdhënësi/mësimdhënësja e shfrytëzon grafikën në të cilën ai raport është prezantuar në mënyrë figurative (Shtojca nr. 3) e pas ekspozesë fletët me vizatime ua shpërndan nxënësve.

## Materiali për punë:

### Shtojca nr. 1 (për nxënës)

#### SHOQËRIA QYTETARE DHE CIVILE

1. Shprehja “shoqëri qytetare” shfrytëzohet si shenjë për tërësinë e *veprimit të lirë* të njerëzve në fushat e ndryshme dhe për *institucionet e organizatat* e krijuara autonome (të pavarura nga shteti), (p.sh. bankat, ndërmarrjet, universitetet, shtëpitë botuese, kishat, klubet sportive etj.). Fushëveprimin e tyre, mënyrën e organizimit dhe të punës nuk e rregullon shteti dhe as që vendos për atë, por këto organizata dhe institucione e *rregullojnë në mënyrë autonome*, duke ndjekur objektiva të ndryshme që dëshirojnë t'i arrijnë. Bazën e kësaj autonomie (mëvetësie) e përbëjnë individët si *qytetarë të lirë* me të drejtat e tyre para se gjithash për jetë, pronë dhe liri). Këto të drejta u mundësojnë atyre të krijojnë dhe realizojnë planet e veta në jetë, pa imponime nga jashtë, të pavarur apo të *bashkuar*.

Falë posedimit të drejtave elementare të njeriut, të gjithë anëtarët e moshës madhore të shoqërisë qytetare janë të rritur për jetë të barabartë politike, tolerancë e bashkëpunim, me respektimin e rregullave të vendosura të sjelljes dhe veprimit. Me këtë janë krijuar premiset që qytetarët e bashkuar në shoqëri qytetare mund të ndërtojnë shoqëri dhe shtet *demokratik*, respektivisht *demokracinë përfaqësuese*.

Këtë shoqëri, megjithatë, e karakterizon raporti *pasiv* ndaj shtetit, sepse ajo kënaqet me faktin që shteti *ta lë rehat* dhe që si *institucion publik* të mos përzihet në punë *private*, interesa dhe veprimtari të qytetarëve të vet të lirë.

2. Me shtimin e ndërlikimit të shoqërisë moderne qytetare dhe me avancimin e demokracisë përfaqësuese në çerekun e fundit të shekullit të XX, u shtua nevoja për *aktivizim* më të madh të qytetarëve, për pjesëmarrje *politike* të shtuar dhe në këtë mënyrë me *demokratizimin e gjerë e të thellë*. Me këtë ka lindur edhe domethënia e ngushtë e shoqërisë qytetare me emrin *shoqëria civile* ose *veprimi civil shoqëror*. Ajo paraqitet si pasojë e faktit se demokracia përfaqësuese nuk është e mjaftueshme për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të rendit demokratik dhe se nevojitet të plotësohet me veprimin aktiv politik dhe me pjesëmarrjen e qytetarëve – me *iniciativat* qytetare. *Tërësia* e këtyre iniciativave qytetare dhe e veprimit civil e përbën *shoqërinë civile*.

Prandaj nga domethënia e gjerë e nocionit shoqëri qytetare duhet dalluar kjo domethënie e saj të ngushtë që ka të bëjë me veprimin shoqëror e politik të individëve, grupeve, shoqatave dhe organizatave me *ndikim* në pushtet, për *kontrollimin* e tij dhe pjesëmarrjen në zgjidhjen e problemeve shoqërore.

3. *Shoqëria qytetare* është, pra, shoqëri e qytetarëve të cilën e përbëjmë NE kur si individë, qytetarë, ose pjesëtarë të shoqatave të ndryshme, grupeve, organizatave dhe institucioneve, autonomë dhe në bashkëpunim me të tjerët prodhojmë, krijojmë, blejmë e shesim, investojmë, vlerësojmë, simpatizojmë, argëtohemi, shpikim, hulumtojmë, mësojmë, besojmë, garojmë ...gjithë këtë duke e bërë pa dhunë, tolerantë, në mënyrë të civilizuar, për kënaqjen e nevojave dhe interesave më të ndryshme private në jetën e rregulluar (qytetare) të përbashkët. *Shoqëria civile* është pjesë e shoqërisë qytetare, domethënë prapë NE, si individë qytetarë, pjesëtarë të shoqatave të ndryshme, grupeve organizatave dhe institucioneve, kur veprimi vullnetarisht në *funksion të së mirës së përgjithshme*, me anë të iniciativave qytetare dhe në kuadër të shoqatave të qytetarëve (organizatave joqeveritare). Kjo është ajo sferë me të cilën do të merremi në punën e mëtejshme në kuadër të lëndës “Edukata qytetare 3”.

## Shtojca nr. 2 (për mësimdhënës)

### SHOQËRIA QYTETARE DHE CIVILE

1. Historikisht, shoqëria qytetare është zhvilluar gradualisht me ndryshimet kulturore historike prej shekullit të XV deri në fund të shekullit XVIII, që kanë çuar në shkatërrimin e shoqërisë mesjetare dhe lindjen e shoqërisë dhe të shtetit modern. Karakteristika themelore e asaj shoqërie moderne (“qytetare”) është se është çliruar nga dominimi i kishës dhe shtetit të cilat janë “dëbuar” nga fusha e ekonomisë, shkencës, kulturës dhe jetës së përditshme dhe janë reduktuar në fusha të veta adekuate të religjionit, respektivisht të politikës. Shprehja “shoqëria qytetare” kështu nisi të shfrytëzohet si shenjë për tërësinë e *veprimit të lirë* të njerëzve në fusha të ndryshme dhe për *institucionet e organizatat* e krijuara autonome (të pavarura nga shteti) (p.sh. bankat, ndërmarrjet, universitetet, shtëpitë botuese, kishat, klubet sportive etj.). Fushëveprimin e tyre, mënyrën e organizimit dhe të punës më nuk e rregullon shteti dhe ai s’mund të për të, por këtë këto organizata dhe institucione e rregullojnë në mënyrë *autonome*, duke ndjekur objektiva të ndryshme të cilat dëshirojnë t’i arrijnë. Me çlirimin e njerëzve nga varësia feudale dhe përzierja e kishës në jetën e përditshme, individët nga vasalët u bënë *qytetarë* të lirë me të drejtat e veta (para se gjithash për jetë, pronë dhe liri). Ato të drejta u kanë mundësuar të krijojnë dhe realizojnë planet e veta në jetë pa imponime nga jashtë, të pavaruar ose të *bashkuar*.

Paralelisht me paraqitjen e shoqërisë demokratike të kuptuar në këtë mënyrë, ka ecur edhe kuptimi se ajo paraqet kalimin nga periudha e barbarizmit dhe e organizatës ushtarake, në shoqëri të *civilizuar* ose kulturore dhe shoqëri *civile* e jo të dhunshme të qytetarëve. Një shoqëri e tillë qëndron në mirësjelljen, qytetarinë, humanizmin dhe sjelljen tolerante të individëve dhe në *rregullat* e përbashkëta të sjelljes “së mirë” dhe paqedashëse. Falë posedimit të drejtave themelore të njeriut, të gjithë anëtarët e moshës madhore të shoqërisë qytetare janë rritur në jetë të barabartë politike, tolerancë dhe bashkëpunim, me respektimin e rregullave të instaluar të sjelljes dhe të veprimit. Me këtë janë krijuar premiset që qytetarët të bashkuar në shoqëri qytetare, mund të ndërtojnë shoqërinë dhe shtetin *demokratik*, gjegjësisht *demokracinë përfaqësuese*.

Këtë shoqëri, megjithatë, e karakterizon raporti *pasiv* ndaj shtetit, sepse ajo kënaqet me faktin se shteti e *lë rehat* dhe si institucion *publik* nuk përzihet në punë *private*, interesa e veprimtari të qytetarëve të vet të lirë.

2. Me shtimin e ndërlikimit të shoqërisë moderne qytetare dhe me avancimin e demokracisë përfaqësuese në çerekun e fundit të shekullit të XX, lindi nevoja për *aktivizim* më të madh të qytetarëve, për pjesëmarrje *logjistike* shtesë për *demokratizimin* e gjerë e të thellë. Me këtë ka lindur edhe domethënia e ngushtë e shoqërisë qytetare me emrin *shoqëria civile* ose *veprim civil shoqëror*. Ajo lind si pasojë e faktit se demokracia përfaqësuese nuk është e mjaftueshme për mbajtje dhe zhvillim të mëtejshëm të rendit demokratik dhe se nevojitet të plotësohet me veprimin aktiv politik dhe me pjesëmarrjen e qytetarëve – iniciativat qytetare. *Tërësinë* e këtyre iniciativave qytetare dhe të veprimit civil e përbën *shoqëria civile*. Në këtë kuptim deri tek *veprimi civil*, në formën e iniciativave qytetare, arrihet atëherë kur:

- a) institucionet ekzistuese të demokracisë përfaqësuese nuk janë të afta ose të gatshme t’u përgjigjen nevojave dhe kërkesave të qytetarëve dhe t’i kënaqin pritjet dhe mundësitë e shtuara të shoqërisë në mënyrë adekuate, ose
- b) kur shteti dhe pushteti tregojnë prirje për t’i shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut, përzihen në veprimin autonom në fushën ekonomike,


kulturore, shkencore, fetare ose ndonjë fushë tjetër të veprimit të lirë të qytetarëve dhe tenton t'ia nënshtrojë shoqërinë kërkesave dhe nevojave të veta, duke prishur rendin demokratik (siç ka qenë rasti në sistemet totalitare të fashizmit dhe komunizmit).

Prandaj, nga domethënia e gjerë e nocionit shoqëri qytetare duhet të dallohet kjo domethënie e tij e ngushtë që ka të bëjë me veprimin shoqëroro-politik të individëve, grupeve, shoqatave dhe organizatave me ndikim tek pushteti, tek kontrollimi i tij dhe i pjesëmarrjes në zgjidhjen e problemeve shoqërore. Meqë ajo nuk zhvillohet në asnjë fushë publike të shtetit, as në fushën private të shoqërisë qytetare por në fushën e angazhimit vullnetar për të mirën e përgjithshme, së këndejmi kjo sferë shoqërore quhet edhe sektori i “tretë” ose “jo-profit”. Shoqëria civile paraqet një resurs të konsiderueshëm ekonomik, kulturor dhe politik të shoqërisë: rezervuar i pashtershëm i aftësisë, përvojës, shkathtësisë, talentit, inovacionit, energjisë dhe dijes, si dhe është element i konsiderueshëm i avancimit dhe ruajtjes së demokracisë dhe lirisë.

*Shoqëria qytetare*, është pra shoqëri e qytetarëve të cilën e përbëjmë NE kur si individë, qytetarë ose pjesëtarë të shoqatave të ndryshme, grupeve, organizatave dhe institucioneve, autonome dhe në bashkëpunim prodhojmë, krijojmë, blejmë e shesim, investojmë, vlerësojmë, simpatizojmë, argëtohemi, shpikim, hulumtojmë, mësojmë, besojmë garojmë...krejt këto duke punuar pa dhunë, me tolerancë, civilizim për plotësimin e *nevojave dhe interesave* më të llojllojshme *private* në jetën e rregulluar (qytetare) e të përbashkët.

*Shoqëria civile ose sektori (jo-profit) civil* është pjesë e shoqërisë qytetare, pra NE si individë dhe qytetarë e pjesëtarë të shoqatave të ndryshme, grupeve, organizatave dhe institucioneve, kur veprojmë vullnetarisht në *funksion të së mirës së përgjithshme*, me anë të iniciativës qytetare dhe në kuadër të shoqatave të qytetarëve (organizatave joqeveritare). Kjo është ajo sferë me të cilën do të merremi në punën e mëtejshme në kuadër të lëndës “Edukata qytetare”.

RAPORTI I SHOQËRISË QYTETARE DHE CIVILE



## **Punëtorja: KARAKTERISTIKAT E SHOQËRISË CIVILE**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtore është që nxënësit të njihen më afër me karakteristikat e shoqërisë civile

### **DETYRAT:**

- të vrojtohet sesi shoqëria civile i ndërlidh të drejtat qytetare, iniciativat qytetare dhe opinionin
- vrojtimi si roli i shoqërisë civile është që ta plotësojë dhe kontrollojë shtetin

### **Materiali për punë:**

- Kartelat me detyra (Shtojca nr. 1). Ekzistojnë pesë kartela të ndryshme, të cilat duhet të kopjohen në mënyrë të tillë që secili nxënës të marrë nga një, kurse e gjithë klasa të ndahet në pesë grupe
- Lista e punës (Shtojca nr. 2)

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja ua kumton nxënësve se në këtë punëtori do të kenë për detyrë që të mësohen në rolin e qytetarëve të një komune, të cilët ballafaqohen me probleme të ndryshme shoqërore. Për çfarë problemi është fjala do ta mësojnë kur ta tërheqin kartelën, në të cilën është shkruar ai problem.

Pas kësaj, secili nxënës e merr kartelën ku është shkruar kush është ai dhe me cilin lloj të problemit shoqëror është ballafaquar.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja u thotë nxënësve se ata tani janë qytetarë të cilët janë ballafaquar me problemin e përshkruar në kartelën e marrë, dhe se nevojitet që të mësohen sa më shumë në rolin e personit të cilin ai problem e mundon shumë. Për ndihmë u janë drejtuar kryetarit të komunës, por nga ai kanë marrë këtë përgjigje:

“Qytetarët për arsye të ndryshme më drejtohen mua personalisht dhe Komunës. Çfarë t’ju them - e di se ekziston problemi ekologjik, se qytetarët janë të pakënaqur me mediat lokale, se janë të zemëruar për shkak të korrupsionit, se të rinjtë kanë kërkesat e vete; di për të gjitha këto probleme dhe shumë të tjera. Por as unë, as Këshilli ekzekutiv nuk jemi të gjithëfuqishëm, dhe prandaj kemi prioritete nga të cilat nuk mund të shmangemi. Këto janë gjëra të cilat ne duhet t’i zgjidhim tani. Ne, kur të mundemi, dhe nëse do të kemi mundësi, do të merremi edhe me këto probleme “tuajat”. Vërtetë s’kam çfarë t’ju them tjetër.”

#### **Vërejte:**

Kur mësimdhënësi/mësimdhënësja u drejtohet nxënësve nga roli i kryetarit të komunës, kjo duhet të jetë e qartë nga toni dhe mënyra e të drejtuarit.



## **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Pasi që nxënësit e dëgjuan deklaratën e kryetarit të komunës, mësimitdhënësi/ mësimitdhënësja u jep instruksion që të gjejnë bashkëmendimtarë, ata “që i brengos i njëjti hall”, që të grupohen dhe të bisedojnë për problemin e tyre të përbashkët (ata janë nxënës që e kanë tërhequr kartelën me të njëjtin problem). U thotë të mendohen se çfarë do të mund të bënin ata si qytetarë me këtë rast, dhe çfarë do të ishte me vend që të ndërmarrin.

Nxënësit në grupe, bisedojnë mbi temën që e kanë në kartelat e tyre dhe këmbejnë ide mbi angazhimin e mundshëm.

## **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimitdhënësi/ mësimitdhënësja i fton nxënësit ta imagjinojnë se janë bashkuar për të ndërmarrë diçka, dhe se më tutje do të konsiderojnë se çdo shoqatë është formuar për t’u zgjidhur problemet e caktuara. Secili nga pesë grupet e nxënësve e merr listën e punës – pyetësorin (Shtojca nr. 2)

Mësimitdhënësi/ mësimitdhënësja në vazhdim të aktivitetit i lut nxënësit që t’i plotësojnë pyetësorët e marrë, me vërejtjen se para se t’i përgjigjen pyetjes, të mendohen dhe diskutojnë mbi këtë në nivel të grupit.

## **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Në këtë pjesë të aktivitetit, përfaqësuesit e grupeve i njohin të tjerët me problemin e tyre, e pastaj secili grup i lexon përgjigjet e veta.

## **Hapi pestë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimitdhënësi/ mësimitdhënësja ua vë në pah nxënësve se në këtë aktivitet janë sjellë sipas modelit të shoqërisë civile – se e kanë dalluar rrezikimin e të drejtave të tyre, se janë bashkuar për t’i mbrojtur ato, se kanë pas qëllim të ndërmarrin aksionin publik, se i kanë bërë thirrje pushtetit për bashkëpunim dhe përgjegjësi në zgjidhjen e problemeve shoqërore. Bashkësia e gjerë shoqërore, gjithashtu është sferë e angazhimit qytetar. Ajo që po ndodh, ose do të duhej të ndodh në nivel lokal (“në planin mikro”), ndodh gjithashtu edhe në nivelin global shoqëror (“në planin makro”)

### **Vërejte:**

Është me rëndësi që mësimitdhënësi/ mësimitdhënësja në masë sa më të madhe t’u referohet përgjigjeve që i kanë dhënë grupet, e të cilat i forcojnë këto pohime.

Mësimitdhënësi/ mësimitdhënësja duhet t’ua vejë në pah nxënësve se shoqëria civile e mundëson iniciativën e pavarur të qytetarëve për tu marrë me çështjet me interes të përgjithshëm. Qytetarët e bashkuar e të organizuar i realizojnë objektivat më me sukses, se sa që mund ta bëjnë këtë individët e paorganizuar. Autoritetet (pushteti) demokratike e kuptojnë domethënien e shoqërisë civile për realizimin e nevojave të bashkësisë. Për këtë shkak, ato mbështesin shumë organizata jo-profite që merren me arsimimin, u ofrojnë ndihmë refugjatëve ose të varfërve e gjëra të ngjashme.

Shoqëria civile ka rol të madh edhe në kontrollin e pushtetit. Autoritetet jodemokratike shpesh e kufizojnë ose ndalojnë aktivitetin e shoqatave qytetare, veprimi i të cilave nuk ju pëlqen.

### **Hapi gjashtë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/ mësimdhënësja u jep instruksione nxënësve të imagjinojnë se është formuar Shoqata për ndëshkim fizik në shkollë, anëtarët e së cilës konsiderojnë “se dajaku ka dalë nga parajsa”, dhe se rinia e sotme është e “tillë” për shkak se kurrë nuk është ndëshkuar në mënyrë adekuate për kundërvajtjet e veta. Ose mund të jap instruksionin ta imagjinojnë se është formuar Asociacioni PËR punën e fëmijëve, i cili konsideron se ndalimi i punës së fëmijëve është i gabueshëm dhe i dëmshëm për zhvillimin e ekonomisë.

Në vazhdim të aktivitetit, mësimdhënësi/ mësimdhënësja e ngre debatin mbi format e përmendura ose të tjera të ngjashme të bashkimit, duke pyetur nxënësit nëse format e përmendura të bashkimit janë pjesë e shoqërisë civile. Mësimdhënësi/ mësimdhënësja thekson se nuk janë të lejueshme të gjitha aktivitetet rreth të cilave disa qytetarë dëshirojnë të bashkohen, dhe se këto raste të bashkimit kanë qenë të palejueshme, sepse ekziston ndalesa ligjore e ndëshkimit fizik në shkollë, dhe ndalimi i punës së fëmijëve.

Biseda mund të orientohet në argumentin nëse i duhet dhënë përparësi të drejtës për bashkim dhe t'i tolerojë shoqatat jo-tolerante e madje edhe agresive të qytetarëve (p.sh. Shoqata për luftën kundër “të huajve” për shkak se konsiderojnë se të gjithë “ardhacakët” i rrezikojnë resurset edhe ashtu modeste të komunës), ose i duhet dhënë përparësi sistemit të vlerave të cilin e bëjnë: barazia, toleranca, respektimi i të ndryshmes, e mira e përgjithshme. Në këtë rast këto dhe shoqata të ngjashme janë jo-legjitime dhe të papranueshme, sepse i rrezikojnë njerëzit e tjerë.

## Materiali për punë:

### Shtojca nr. 1

#### KARTELAT ME DETYRAT

<p>Ti je qytetar/qytetare i “vetëdijesuar ekologjikisht” që nuk do të pajtohesh me faktin se në afërsi direkte të lagjes tuaj, po ndërtohet deponia për të cilën dihet se është ndotëse e madhe, dhe se diçka e ngjashme nuk ndërtohet askund në botë pranë lagjes së qytetit, përkundrazi. Punimet janë në zhvillim e sipër dhe t’i konsideron se duhet të ndërmerret urgjentisht!</p>	<p>Ti je qytetar/qytetare e ndjeshme sepse në programin stacionit lokal TV ka gjithnjë e më shumë emisione në të cilat dominojnë dhuna dhe gjuha e urrejtjes. Banorët e visit tënd e përcjellin me rregull programin e TV lokal, dhe t’i konsideron se programi ekzistues ka ndikim të dëmshëm tek ta, e veçmas tek fëmijët. Dëshiron të ndërmarrësh diçka...</p>
<p>Ti je djalë/vajzë që konsideron se të rinjtë në komunën tuaj s’kanë mundësi ta kalojnë kohën e lirë në mënyrë cilësore. Hapësira e Shtëpisë lokale të kulturës, është rrënuar tërësisht dhe lënë pas dore. Keni ide të mrekullueshme: doni të inicioni teatrin e rrugës, Internet kafenë, skenën muzikore, seminare të ndryshme për të rinjtë. Konsideron se diçka duhet ndërmarrë...</p>	<p>Ti je qytetar/qytetare që e ka provuar vetë se pa “lidhje” dhe pa “ryshfet” (mito) njeriu nuk mund të kryejë punë në institucionet kompetente: as në Shtëpinë e shëndetit, as në gjykatë, as në komunë. Ti nuk pajtohesh me faktin se “aty nuk mund të ndryshohet asgjë”...</p>
<p>Ti dhe familja jot keni ardhur këtu në vitin 2000, dhe jeni vendosur. E ke statusin e personit të zhvendosur intern nga Kosova. Kjo nënkupton një varg problemesh: arrin me vështirësi deri tek dokumentet, nuk mundesh të planifikosh në afat të gjatë për vete dhe familjen tënde: ku do të jetosh, ku do të shkojnë fëmijët në shkollë, çfarë do të punosh. Nuk je i vetmi me këtë problem.</p>	

## Shtojca nr. 2

### LISTA E PUNËS: SHOQËRIA QYTETARE

1. Jepni emrin e shoqatës tuaj
2. Formuloni saktë se për çfarë angazhoheni ju si shoqatë?
3. Cilën të drejtë tënden po orvatesh ta mbrosh?
4. Çfarë mund të ndërmerrni vetë?
5. Çfarë prisni nga kryetari i komunës/pushteti lokal?
6. . Edhe cilin do të orvateshit ta përfitonit, dhe si?
7. A është kjo për çfarë po angazhoheni, interes personal i juaji si individ, interes i juaj grupor, apo është e mirë e përgjithshme/publike apo të gjitha këto bashkë?
8. A jeni të interesuar që shoqata juaj të zgjerohet dhe të jetë fillim i aksionit të madh publik, apo më shumë do të doni që ajo të mbetet në rrethin tuaj të ngushtë? Përse?

## **Punëtorja: RAPORTI I SHOQËRISË CIVILE DHE SHTETIT**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të kuptojnë se ekzistojnë aktivitete të cilat i ndërmerr vetëm shteti, aktivitete që janë në sferën e shoqërisë civile, dhe ato që i takojnë fushëveprimit të tyre të përbashkët.

### **DETYRAT:**

- njohja me aktivitetet e shoqërisë civile dhe shtetit
- të vërejturit e raportit të shoqërisë civile dhe shtetit

### **Materiali për punë:**

- skema me rrethe (Shtojca nr. 1)
- kartelat me përshkrimet e aktiviteteve (Shtojca nr. 2)
- tabela me aktivitetet e renditura drejt (Shtojca nr. 3)
- përshkrimi i situatave problematike (Shtojca nr. 4)
- kartelat boshe
- dy letra të mëdha
- ngjitësi me stilolaps

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Para fillimit të aktivitetit, detyra e mësimit/mësimit është që t'ua rikujtojë nxënësve punëtorinë *Shoqëria qytetare dhe civile*, dhe në një copë të letrës së madhe ta vizatojë skemën që është shfrytëzuar në atë punëtori. Është me rëndësi që mësimit/mësimit t'ua përmendë nxënësve se në këtë skemë, në fokus do të jenë dy rrahë si dhe prerja e tyre, nga të cilët njëri është shënuar si “shteti” e tjetri si “shoqëria civile”.

#### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 20 minuta)

Mësimit/mësimit i ndan nxënësit në grupe të vogla, që secili grup të marrë disa kartela ku janë shkruar aktivitete të ndryshme shoqërore. Detyra e çdo grupi është që të përcaktohet se cilës nga tri fushat në vizatim i takojnë aktivitetet nga kartelat e tyre.

Prezantimi i punës grupore duket i tillë që përfaqësuesi i secilit grup e lexon aktivitetin nga kartela, jep arsytim të shkurtër për renditjen, dhe pastaj e ngjet kartelën në letër të madhe në një rrahë nga tri fushat (shteti, shoqëria civile dhe hapësira e prerjes së tyre). Mësimit/mësimit i komenton përgjigjet e nxënësve, duke pasur parasysh mënyrën e drejtë të renditjes së aktivitetit (Shtojca nr. 3).

Pas përfundimit të kësaj pjese të aktivitetit, mësimit/mësimit u cek nxënësve se aksionet e shoqërisë civile dhe të shtetit mesveti mund të jenë në kundërshtim, sikur që mund të jenë në raport bashkëpunues. Edhe në sektorin shtetëror, edhe civil, mund të gjejmë aktivitete që i mbështesim dhe aktivitete që nuk i miratojmë. (Në qoftë se shteti

zhvillon politikë diskriminuese ndaj qytetarëve të vet, që janë të racës tjetër në raport me shumicën, kurse organizatat e shoqërisë civile luftojnë kundër kësaj, kjo është një çështje, po nëse shteti zhvillon politikën e barazisë së gjithë qytetarëve, e disa qytetarë themelojnë shoqatën për luftën kundër bashkëqytetarëve të racës tjetër, kjo është çështje tjetër...)

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 20 minuta)

Në këtë pjesë të aktivitetit, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i ndan nxënësit në dy grupe të mëdha. Secili grup e ndan në dy nëngrupe nga të cilat, njëri përfaqëson shtetin e tjetri shoqërinë civile. Pastaj mësimitdhënësi/ mësimitdhënësjja secilit grup i jep përshkrimin e një situatë problematike: problemi i ndotjes në Pançevë ose problemi i kampeve të refugjatëve në Serbi (Shtojca nr. 4).

Nëngrupet e nxënësve që e përfaqësojnë shtetin, duhet të formulojnë propozime konkrete mbi temën *çfarë mund dhe duhet të bëjë shteti në këtë rast*, kurse dy nëngrupet tjera, mendojnë se *cilat janë mundësitë e shoqërisë civile*. Secila ide shënohet në pusullë të veçantë, kurse koha për këtë detyrë është 7 minuta. Pastaj nëngrupet marrin detyrën që në disa minuta të ardhshëm të shënojnë me yllka në pusulla ato *ide, në realizimin e të cilave mund të marrin pjesë edhe shteti edhe shoqëria civile*.


Mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i nxit pjesëmarrësit që ta komentojnë pamjen e pankartës së përbashkët me këto pyetje:

1. Kur i krahasoni në këto rrethe frekuencat e aktiviteteve të mundshme për zgjidhjen e këtij problemi, çfarë po vëreni?
2. Çfarë gjendet në fushën në të cilën përputhet rrethi i shtetit dhe rrethi i shoqërisë civile?

Mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja mbështetet në kundrimet e nxënësve, dhe e komenton se objektivi i këtij aktiviteti ishte që të dallohen qartë aktivitetet e shoqërisë civile, dhe aktivitetet e shtetit, por edhe të shikohet fusha e përbashkët në të cilën zhvillohet proceset dinamike të interaksionit të shoqërisë civile dhe shtetit. Në atë fushë edhe potenciali i madh për bashkëpunimin e shtetit dhe sektorit civil për zgjidhjen e problemit me interes të përgjithshëm dhe zhvillimi i raporteve demokratike.

**Materiali për punë**  
**Shtojca nr. 1**  
Skema me rrathët

SHOQËRIA CIVILE DHE SHTETI



**Shtojca nr. 2**

**KARTELAT ME AKTIVITETET SHOQËRORE**

Shpallja dhe zbatimi i zgjedhjeve
Nxjerrja e ligjit mbi statusin e refugjatëve
Fushata kundër drogës
Futja e Edukatës qytetare në shkolla
Ndihmesa refugjatëve
Drejtimi i politikës së jashtme
Kontrolli i zgjedhjeve
Gjykimi i të akuzuarve për korrupsion
Kontrolli i respektimit të drejtave të njeriut
Mbrojtja e të drejtave të njeriut
Aksionet ekologjike
Zbatimi i politikës sociale
Lëvizja për formimin e komunës së re: Vrçin
Caktimi i tatimit
Dogana
Punimi i rrugicave për personat me invaliditet
Përcaktimi i kufijve midis shteteve
Mbrojtja e kufijve të vendit
Iniciativa për shërbimin civil të afatit ushtarak



**Shtojca nr. 3: Tabela me aktivitetet shoqërore të renditura drejt**

AKTIVITETET	SHC	SH	SHC+SH
Shpallja dhe zbatimi i zgjedhjeve		✓	
Nxjerrja e ligjit mbi statusin e refugjatëve		✓	
Fushata kundër drogës			✓
Futja e Edukatës qytetare në shkolla		✓	
Ndihmesa refugjatëve			✓
Drejtimi i politikës së jashtme		✓	
Kontrolli i zgjedhjeve <sup>3</sup>	✓		
Gjykimi i të akuzuarve për korrupsion		✓	
Kontrolli i respektimit të drejtave të njeriut	✓		
Mbrojtja e të drejtave të njeriut		✓	
Aksioni ekologjik			✓
Zbatimi i politikës sociale		✓	
Lëvizja për formimin komunës së re: Vrçin	✓		
Caktimi i tatimit		✓	
Dogana		✓	
Punimi i rrugicave për personat me invaliditet			✓
Përcaktimi i kufijve midis shteteve		✓	
Mbrojtja e kufijve të vendit		✓	
Iniciativa për shërbimin civil të afatit ushtarak	✓		

<sup>3</sup>Kontrolli i zgjedhjes bën pjesë në aktivitetin e sektorit civil, kurse zbatimi i zgjedhjeve në aktivitetin e shtetit. Organet që i zbatojnë zgjedhjet janë **këshillat zgjedhore** (formacion i përhershëm të cilin e emëron komisioni kompetent zgjedhor dhe formacioni i shtrirë - përfaqësuesit e partive të cilat marrin pjesë në zgjedhje) dhe **komisionet zgjedhore** (komunale, republikane dhe federale). Shërbimet kompetente të komunës i mbajnë regjistrat zgjedhore.

### Shtojca nr. 3

#### PËRSHRIMET E SITUATAVE PROBLEMATIKE

**A)** Në Pançevë prej tridhjetë vitesh ekziston Industria kimike me tri fabrika:

Azotarën, rafinerinë dhe petrokiminë. Këto fabrika merren me prodhimin e plehrave artificiale dhe përpunimin e naftës e të derivateve të naftës, por me derdhjet e veta fizike e kimike e ndotin ajrin në Pançevë e rrethinë.

Emisionet e gazeve helmuese ndodhin befas, pa-kontroll, kryesisht natën gjë që tek qytetarët po ngjallë ndjenjën e rrezikimit dhe të pafuqisë. Deri më tani nuk janë siguruar filtrat e mbrojtës në oxhakët e fabrikave, as instrumentet për matjen e ndotjes së ajrit, as që janë punuar studimet shëndetësore mbi ndikimin e ndotjes në shëndetin e qytetarëve. Vetëm është vërejtur se po shtohet numri i fëmijëve me organet e sëmura të frymëmarrjes, si dhe numri i sëmurjeve kancerogjene.

---

**B)** Në të gjitha vendbanimet e qytetit, e diku edhe në të gjitha qytetet anembanë Serbisë, jeton numër i madh i personave të ikur dhe të zhvendosur në kampet e refugjatëve, në kushtet shumë të pavolitshme për jetë. Fëmijët nuk kanë kushte për lojë, shkollim dhe inkuadrim në jetën kulturore dhe shoqërore. Të rriturit kryesisht janë të papunë, dhe merren me stërshitjen e mallit dhe me punë krahu, të moshuarit nuk kanë mbrojtje adekuate shëndetësore. Kushtet higjienike janë nën çdo minimum, si edhe hapësira jetësore. Shumë nga njerëzit në kampe jetojnë nga ndihma sociale e cila nuk është e rregullt, dhe gjithnjë më e mjerueshme. Po shtohet numri i konflikteve midis njerëzve në kampe, si dhe vdekshmëria e të moshuarve. Disa kampe nuk kanë energji elektrike e ujë, dhe janë shumë larg nga vendbanimet. Tek shumë njerëz në kampe është gjithnjë më e shprehur ndjenja e pashpresës dhe mungesa e perspektivës jetësore.

## **Punëtorja: AKTIVIZMI QYTETAR - PRO E KUNDËR**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të zgjojnë të kuptuarit e rolit të qytetarit dhe domethënien e aktivizmit qytetar, dhe të shqyrtojnë motivet e atyre qytetarëve të cilët nuk/marrin pjesë aktive në jetën publike.

### **DETYRAT:**

- gjetja e argumenteve për pikëpamjet që i përfaqësojnë disa grupe
- analiza dhe zgjedhja e argumenteve
- përfaqësimi publik i qëndrimeve
- ushtrimi në mbështetjen e qëndrimeve dhe praktikimi i teknikave dhe shkathtësive komunikative.

### **Materiali për punë:**

- letra A 4
- lapsa
- përgatitja e debatit (Shtojca nr. 1)

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

#### **Vërejte:**

Përshkrimi i aktiviteteve që pasojnë, ka të bëjë me organizimin e dy orëve të njëpasnjëshme nga të cilat, njëra është përgatitore, kurse ora tjetër është organizuar në formën e debatit. Është rekomandim për mësimmshënësin se nëse këtë e lejojnë kushtet, të organizojë dy-orëshin (90 minuta).

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i njofton nxënësit se tema e orës është aktivizmi qytetar. I rikujton ata se kanë pasur rastin të mësojnë se shoqëria civile mundëson iniciativën e pavarur të qytetarëve në ushtrimin e çështjeve me interes të përgjithshëm, duke plotësuar, kontrolluar dhe kritikuar pushtetin. (Punëtorja *Karakteristikat e shoqërisë civile*).

Secili nxënës e merr nga një letër dhe laps, kurse mësimdhënësi/ mësimdhënësja i lut ata që gjatë pesë minutave të ardhshëm, ta shkruajnë hartimin në të cilin do të tregojnë se çfarë mendojnë ata mbi aktivizmin qytetar. Do ta shfrytëzojnë teknikën e “lapsit të nxehtë”, domethënë gjatë pesë minutave do të shkruajnë, pa u ndalur, gjithçka që u bie ndërmend për temën e dhënë.

#### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja thërret një nxënës/e i cili dëshiron, që ta lexojë hartimin e vet, e pastaj lut që punimin e vet ta lexojë edhe një nxënës/e i cili mbi aktivizmin qytetar ka qëndrim të kundërt, ose të paktën të ndryshëm nga ai që pikërisht e dëgjuan.

Pas leximit të hartimit, mësimdhënësi/mësimdhënësja konstaton se mbi këtë çështje edhe qytetarët kanë mendim të ndryshëm: disa konsiderojnë se nevojitet të angazhohen në zgjidhjen e çështjeve me interes të përgjithshëm, të tjerëve megjithatë nuk u intereson aktivizmi qytetar.

## Hapi tretë

(Kohëzgjatja: 25 minuta)

Në hapin pasues mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i lut nxënësit ta imagjinojnë se janë pjesëmarrës në debatin publik, që organizohet në stacionin lokal TV. Tema e debatit publik është “Aktivizmi qytetar pro dhe kundër”. Mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i njofton nxënësit se në këtë orë, vetëm do të përgatiten për debat publik, kurse debati në studion TV do të mbahet orën e ardhshme.

Nxënësit pastaj ndahen në tri grupe (A, B, C) të cilat renditen në tri qoshe të klasës. Mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i njofton ata mbi detyrat që i kanë, që të gjitha grupet e dinë çfarë është detyra e secilit nga ata.

Grupi A ka detyrë, që në debatin publik, ta përfaqësojnë qëndrimin se aktivizmi qytetar është i domosdoshëm për shoqërinë demokratike, domethënë t’i sajojë dhe ekspozojë argumentet për qëndrimin se është e domosdoshme që qytetarët të marrin pjesë aktive në jetën publike, se kjo është mënyrë sipas të cilës ata i realizojnë të drejtat e tyre, dhe se vetë demokracia mund të rrezikohet, në qoftë se qytetarët janë pasivë dhe të pa-interesuar për avancimin e shoqërisë demokratike, në të cilën jetojnë.

Detyra e grupit B është që të përfaqësojë qëndrimin e argumentuar se aktivizmi qytetar është i panevojshëm, se kanë të drejtë ata qytetarë të cilët udhëhiqen vetëm nga interesi i vet.

Ata do të merren me atë se çfarë është e mirë në argumentimin që e ka prezantuar një grup, dhe se çfarë duhet avancuar.

Në vazhdim të aktivitetit, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja, ua shpërndan grupeve A dhe B shtojcën “Përgatitja për debat” (Shtojca nr. 1). Me këtë rast ai/ajo thekson se përgatitja për debat, zakonisht zhvillohet sipas procedurës së caktuar, dhe se një nga ato procedura e kanë të përshkruar në shtojcën që e kanë marrë, dhe i rikujton se këtë procedurë veç e kanë shfrytëzuar. Detyra e të dy grupeve është që deri në fund të orës, t’i kalojnë hapat 1 deri 3 duke u përgatitur, respektivisht, ta përpilojnë listën e argumenteve për qëndrimin të cilin e mbrojnë dhe listën e kundër-argumenteve të mundshme për pozicionin e kundërt.

Grupi C merr detyrën të mendohet mbi atë se çfarë e bën argumentimin të fortë apo të dobët. Anëtarët e këtij grupi duhet t’i bëjnë kriteret në bazë të së cilëve do t’i vlerësojnë argumentet e të dy grupeve që marrin pjesë në debat.

Nxënësit më parë përmendin krejt çfarë mendojnë se është veçori e argumentimit të mirë në favor të ndonjë pohimi, e pastaj zgjedhin vetëm disa kriteret më të rëndësishme rreth të cilëve pajtohen, p.sh. numri i argumenteve të përmendura: rëndësia e argumentit/ kundër-argumentit, domethënë nëse ka të bëjë me pohimin e shqiptuar ose jo; a e shpreh faktin objektiv ose qëndrimin subjektiv, e ngjashëm.

Mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja gjatë kësaj pjese të aktivitetit, i frekuenton grupet dhe i nxit ata të ndërtojnë argumentimin për pikëpamjen që e përfaqësojnë, kurse grupin C e ndihmon të formulojë kriteret për cilësimin e suksesit të argumentimit të pozicionit që e përfaqësojnë pjesëmarrësit në debat.

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Në fund të orës, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja ua tërheq vëmendjen nxënësve që ta mbajnë mend se në cilat grupe janë përgatitur për debat, sepse në orën e ardhshme do të vazhdojnë punë në formacion të njëjtë.

Gjithashtu duhen rikujtuar nxënësit në grupin A dhe B, që t'i ruajnë listat me argumentet/kundër-argumentet për orën e ardhshme, e mund t'u jepet edhe detyra që deri në orën e ardhshme t'i lexojnë tekstet përkatëse mbi këtë temë, me qëllim që të gjejnë argumentimin shtesë për pikëpamjen që e përfaqësojnë.

Nxënësit nga grupi C, duhet rikujtuar se kriteret për notimin e argumentimit në debat, tek të cilët kanë ardhur në punën e përbashkët, gjithashtu do t'i shfrytëzojnë në orën tjetër.

### **Hapi pestë**

(Kohëzgjatja: 25 minuta – nga 10 deri 12 minuta për secilin grup)

Në fillim të orës së ardhshme, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i fton nxënësit që të mblidhen sërish në grupet e njëjta, në të cilat janë përgatitur orën e kaluar. Në grupet A e B, nxënësit e studiojnë listën e argumenteve që e kanë përpiluar. Pastaj mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i lut që, në kuadër të grupeve të veta, të bien në ujdi se cilët janë tre anëtarë të grupit që do t'i ekspozojnë argumentet që kanë gjetur së bashku.

Derisa nxënësit përgatiten për debat, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja në mes të mësonjëtores i rendit karriget për mysafirët e ardhshëm në studio- pjesëmarrës në debat (grupet që i përfaqësojnë pikëpamjet e kundërta në studio rrinë ulur karshi njëri - tjetrit).

### **Hapi gjashtë**

(Kohëzgjatja: 25 minuta – nga 10 deri 12 minuta për secilin grup)

Mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i lut nxënësit që të sillen sikur vërtetë ndodhën në ndonjë studio TV. Ai/ajo ka rolin e drejtuesit të emisionit të TV që “shikuesve pranë ekraneve të vogla” ua paralajmëron mysafirët dhe temën e debatit, dhe i kumton rregullat e debatit.

Grupi A e B, do të ketë mundësi t'i ekspozojnë pikëpamjet e veta në tre rrathë me nga 3 minuta: më parë përfaqësuesi i grupit A e ekspozon dhe argumenton angazhimin për aktivizëm qytetar. Në tre minutat vijues, qëndrim të kundërt ekspozon grupi B.

Në rrethin e dytë, përfaqësuesit e grupeve (më parë A e B) cekin kundër-argumentet për qëndrimet që kanë dëgjuar nga kundërshtarët e tyre.

Në fund, përfaqësuesit e grupeve i përmbledhin argumentet e veta.

Gjatë debatit, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja shfaq kujdes për renditjen e ekspozimeve, mbi kohën që e ka në dispozicion një debat (maksimum 3 minuta).

Vëzhguesit (grupi C), secili për vete, shënojnë anët e mira e të këqija të argumentimeve të ofruara, sipas kriterëve të përcaktuara. Pas debatit të përfunduar, ata i kumtojnë rezultatet (gjetjet) e veta në formën që e ekspozon drejtuesi i emisionit.

Në argumentimin e grupit A, ishte mirë..., por mund të avancohet...

e në argumentimin e grupit B, ishte mirë..., por mund të avancohet...

### **Hapi shtatë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja në pjesën përfundimtare të punëtorisë me nxënësit zhvillon bisedë mbi atë çfarë kanë mësuar rreth aktivizmit qytetar dhe rolin e tij në shoqërinë demokratike, dhe mbi atë si të motivohen qytetarët për të marrë pjesë aktive në zgjidhjen e çështjeve me interes të përbashkët.

## **Materiali për punë:**

### **Shtojca nr. 1**

#### **Përgatitja për debat**

Grupet përgatiten për debat ndaras dhe zakonisht përgatitja për debat zhvillohet sipas procedurës së përcaktuar. Hapat në rastet më të shpeshta janë:

1. **NDËRTIMI I IDESË** - Secili person në grup, duhet për vetë, në heshtje, të shkruajë sa më shumë gjëra lidhur me temën/ problemin që i bie ndërmend; argumente, shembuj dhe kundër-argumente të mundshme, me të cilat do të prezantohet pala kundërshtare.
2. **LISTA E PRIORITETEVE** – Kur secili anëtar i grupit ta përpilojë listën e vet të ideve, pason këmbimi në nivel të grupit. Të gjithë i paraqesin propozimet e veta, me rend. Diskutohet pesha relative e secilit argument të paraqitur, dhe nëse shumica në grup e shpall sa fuqishëm duhet mbahet ai, në të kundërtën, nëse të gjithë pajtohen se është tepër i dobët, argumenti hidhet poshtë. Rekomandohet orientimi i grupit në gjetjen e argumentimit më të mirë dhe i shembujve që do ta sforcojnë, e jo fokusimi në vlerësimin se cili argument i kujt është. Kur është përpiluar lista e argumenteve, kalohet në **NDARJEN E ROLEVE**: Përpunohet në hollësi mbi çka do të flasë secili anëtar i grupit, dhe me cilën renditje do të ekspozojnë.
3. **PËRGATITJA INDIVIDUALE PËR PREZANTIM** – Secili folës duhet ta përpilojë konceptin e vet se si do të ekspozojë në debat. Në këtë fazë, nuk rekomandohet shkrimi i konceptit në formën finale të **FJALIMIT**, por kjo rezymë e planifikuar edhe mund të dallojë më pas nga vet paraqitja, që do të varet nga rrjedha konkrete e vetë debatit dhe argumenteve, dhe e paraqitjes së anëtarëve të tjerë. Në këtë kuptim, duhet të jenë fleksibil (të lakueshëm), por megjithatë të skicohet se me cilën renditje do të paraqiten argumentet, cilat janë dobësitë potenciale të asaj që dëshirohet të kumtohet...Të shfaqet kujdes mbi gjatësinë e ekspozesë dhe mbi strukturën. Domethënë, në minutën e parë zakonisht ekspozohet esenca e asaj që dëshirohet të thuhet, ndërsa në minutën e fundit përmbledhen argumentet. Folësi mund të mendohet mbi përfundimin e rastit më të fuqishëm të pjesës së vet të fjalimit, në formë të ndonjë citati relevant apo fjalie kyçe.
4. **KONFIRMIMI I TË DAKORDUARËS** – Në fund i tërë grupi kalon nëpër konceptin final të ekspozesë, plani i debatit, duke vështruar atë se si është definuar tema, në ndarjen e rolit dhe krejt çka është planifikuar në përgjithësi që grupi të kumtojë, me planifikimin e strategjisë globale të paraqitjes grupore dhe individuale.

## **Punëtorja: SUPOZIMET E SHOQËRISË DEMOKRATIKE**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen me faktorët të cilët e nxisin ose pengojnë zhvillimin demokratik të shoqërisë.

### **DETYRAT:**

- të vërejturit e kushteve të cilët mundësojnë dhe ndihmojnë ekzistimin e shoqërisë demokratike
- të vërejturit e faktorëve të cilët e rrezikojnë ekzistimin e shoqërisë

### **Materiali për punë:**

- tabela ose letra e madhe
- kartelat me detyra (Shtojca nr. 1)
- shirita ngjites

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në fillin të aktivitetit mësimdhënësi/ mësimdhënësja i ndan nxënësit nga katër grupe. Secilit grup ua shpërndan kartelat në të cilat janë cekur faktorë të ndryshëm, që mund të ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë demokratike. Grupet marrin më shumë kartela të llojllojshme, kurse në nivel të grupit, nxënësit merren vesh A MUNDET DHE NË ÇFARË MËNYRË mundet, faktori i cekur në kartelën e tyre, ta ndihmojë ose vështirësojë zhvillimin e shoqërisë demokratike.

#### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 25 minuta)

Mësimdhënësi/ mësimdhënësja e shkruan në krye të tabelës ose të letrës së madhe “e ndihmon”, kurse në fund e “vështirëson”. Në gjysmë është tërhequr vija horizontale e cila e shënjon kufirin e dy fushave.

Pastaj, mësimdhënësi/ mësimdhënësja i fton përfaqësuesit e grupeve që kartelat e marra t'i ngjisin në pjesën e caktuar të letrës ose tabelës, duke shënuar kështu nëse faktori ndihmon apo e vështirëson zhvillimin e shoqërisë demokratike. Përfaqësuesit e grupeve shpjegojnë shkurt MËNYRËN sipas të cilës faktorët e vështirësojnë ose e nxisin zhvillimin e shoqërisë demokratike.

Pas shpjegimit që e ka dhënë përfaqësuesi i grupit për secilin nga faktorët, mësimdhënësi/ mësimdhënësja i fton nxënësit e tjerë të deklarohen nëse kanë diçka të shtojnë. Pastaj, përfaqësuesi i grupit ka rastin t'u përgjigjet nëse pajtohet me këtë apo jo.

#### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Në pjesën përfundimtare të këtij aktiviteti, mësimdhënësi/ mësimdhënësja, duke iu referuar masës më të madhe të vërejtjeve të nxënësve, e përmbledh diskutimin duke vënë në pah rëndësinë e faktorëve të caktuar për zhvillimin e demokracisë.

“Kujtojeni se në punëtorinë e parë kemi thënë se për vendimmarrjen demokratike, dhe për ekzistimin e demokracisë është i domosdoshëm ekzistimi i rregullave dhe procedurave demokratike (e drejta e përgjithshme e votimit, zgjedhjet e lira e të ndershme, kontrolli i pushtetit, etj.) Pas kësaj, në punëtorinë e radhës kemi folur mbi rëndësinë e kufizimit të pushtetit, dhe veçmas mbi njërën nga format e atij kufizimi – ndarjen e pushtetit. Pastaj, kemi folur mbi disa parakushte që të zhvillohet demokracia në një shoqëri (pjesëmarrja aktive e qytetarëve në jetën politike, autonomia relative e shoqërisë qytetare, veprimi i lirë i shoqërisë civile). Sot e kemi analizuar një varg premisash të demokracisë. Me këtë, nga punëtorja jonë fillestare e cila nocionin e demokracisë e ka reduktuar në ekzistimin e rregullave demokratike të vendimmarrjes, kemi arritur deri tek një varg i tërë kushtesh, supozimesh dhe parimesh të cilët duhet të ekzistojnë, që të kemi një demokraci të zhvilluar. Në këtë mënyrë e kemi zgjeruar nocionin e demokracisë. Nuk mjafton të ekzistojnë vetëm rregullat e caktuara të vendimmarrjes demokratike, por edhe disa faktorë të tjerë të cilët e ndihmojnë zhvillimin e demokracisë: ata të cilët i kemi përmendur si mënyra të kufizimit të pushtetit (sundimi i drejtësisë, ndarja e pushtetit, të drejtat e njeriut, kushtetutshmëria, sistemi shumëpartiak, decentralizimi i pushtetit, mediat e lira e të pavarura, shoqëria autonome demokratike, veprimi i lirë i shoqërisë civile) kurse tani i kemi shtuar edhe këto: mundësia e vetorganizimit, barazia, participimi, shkalla e lartë e tolerancës, ekonomia e tregut, paqja.

Demokracia nuk është shumë e thjeshtë e supozimeve të cilat në një shoqëri realizohen përnjëherë, por është **proces** afatgjatë i **demokratizimit**, i cili nis me vendosjen e lirisë së bashkimit politik dhe të sistemit shumëpartiak, me organizimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe të procedurave demokratike. Atëherë, kur janë vendosur vetëm disa parakushte fillestare për demokraci, dhe disa procedura themelore (pluralizmi politik, sistemi shumëpartiak, zgjedhjet e lira e të ndershme) , atëherë flasim mbi të ashtuquajturat **demokraci zgjedhore**. Vendosija e premisave të mëtejshme dhe të institucioneve të demokracisë (sundimi i drejtësisë, kushtetutshmëria e ligjshmëria, ndarja e pushtetit, mediat e pavarura, ekonomia e tregut, shoqëria e zhvilluar qytetare, etj) është çështje e demokratizimit të mëtejshëm, e cila çon drejt demokracisë së **konsoliduar**, që do të thotë se demokracia si sistem është **përforsuar**, dhe se zhvillimi i saj i mëtejshëm në shkallë më të lartë të demokracisë, po zhvillohet pa rrezik që sërish të bjerë në rend jodemokratik.”



**Materiali për punë:**

**Shtojca nr. 1: Kartelat për nxënës**

Sundimi i ligjit	Mosrespektimi i ligjit
Mundësia e vetorganizimit	Ndalimi i tubimeve publike
Barazia	Mentalitet vasali
Participimi	Sistemi një-partiak
Sistemi shumë partiak	Mosdurimi
Shkalla e lartë e tolerancës	Mediat e kontrolluara
Pavarësia e mediave	Diskriminimi
Zgjedhjet e lira e të drejta	Gjuha e urrejtjes
Vendimi i shumicës, e mbrojtja e të drejtave të pakicave	Varfëria
Ekonomia e tregut	Njëmendësia
Ndarja e pushtetit	Apatia politike
Respektimi i të drejtave të njeriut	Korrupsioni
Paqja	Lufta

## **Punëtorja: TË DREJTAT E NJERIUT 1**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që t'u ndihmojë nxënësve ta kuptojnë nocionin e të drejtave të njeriut, dhe të spikas karakterin e tij universal.

### **DETYRAT:**

- përcaktimi më i afërt i nocionit të drejtat e njeriut
- spikatja e rëndësisë së të drejtave të njeriut për secilin individ
- njohja e temës së të drejtave të njeriut në shtypin ditor

### **Materiali për punë:**

- Pyetëtori (Shtojca nr. 1)
- Shembujt nga gazetat (Shtojca nr. 2)

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja në parashtrimin hyrës i rikujton nxënësit se në klasën e dytë janë marrë me të drejtat *e fëmijëve*, dhe atëherë kanë qenë të orientuar në Konventën mbi të Drejtën e Fëmijës. Në punëtoritë që pasojnë do të merren me të drejtat e *njeriut*, prandaj është e domosdoshme që të vërejnë ndërlidhjen e këtyre fushave. (Veçanërisht është e dobishme që nxënësit të rikujtohen me çështjen mbi raportin midis nevojave dhe të drejtave.)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson që secili nga ne, në jetën e përditshme, i gëzon të drejtat e njeriut. Në situata të shumta ndonjëra nga të drejtat tona mund të rrezikohet ose cenohet. Nga ana tjetër, kjo është temë mbi të cilën po flitet shumë në kohën e re, që është arsye shtesë ta “verifikojmë” se çfarë nënkuptojmë ne me të drejtat e njeriut. Pastaj, mësimdhënësi/mësimdhënësja ua shpërndan nxënësve pyetëtorin, dhe i lut nxënësit ta plotësojnë atë (Shtojca nr. 1).

Nxënësit e plotësojnë pyetëtorin në mënyrë të pavarur.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i fton nxënësit të marrin pjesë në bisedën mbi të drejtat e njeriut, dhe të thonë si e kuptojnë atë nocion në bazë të përvojës së deritashme, dhe në bazë të pyetësorëve që i kanë plotësuar.

Pyetjet që duhet të marrin përgjigje me anë të diskutimit, janë të njëjta me ato që janë shtruar në pyetësor.

- *Cilat të drejta të njeriut i dini?*

(Nxënësit numërojnë ne me rend, mësimdhënësi/mësimdhënësja shënon, duke shtuar edhe vetë shembujt – e drejta për jetë, e drejta për lirinë e mendimit e të shprehjes... Në qoftë se numërimi shkon me vështirësi, mësimdhënësi/mësimdhënësja mund të shërbehet me Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut, duke lexuar disa nene, kurse detyra për nxënës në këtë rast, është që t'ia japin emrin e nenit të lexuar duke e emërtuar si: E drejta për...)

- *Përse këto të drejta quhen të drejta të njeriut?*

(Nxënësit përgjigjen individualisht, biseda ndërpritet në momentin kur tema përfundon në përgjigjet e ofruara)

- *A është shteti ai që na i dhuron këto të drejta?*

(Mësimdhënësi/mësimdhënësja i lut nxënësit që të arsyetojnë përse e kanë zgjedhur përgjigjen po ose jo, duke shpjeguar përse është përgjigja JO.)

- *Cili është roli i shtetit në raport me të drejtat e njeriut?*

Pas përgjigjeve të paraqitura, mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se cilat përgjigje janë të sakta (të sakta janë përgjigjet: 2, 3 dhe 6), duke përsëritur shembujt e mirë dhe sqarimet që i kanë dhënë nxënësit. Për komente të përgjigjeve të nxënësve, është e domosdoshme të konsultohet teksti mbi të drejtat e njeriut nga literatura shtesë.

Me përfundimin e diskutimit, është me rëndësi të cekën edhe këto elemente të përcaktimit të drejtave të njeriut:

- Të drejtat e njeriut janë minimum i kërkesave që mund t'i shtrojmë ndaj shoqërisë dhe njerëzve të tjerë, me vetë faktin që jemi njerëz.
- Të drejtat e njeriut nuk varen nga shtetet (ai nuk i normon as i lejon) veç se qenia njerëzore i ka me vet faktin që është qenie njerëzore.
- Shteti është i obligueshëm të garantojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut.
- Kufijet e të drejtave tona janë të kufizuara me të drejtat e të tjerëve.

Në qoftë se në diskutim hapet çështja e konfliktit të drejtave, është mirë t'u rikujtohet nxënësve punësoria mbi konfliktin e të drejtave nga klasa e dytë.

Është mirë që këto qëndrime të shkruhen trashë dhe pashëm gjatë të dy orëve mbi të drejtat e njeriut.

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i ndan nxënësit në disa grupe dhe secilit ia jep Listën e titujve të gazetave (Shtojca nr. 2). Pastaj, i lut nxënësit të mendojnë se cilat të drejta të njeriut janë tematizuar në tekstin e caktuar, me konstatimin që të bëjnë mbi-titullin, i cili do të emëronte se për cilën të drejtë të njeriut është fjala (E drejta për...).

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Përfaqësuesit e grupeve i arsyetojnë zgjidhjet e veta.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se dëshiron që me anë të këtij aktiviteti ta vërë në ndërlidhje një situatë nga jeta me të drejtat e njeriut, sepse tema e të drejtave të njeriut është e pranishme çdo ditë në jetën e secilit nga ne, bile edhe kur kjo nuk është thënë në mënyrë eksplicite.

## Materiali për punë:

### Shtojca nr. 1

Cilat të drejta të njeriut i dini? Numëroni disa të drejta të njeriut
E drejta për... E drejta për... E drejta për...
Përse këto të drejta quhen të drejta të njeriut?
është raporti i shtetit karshi të drejtave të njeriut? Rrumbullakoni përgjigjet e sakta.
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Shteti ua dhuron të drejtat e njeriut qytetarëve të vet.</li><li>2. Gjykatat duhet t'i dënojnë ata që i shkelin të drejtat e njeriut.</li><li>3. Shteti nuk guxon të shkelë të drejtat e qytetarëve të vet.</li><li>4. Shteti mundet, me propozim të shumicës së qytetarëve të vet, ta ndalojë shkeljen e ndonjë të drejte.</li><li>5. Shteti guxon të nxjerrë ligjin që është në kundërshtim me të drejtat e njeriut.</li><li>6. Shteti duhet të ketë raport aktiv ndaj të drejtave të njeriut, të marrë një varg masash me anë të të cilave mundëson realizimin e të drejtave të njeriut.</li><li>7. Shteti mund të vendosë se cilat nga të drejtat do t'i mbrojë, për shkak se i konsideron më të rëndësishme nga të tjerat.</li><li>8. Qytetarët mund të heqin dorë nga të drejtat e njeriut, në dobi të shtetit.</li></ol>
Mendoni për fjalinë: Të drejtat tona janë të kufizuara me të drejtat e të tjerëve.

## **Shtojca nr. 2**

**Artikujt e gazetave**

## **Punëtorja: TË DREJTAT E NJERIUT 2**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i punëtorisë është njohja e nxënësve me disa lloje të të drejtave të njeriut.

### **DETYRAT:**

- njohja me përmbajtjen e disa të drejtave
- promovimi i të drejtave të njeriut

### **Materiali për punë:**

- Kartelat e të drejtave (Shtojca nr. 1)

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 25 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i njofton nxënësit se kjo orë është vazhdim i orës së kaluar mbi të drejtat e njeriut, dhe ua rikujton shkurt elementet më kryesore, pastaj i ndan nxënësit në katër grupe dhe secilit grup ua jep nga një kartelë me një të drejtë (Shtojca nr. 1). Secili grup e përgatit prezantimin e të drejtës së caktuar me instruksion: Të lexohet e drejta “vetjake”, të shpjegohet sa më me argumente përse ajo është e rëndësishme, në cilat situata ajo na është rrezikuar, cilat grupe të njerëzve, sipas mendimit të tyre, kanë probleme me mbrojtjen e kësaj të drejte...Në vazhdim të aktivitetit nxënësit i prezantojnë të drejtat e tyre.

#### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në këtë pjesë të aktivitetit, mësimdhënësi/mësimdhënësja i lut nxënësit që në nivel të grupit ta formulojnë të drejtën vetjake duke shfrytëzuar, ta zëmë, format artistike të shprehjes. Detyra është që ta dërgojnë mesazhin propagandistik me të cilin e promovojnë atë të drejtë. Këtë mund ta bëjnë me anë të tekstit, këngës, video spotit, artikullit gazetaresk, formës dramatike, pllakate e ngjashëm. Secili grup përgatiti paraqitjet e veta dhe i ekzekuton përpara të tjerëve. Mësimdhënësi/mësimdhënësja i nxit nxënësit që mesazhet të jenë sa më bindëse në aspektin e marketingut.

#### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja, në pjesën përfundimtare të aktivitetit, thekson se secila nga këto të drejta i takon korpusit të të drejtave qytetare, politike, ekonomike, sociale ose kulturore. Pavarësisht cilit grupit i takon, secila nga ato për individin është e konsiderueshme, dhe është e domosdoshme të kemi raport aktiv ndaj të drejtave të njeriut.

Angazhimi për respektimin e të drejtave të njeriut dhe lufta për realizimin e tyre, cilitdo grup t'i takojnë, mund të realizohen me anë të formave të ndryshme të vetorganizimit dhe me anë të iniciativës qytetare. Mbi atë se si mbrohen të drejtat e njeriut me anë të iniciativës qytetare, flasin punëtoritë në vazhdim.

## Shtojca 1.

### Materiali për punë:

#### Kartelat me detyrat

##### E DREJTA QYTETARE

###### Liria e qarkullimit dhe e zgjedhjes së vendqëndrimit

Kjo e drejtë mundëson lirinë e lëvizjes brenda territorit të shtetit, dhe vendosjen e lirë lidhur me vendbanimin e secilit shtetas të vendit ose të huaj, të cilit i është lejuar të hyjë në territorin e shtetit. Edhe pse kjo e drejtë sot duket krejt e natyrshme, mjafton të përmendet se shumë vende e kanë njohur sistemin e pasaportave të brendshme pa të cilat nuk ka mundur të braktiset vendqëndrimi, si dhe lejet unike për vendqëndrim në qytete, sidomos në kryeqendra.

Gjithashtu, shteti nuk guxon t'i pengojë shtetasit të udhëtojnë jashtë vendit. Pasaporta nuk guxon të jetë dokument që do të lëshohet në bazë të vendimit të diskrecionit të organeve të shtetit, pa të drejtë ankese në gjykatë.

##### E DREJTA POLITIKE

###### E drejta për pjesëmarrje në drejtimin e bashkësisë

Ekzistojnë të drejtat politike të cilat qytetarëve u garantojnë ndikim real në drejtimin e punëve publike. Me to, shpesh nënkuptohet e drejta për drejtimin e punëve publike, e drejta pasive dhe aktive e zgjedhësve, dhe qasja e barabartë në shërbimet publike. Sipas rregullit, këto të drejta janë të rezervuara vetëm për shtetasit e një vendi, ndonëse asgjë nuk qëndron në rrugë që t'u jepen edhe të huajve me vendqëndrim të përhershëm.

Çdo qytetar duhet të ketë të drejtën dhe mundësinë që, pa diskriminim dhe kufizime të panevojshme, të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirshëm.

E drejta më e evidente demokratike është e drejta e qytetarit të zgjedhë dhe të zgjidhet në organe të cilat marrin vendime politike.

Gjithashtu, secili qytetar nën kushte të njëjta të barazisë, duhet të ketë qasje në shërbimin publik të vendit të tij.

## E DREJTA EKONOMIKE

### E drejta për punë, kohë të kufizuar të punës dhe mbrojtje në punë

E drejta për punë paraqet një rënë nga të drejtat themelore sociale e cila siguron pavarësinë ekonomike të individit. Ajo në fund të fundit mundëson zhvillim të plotë dhe realizimin e personalitetit njerëzor. Me këtë të drejtë, janë të ndërlidhura ngushtë ndalimi i punës së detyrueshme, të gjitha format e eksploatimit të punës së huaj, dhe pamundësimi i zgjedhjes së lirë të punësimit. Edhe pse e drejta për punë nuk nënkupton të drejtën e çdo individit të fitojë punë, shteti është i detyrueshëm të ndërmarrë masa për pakësimin e papunësisë. E drejta për punë e përfshin edhe të drejtën për ndihmë pa-pagesë me rastin e kërkimit të punës, detyrimin e shtetit që të formojë shërbimin i cili do ta ofrojë këtë ndihmë, dhe obligimin që të sigurojë qasje pa-pagesë në njoftimet mbi vendet e lira të punës.

## E DREJTA KULTURORE

### E drejta për arsimim

Kjo e drejtë, para se gjithash, nënkupton detyrimin e shtetit që individëve t'u mundësojë të fitojnë arsimim. Për këtë shkak, arsimimi elementar duhet të jetë pa pagesë, i detyrueshëm dhe i kapshëm për të gjithë.



## **Punëtorja: QYTETARËT E KOMUNËS TIME 1**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është shqyrtimi i informimit vetjak dhe i gatishmërisë për të marrë pjesë aktive në zgjidhjen e problemeve ekzistuese shoqërore.

### **DETYRAT:**

- vënia në pah e mundësive për pjesëmarrjen e qytetarëve në punët publike
- vlerësimi i udhëzimit vetjak në punën e komunës dhe në shkallën e gatishmërisë që aktivisht të marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve ekzistuese shoqërore.

### **Materiali për punë:**

- fletëzat anketuese për nxënës dhe për anketën në terren (Shtojca nr. 1)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja ua rikujton nxënësve punëtorinë mbi të drejtat e njeriut, duke vënë theksin në të drejtat politike.

Ekzistojnë të drejta politike të cilat qytetarëve u garantojnë ndikim real në drejtimin e punëve publike. Me to, shpesh, nënkuptohet e drejta për drejtimin e punëve publike, e drejta aktive dhe pasive zgjedhore, dhe qasja e barabartë në shërbimet publike.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja përmend se në punëtoritë që pasojnë do të shqyrtohet një formë specifike e shfrytëzimit të drejtës për pjesëmarrje në drejtimin e bashkësisë - iniciativat qytetare. Iniciativat qytetare u mundësojnë qytetarëve që edhe vetë të orvatën që të veprojnë direkt, me qëllim të zgjidhjes së problemeve nga mjedisi i tyre, apo që edhe vetë të propozojnë masa të cilat do ta avancojnë jetën në bashkësi.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 25 minuta)

Në këtë pjesë të aktivitetit, mësimdhënësi/mësimdhënësja ua shpërndan nxënësve pyetësorin me pyetje, përgjigjet e të cilave duhen ditur nëse dëshirojnë të merreni aktivisht me problemet shoqërore. Pastaj, mësimdhënësi/ mësimdhënësja i lut nxënësit ta plotësojnë pyetësorin individualisht.

Në vazhdim të aktivitetit nxënësit ndahen në grupe prej 3 deri 4 veta, kurse mësimdhënësi/mësimdhënësja jep instruksione që në nivel të grupit të flasin mbi përgjigjet e veta.

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i lut përfaqësuesit e grupeve të ekspozojnë se rreth cilave përgjigje kanë pasur më shumë hamendje dhe mospajtime. Pastaj, i njofton nxënësit se detyra e tyre është që me anë të pyetësorëve të njëjtë, ta zbatojnë anketën midis bashkëqytetarëve të vet të cilën do ta analizojnë në orën e ardhshme.

**Vërejte:**

Është me rëndësi që mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja, t'i kushtojë vëmendje të veçantë hamendjeve dhe përgjigjeve karakteristike të nxënësve, që t'u referohet atyre në punën e ardhshme.

Në fund të aktivitetit, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i lut nxënësit që në grupet e njëjta, ta zbatojnë anketimin e qytetarëve të vet. Secili grup merr nga 10 fletanketa (nga një fletëz për secilin person të anketuar). Deri në orën e ardhshme, është e domosdoshme të zbatojnë anketimin dhe të përgatisin prezantimin e punës së vet.

Mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja u përmend nxënësve se me rastin e anketimit duhet të jenë të njerëzishëm dhe seriozë, domethënë të thonë se janë nxënësit e klasës së 3 të filan shkollës dhe se në kuadër të lëndës Edukata qytetare, si detyrë shkollore, e zbatojnë anketën mbi qëndrimet dhe informimin e qytetarëve në komunën e tyre. Nxënësit lypset t'u thonë qytetarëve, të cilët do t'i lusin të marrin pjesë në anketë, se hulumtimi është anonim dhe vullnetar. Njerëzit kanë reagime të ndryshme ndaj anketimit, prandaj nxënësit duhet të jenë të përgatitur paraprakisht se të gjithë bashkëqytetarët nuk do të reagojnë në mënyrë të njëjtë ndaj ftesës për anketim.

## Materiali për punë:

### Shtojca nr. 1

PYETËSORI
1. Ku gjendet ndërtesa e Komunës?
2. Çfarë mund të kryejë qytetari në Komunë?
3. A është Komuna e detyruar të përgjigjet në pyetjet që i shtrojnë qytetarët me anë të shkresave formale?
4. Sipas vlerësimit tuaj cili është problem i më i madh i përbashkët i kësaj Komune?
5. Kush duhet ta zgjidhë atë problem (pushteti komunal, i qytetit apo ai Republikan)?
6. A do të kontribuonte vetiniciativa e qytetarëve në zgjidhjen e problemeve?
7. Çfarë është “Iniciativa qytetare”?
8. A do të ishit të gatshëm që Ju personalisht të inicioni aksionin për zgjidhjen e ndonjë problemi?
9. A do t’i bashkoheshit aksionit të organizuar për zgjidhjen e ndonjë problemi?

## **Punëtorja: QYTETARËT E KOMUNËS TIME 2**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është, konfirmimi i informimit të qytetarëve mbi punët e komunës dhe i gatishmërinë së qytetarëve që aktivisht të marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve ekzistuese shoqërore.

### **DETYRAT:**

- hulumtimi i informimit të qytetarëve mbi punët e komunës, dhe i gatishmërisë së qytetarëve që të marrin pjesë aktivisht në zgjidhjen e problemeve ekzistuese shoqërore.

### **Materiali për punë:**

- fletanketa e plotësuar

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja, i fton nxënësit që përfaqësuesit e grupeve të tregojnë se si kanë qenë përvojat e punës anketuese. Mësimdhënësi/ mësimdhënësja mund të shërbehet me këto pyetje:

- A kanë qenë qytetarët të gatshëm të bashkëpunojnë?
- Çfarë kanë qenë reagimet e qytetarëve?
- A pati ndonjë ngjarje interesante, gjatë anketimit të qytetarëve?

#### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 35 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i fton nxënësit që t'i sistematizojnë bashkë përgjigjet e pyetjeve të shtruara në anketë. Rezultatet e anketës shkruhen në tabelë në këtë mënyrë:

<b>Rezultatet e anketës</b>
<p>1. Ku gjendet ndërtesa e Komunës?</p> <p><i>Shkruhet numri i të anketuarve të cilët kanë ditur edhe numrin e atyre të që nuk kanë ditur ku gjendet godina e komunës.</i></p>
<p>2. Çfarë mund të marrë qytetari në Komunë?</p> <p><i>Shkruhen të gjitha përgjigjet karakteristike</i></p>
<p>3. A është e detyruar Komuna t'iu përgjigjet pyetjeve që i shtrojnë qytetarët me anë të shkresave formale?</p> <p><i>Shkruhet numri i të anketuarve që janë përgjigjur me PO, dhe numri i atyre që janë përgjigjur me JO.</i></p>
<p>4. Sipas mendimit tuaj, cili është problemi më i madh i përbashkët?</p> <p><i>Shkruhen ato përgjigje që i kanë përmendur më së shumti tre të anketuar</i></p>
<p>5. A duhet ta zgjidhë pushteti atë problem (qoftë komunal qoftë ai republikan?)</p> <p><i>Shkruhet numri i të anketuarve që janë përgjigjur me PO, dhe numri i atyre që janë përgjigjur me JO.</i></p>
<p>6. A do të kontribuonte iniciativa e qytetarëve në zgjidhjen e problemeve?</p> <p><i>Shkruhet numri i të anketuarve që janë përgjigjur me PO, dhe numri i atyre që janë përgjigjur me JO.</i></p>
<p>7. Çfarë është "Iniciativa qytetare"?</p> <p><i>Shënohen tri përgjigjet më të shpeshta</i></p>
<p>8. A do të ishit të gatshëm të angazhoheni personalisht në zgjidhjen e ndonjë problemi në vendin tuaj?</p> <p><i>Shkruhet numri i të anketuarve që janë përgjigjur me PO, dhe numri i atyre që janë përgjigjur me JO.</i></p>
<p>9. A do t'i bashkoheshit organizimit të aksionit për zgjidhjen e ndonjë problemi?</p> <p><i>Shkruhet numri i të anketuarve që janë përgjigjur me PO, dhe numri i atyre që janë përgjigjur me JO.</i></p>

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i fton nxënësit t'i komentojnë rezultatet e anketës, dhe bashkë me ta t'i kumtojë rezultatet:

Qytetarët e komunës tonë:

- (nuk) e dinë ku gjendet Komuna
- (nuk) e dinë çfarë mund të kryejë qytetari në Komunë
- (nuk) konsiderojnë se komuna është e detyruar të përgjigjet në pyetjet të cilat i shtrojnë qytetarët
- konsiderojnë se problemet më të mëdha të përbashkëta të kësaj Komune:...
- (nuk) konsiderojnë se ato probleme duhet t'i zgjidhë pushteti
- .....

Në fund të aktiviteteve, mësimdhënësi/mësimdhënësja vë në pah se në këtë mënyrë e kanë dhënë tablonë e hartës së informimit të qytetarëve mbi punët dhe detyrimet e Komunës, të problemeve më të mëdha komunale, dhe gatishmërinë e qytetarëve që edhe vet të inkuadrohen aktivisht në zgjidhjen e tyre.

## **Punëtorja: INICIATIVA QYTETARE**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen me iniciativat qytetare, si një nga format e pjesëmarrjes imediate të qytetarëve në punët publike.

### **DETYRAT:**

- Njohja me nocionin iniciativa qytetare
- Përzgjedhja e problemit dhe propozimi për zgjidhjen e tij.

### **Materiali për punë:**

- Teksti “Kompetencat e KK (Kuvendi Komunal) për mësimdhënës (Shtojca nr. 1)
- Shembujt e iniciativave të formuluar qytetare për mësimdhënës (Shtojca nr. 2)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i njofton nxënësit se ekzistojnë dy mënyra të pjesëmarrjes së qytetarëve në punët publike- indirekt dhe direkt.

Mënyra **indirekte** e pjesëmarrjes së qytetarëve në punët publike, është me anë të përfaqësuesve të zgjedhur – deputetëve ose këshilltarëve (të komunës).

Ekzistojnë dy forma të mënyrës së **drejtpërdrejtë** të pjesëmarrjes së qytetarëve. Njëra nga to forma është *referendumi*, të cilin e shpallin organet e pushtetit, e ku qytetarët deklarohen me votim. Forma e dytë është *iniciativa qytetare*, të cilën e iniciojnë vet qytetarët. Në këtë mënyrë ata marrin pjesë të drejtpërdrejtë në procesin e marrjes së vendimeve. (Marrja e vendimeve nuk reduktohet vetëm në votim në institucione, veç kjo nënkupton procesin i cili përbëhet nga disa hallka: nis me ngritjen e iniciativës (me propozimin), pastaj pason debati dhe në fund marrja e vendimit me votimin e deputetëve/këshilltarëve).

Mësimdhënësi/mësimdhënësja, më pas paralajmëron se nxënësit gjatë orëve të ardhshme, do të merren me atë se çfarë mund të bëjnë qytetarët kur e vërejnë ndonjë problem, ose e dallojnë ndonjë nevojë në bashkësi lokale.

1. Një mundësi është që të iniciojnë vetë aksionin, dhe ta zgjidhin ndonjë problem.
2. Mundësia tjetër është të iniciojnë procesin e vendimmarrjes në vet institucionet kompetente për zgjidhjen e tyre.

Duke iniciuar zgjidhjen e problemeve nga ambienti i tyre, qytetarët bëhen pjesëmarrës aktivë në jetën e bashkësisë së tyre.

### **Hapi dytë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në vazhdimin e aktiviteteve, mësimdhënësi/mësimdhënësja i informon nxënësit se ata, orën e ardhshme, do të gjenden në rolin e qytetarëve të cilët e japin iniciativën. Për fillim nevojitet të përzgjidhet problemi në zgjidhjen e të cilit do të punojnë.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i lut nxënësit që t'i cekin problemet të cilat i kanë vërejtur në komunën e tyre. Shfrytëzohet teknika e “stuhisë së ideve”, kurse problemet shkruhen në tabelë. Më atë rast, mësimdhënësi/mësimdhënësja trgon kujdes për problemet se janë nga kompetenca e KK (mësimdhënësi/mësimdhënësja për këtë mund të mbështetet në Shtojcën nr. 1), dhe se janë definuar sa më konkretisht (psh “problemi ekologjik” është përcaktim i përgjithësuar i problemit , ndërsa “oxhaqet e fabrikave nuk kanë filtra mbrojtës, gjë që sjell ndotjen e ajrit”, ka qenë përcaktim ekzakt i problemit të njëjtë).

### **Hapi tretë:**

(Kohëzgjatja: 20 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i ndan nxënësit në dy grupe (p.sh., sipas principit të “njësheve” dhe “dysheve”) dhe jep instruksion që secili grup të zgjedhë njërin nga problemet e cekura me të cilin do të merret, si dhe të propozojë zgjidhjen e tij. Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se është shumë me qenësore që problemi, të cilin e zgjedhin nxënësit dhe zgjidhjen që e propozojnë, të jetë i rëndësishëm për një numër më të madh të bashkëqytetarëve, sepse do të lypset të kërkojë mbështetjen e tyre.

Pastaj mësimdhënësi/mësimdhënësja thotë se në orën e ardhshme, nxënësit do të kenë detyrë t'i sajojnë **argumentet** të cilat spikasin faktin përse pikërisht ai problem kërkon zgjidhje urgjente, të planifikojnë **mjete**, financiare e tjera, që janë të nevojshme për realizimin e objektivit, si dhe ta projektojnë fushatën me të cilën do të tërheqin vëmendjen e opinionit dhe do ta përfitojnë mbështetjen e tyre. Në gjithë këtë është me rëndësi të planifikohet edhe procesi i **lobimit (përfitimit)** të atyre që mund t'u ndihmojnë, qofshin ata vendimmarrës apo personalitete publike e prestigjioze, të cilët mund t'u ofrojnë mbështetjen financiare, konsultative, mediatike apo cilëndo ndihmë tjetër.

Derisa nxënësit nëpër grupe bien në ujdi, mësimdhënësi/mësimdhënësja i frekuenton, jep shpjegime të nevojshme dhe shfaq kujdes që grupet të mos e zgjedhin problemin e njëjtë. Në fund të orës, përfaqësuesi i secilit grup paraqet problemin dhe zgjidhjen për të cilën kanë vendosur si grup.

### **Vërejte:**

Për hir të drejtimit më të lehtë të punëtorisë mësimdhënësi/ mësimdhënësja mund t'i shikojë shembujt e iniciativave të formuluar që i kanë përpiluar nxënësit (Shtojca nr. 2).

## Shtojca nr. 1

### KOMPETENCAT E KOMUNËS

Lidhur me fushëveprimin e punëve të komunës, ekziston një unifikim i madh i zgjidhjeve të përfaqësuara në vendet e ndryshme. Ligjet ndryshohen, kurse fushat në të cilat Komuna është kompetente, kryesisht mbeten të njëjta.

Punët me të cilat merret komuna, janë këto:

- **veprimtaritë komunale** (furnizimi me ujë, mirëmbajtja e pastërtisë, shfrytëzimi i tregjeve, parqeve, vend-parkingjeve, deponive dhe i hapësirave të tjera, ndriçimi publik etj.);
- **urbanizmi** (nxjerrja e planeve urbanistike, kujdesi për mirëmbajtjen e godinave të banimit dhe të rrugëve me rëndësi lokale, rregullimi dhe shfrytëzimi i tokës ndërtimore të qytetit etj.);
- **trafiku** (transporti urban dhe ndër-urban rrugor i udhëtarëve , transporti me auto-taksi, transporti nëpër ujë në territorin e komunës);
- **mbrojtja dhe avancimi i mjedisit të jetesës** (nxjerrja e programeve dhe planeve dhe përcaktimi i kompensimit të veçantë për këtë qëllim);
- **arsimimi, shëndetësia, kultura, sporti** (formimi i institucioneve nga këto fusha dhe përcjellja e sigurimi i funksionimit të tyre.);
- **zhvillimi ekonomik** (nxitja e zhvillimit ekonomik, e sidomos: i turizmit, hotelërisë, zejtarisë dhe tregtisë);
- **informimi** (sigurimi i informimit publik me rëndësi lokale).



## **Shtojca nr. 2**

### **SHEMBUJT E FORMULIMIT TË INICIATIVAVE QYTETARE**

#### **1. PAISJA E PARKUT PËR FËMIJË**

(shembulli është mbështetur në iniciativën qytetare të cilën e kanë formuluar pjesëmarrësit e programit “Bëhu qytetar” në Jagodinë, më 14.04.2002 vit).

#### **Argumentimi:**

1. Në qytet nuk ekziston hapësira e rregulluar (vegla për lojë, gjelbërimi, rëra etj.), ku fëmijët e vegjël mund të lozin. Në oborret e shkollave fillore nuk ka hapësirë për fëmijët deri në klasën e 4, ndërsa fëmijët që nuk shkojnë në shkollë, as në kopsht s’kanë ku të lozin. 60% e fëmijëve në parqe nuk kanë ku të lozin.
2. Siguria – në parkun e vjetër ekzistojnë mbeturinat e veglave të vjetra që paraqesin rrezik për fëmijët, sepse mund të shkaktojnë lëndime.

#### **Lobimi**

1. Këshilltarët
2. Mediat
3. Personalitetet publike
4. Ndërmarrjet

#### **Fushata**

“Java e fëmijëve” në Jagodinë do të përbëhej nga:

- shpërndarja e afisheve dhe ngjitja e pllakateve në qendër të qytetit, foshnjore dhe në shkolla fillore
- emetimi i reklamave në mediat lokale (radio e TV stacionet –RTJ, Novi Put)
- emisioni me temën “Fëmijët e gëzuar-njerëz më të mirë”, në kuadër të së cilës do të intervistohen prindërit, edukatorët dhe qytetarët e tjerë
- për ditën e fundit të javës së fëmijëve është planifikuar mbajtje e tubimit në shesh – në qendër, ora 12.
- në hapësirën e parkut të qytetit do të organizohen gara me lojëra të ndryshme për fëmijë. Më këtë rast do të mblidhen kontribute vullnetare.
- me rastin e hapjes së parkut të pajisur do të organizohet shfaqja për fëmijë ku, përpos fëmijëve do të marrë pjesë edhe Bojane
- fushatën do ta vazhdojmë me qëllim të pajisjes së hapësirave dhe parqeve të nevojshme dhe të domosdoshme për fëmijëri më të bukur të fëmijëve të Jagodinës

#### **Financat**

- Për aksionin nevojiten gjithsej 300.000 dinarë
- nga “Palma” – 50.000 dinarë
- nga “Feman” – 40.000 dinarë
- nga “Metalka- Majur” ndihmën e premtuar për blerjen e bankave dhe të veglave për lojëra në shumën prej 100.000 dinarë.
- Kontributet vullnetare – 10.000 dinarë
- Nga Kuvendi i Komunës së Jagodinës kërkojmë të paguaj 100.000 dinarë për realizimin e projektit tonë

## **2. ZHVENDOSJA E DEPONISË SË QYTETIT**

(shembulli është i mbështetur në iniciativën qytetare të cilën e kanë formuluar pjesëmarrësit e programit “Bëhu qytetar” në Jagodinë, 14.04.2002 vit.

### **Argumentimi**

1. Një për qytet po përhapen erëra të ndryshme. Kundërmon!
2. Kanoset katastrofa ekologjike. Të rrethuar me materie, në natyrë bëhet ndotja e ujërave nëntokësore dhe e dheut. Uji i ndotur me avullim arrin në atmosferë dhe më pas me kullimin e shirave të tharbët rrezikohet ekosistemi i qytetit

Zgjidhjet e mundshme të problemit:

1. zhvendosja
2. ndërtimi i fabrikës për riciklim

### **Fushata**

- Spoti në RTJ
- Radio xhingli (Gong, JRT, Siti)
- Pllakatet dhe afishet
- Shpallja (auto)
- Trikot, kapelat, shenjat (bexhat), lapsat
- Slogani (Jovaça Miciq kthehet në Jagodinë dhe thotë: “Tërë botën e kalova dhe Jagodinën të përlyer e gjeta!”)

### **Lobimi**

1. qytetarët e njohur
2. Mediat (p.sh. në Jagodinë –RTJ, TV Palma Plus, Radio Siti, Rdio Gong)
3. Këshilltarët e Komunës
4. Ndërmarrja (p.sh. në Jagodinë: FK Put, GP Put, Ferma Tomiq, Konfeksioni Resava, NP Standard, Shtypshkronja Margo)

### **Financat**

- Gjithsej 150.000 dinarë
- Sponsorët medial: RTJ, K21, Palma Plus, Radiostacionet Siti dhe Gong
- Ndërmarrjet lokale: Standard, Resava – industria e tekstilit, Margo – shtypshkronja, Tomiq –Ferma, VSJ –Shërbimi i zjarrfikësve, Put- ndërmarrja ndërtimore
- Donacione të qytetarëve – 50.000 dinarë
- Kuvendi i Komunës – 100.000 dinarë

## **Punëtorja: INICIATIVA QYTETARE - FOMRULIMI**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të formojnë iniciativat e veta qytetare dhe të planifikojnë hapat e domosdoshëm për realizimin e tyre në mënyrë që një iniciativë e iniciuar nga qytetarët të jetë sa më e suksesshme. Ushtrimi përfshin proceset e paraprijnë vendimit për problemin e iniciuar (interesin e qytetarëve) në Komunë.

### **DETYRAT:**

- Formulimi i argumenteve për zgjidhjen e problemit
- Planifikimi i fushatës, shpenzimeve financiare dhe i lobimit

### **Materiali për punë:**

- Instruksione për grupet (Shtojca nr. 1)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i lut nxënësit që, në grupet të cilat i kanë formuar orën e kaluar mësimore, ta përpunojnë problemin e zgjedhur. Në këtë hap grupi duhet të hartojë listën e argumenteve të cilët vënë në pah domosdonë e zgjidhjes së problemeve.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se formulimi i argumenteve është jashtëzakonisht domethënës për aktivitetet e mëtejme që do të punojnë në grupe të vogla. Me argumente do të duhej të shërbehen edhe ata që merren me fushatën ose me lobimin, për marrjen e mbështetjes së opinionit, po aq sa edhe për atyre që merren me grumbullimin e mjeteve, e të cilët do t'i prezantojnë si financues potencial.

### **Hapi dytë:**

(Kohëzgjatja: 20 minuta)

Në vazhdim të aktiviteteve, secili nga grupet ndahet në tri nëngrupe, që gjithsej të punojnë gjashtë grupe (nga tri për secilin problem). Mësimdhënësi/ mësimdhënësja, secilit nga tri grupe u ndan instruksione në formën e shkruar – fushatën, lobimin dhe planin e financimit (Shtojca nr. 2).

Mësimdhënësi/mësimdhënësja u vë në pah nxënësve se në këtë hap, secili nga grupet planifikon një varg aktivitetesh, me shfrytëzimin e mjeteve dhe taktikave të ndryshme për të përfituar grupet e ndryshme dhe personalitete.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja u thekson nxënësve se edhe në këtë hap, është e domosdoshme që grupet, të cilat e përpunojnë problemin e njëjtë, tërë kohën të këmbëjnë mesvete informata, në mënyrë që t'i harmonizojnë aktivitetet e veta (p.sh., nëse është planifikuar që në kuadër të fushatës të shfaqen TV spotet, kjo duhet parashikuar edhe në planin financiar).

Nxënësit mund të përzgjedhin vetë në cilin grup do të donin të punojnë: e projektojnë fushatën, hartimin e planit financiar apo hartimin e planit të lobimit të personave të cilët do të mund të ofrojnë mbështetje në zgjidhjen e problemeve të tyre.

**Hapi tretë:**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Në këtë hap, tri nëngrupet sërish me nëngrupet e veta, bisedojnë mbi aktivitetet e parashikuara, duke verifikuar sa janë harmonizuar aktivitetet.

Me përfundimin e aktiviteteve, mësuesi/mësuesja paralajmëron se nxënësit do t'i prezantojnë në orën e ardhshme, iniciativat e veta të formuluar dhe se nevojitet ta dizajnojnë prezantimin në të cilin nga një përfaqësues i çdo grupi do t'a prezantojë argumentimin, fushatën, lobimin dhe financat.

## Materiali për punë:

### Shtojca nr. 1

#### Instruksione për grupet

#### Detyra juaj është: **Hartimi i planit financiar**

Realizimi i propozimit të grupit tuaj kërkon mjete të caktuara, të cilat mund të jenë financiare (në para) ose materiale (p.sh., u nevojitet lokali) ose ju nevojitet shërbimi i dikujt (puna).

Detyra juaj është që ta planifikoni saktësisht se çfarë është e nevojshme, cili është çmimi i secilës nga ato pjesë, dhe sa do të jenë shpenzimet e përgjithshme i realizimit të objektivit tuaj.

Në qoftë se shumica e përgjithshme është e madhe, dhe e dini se buxheti komunal është i kufizuar, mund të kërkonit nga Kuvendet Komunale vetëm pjesën e mjeteve, kurse një pjesë nga dikush tjetër (kontributet vullnetare, donatorët e ngjashëm). Kjo gjithashtu duhet të planifikohet dhe të ceket saktësisht.

#### Detyra juaj është: **Lobimi (përvetësimi)**

Lobimi paraqet një varg aksionesh, qëllimi i të cilave është të ndikojë në personat të cilët marrin vendime.

Marrësit e vendimeve mund t'i loboni direkt, por mund edhe të kërkonit ata të cilët mund t'ju ndihmojnë, që të vini kontakt me ta. Ata mund të jenë disa personalitete publike, por edhe miqtë tuaj, fqinjët, të afërmit. Është qenësore që me rastin e lobimit të shfrytëzoni ekskluzivisht forcën argumenteve.

Detyra juaj është të vërtetoni:

1. Cilin person (apo grup) dëshironi ta përfitoni?
2. Si mund t'ju ndihmojnë ata?
3. Si do të vini kontakt me ata – kush do t'ju ndihmojë në këtë dhe kush nga ju do të jetë i ngarkuar ta kontaktojë atë person?

#### Detyra juaj është: **Fushata**

Objektivi i fushatës është tërheqja e vëmendjes dhe përfitimi i mbështetjes së opinionit.

Detyra juaj është ta përzgjidhni:

1. Grupin e fokusit të cilit do t'i drejtoheni
2. Mesazhin – ai duhet të jetë i shkurtër, i qartë, i dalluar, duhet të ftojë për përfshirje në aksion, kurse gjuha lypset të jetë e kuptueshme për grupin e fokusit.
3. Mjetet dhe metodat që do t'i shfrytëzoni (p.sh., pllakatet, afishet, radio e TV emisionet, tubimet publike, aksionet...)

Është e dëshirueshme që aksioni të emërtohet. Emri me dy apo tri fjalë, me anë të së cilave shprehen objektivat, lë përshtypje të fuqishme në opinion dhe lehtë ngulitet në vetëdijen e njerëzve (p.sh. “Jo më shpejtë se jeta!”, ose “Jepni impuls jetës!”)

Detyra juaj është edhe të caktoni planin kornizë kohor për zbatimin e fushatës. Fushata duhet të jetë intensive dhe gjithmonë është më efektive nëse përfundon me ndonjë ngjarje të fuqishme (aheng, koncert).

## **Punëtorja: INICIATIVA QYTETARE – PREZANTIMI DHE ANALIZA E PUNËS NËPËR GRUPE**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj ore është që nxënësit, me anë të prezantimit dhe diskutimit, të analizojnë formulimin e iniciativës dhe në atë mënyrë i ushtrojnë dijenitë e përfituara në orët e mëparshme.

### **DETYRAT:**

- -prezantimi dhe analiza e iniciativave të formuluar
- -analiza e punës në grupe të vogla

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE**

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 25 minuta)

Nxënësit i prezantojnë iniciativat e përgatitura qytetare, sipas hapave. Secili grup ka nga 12 minuta për prezantim. Në prezantime duhet të marrin pjesë të gjithë anëtarët e grupeve.

#### **Hapi dytë:**

(Kohëzgjatja: 20 minuta)

Gjithë paralelja e analizon (diskuton) përmbajtjen e iniciativave të prezantuara. Mësimdhënësi/mësimdhënësja u përgjigjet pyetjeve eventuale të nxënësve dhe i paraqet të vrojtuarit mbi:

- mënyrën e punës në grup;
- saktësinë në definimin e problemit dhe të objektivit;
- origjinalitetin dhe plotësinë e argumentimit;
- realiteti i planit financiar, e sidomos i burimit të mjeteve për financimin e zgjidhjes së problemit;
- fushatën dhe harmonizimin e saj me natyrën e problemit të iniciuar dhe ambientin
- lobimin, zgjedhjen e personalitetit për lobim.

Secili grup i paraqet vrojtimit e veta dhe përvojat në punën ekipore (ndarjen e roleve, problemet eventuale në punë). Pason diskutimi i përbashkët.

## **Punëtorja: INICIATIVA QYTETARE- PROPOZIMI FORMAL**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen me dallimin midis iniciativës formale e joformale, si dhe me rregullat e formulimit të propozimit formal që i dërgohet Kuvendit.

### **DETYRAT:**

- kuptimi i dallimeve midis iniciativës formale e joformale
- njohja me formën dhe përmbajtjen e propozimit si mënyrë formale e realizimit të drejtave të qytetarëve që të marrin pjesë direkt në marrjen e vendimeve.

### **Materiali për punë:**

- sqarimi i formës formale dhe joformale i iniciativës qytetare (Shtojca nr. 1)
- formulari për plotësimin e dallimeve midis iniciativës formale e joformale (Shtojca nr. 2)
- skema e hyrjes që iniciativës qytetare në procedurë (Shtojca nr. 3)
- formularët bosh për propozim (Shtojca nr. 4).

### **Materiali për punë: (për mësimdhënës)**

- formulari i plotësuar për propozim (Shtojca A)
- sqarimi i propozimit si formë formale e iniciativës qytetare (Shtojca B)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në fillim të orës, mësimdhënësi/mësimdhënësja i rikujton nxënësit se, nocioni i iniciativës qytetare si një nga mënyrat sipas të cilët qytetarët do të marrin pjesë të drejtpërdrejtë në pushtet dihet, dhe se iniciativën qytetare për dallim nga referendumi, e iniciojnë dhe formulojnë vetë qytetarët atëherë kur kanë nevojë ta zgjidhin ndonjë problem shoqëror, ose të realizojnë ndonjë interes të vetin. Iniciativa qytetare mund të jetë formale ose joformale, për të cilën mund të mësojnë më shumë nga shtojca që do t'ua ndajë (Shtojca nr. 1).

Me shtojcën, mësimdhënësi/mësimdhënësja nxënësve ua shpërndan edhe formularin për plotësimin e dallimeve (Shtojca 2), dhe u jep instruksione që ta lexojnë tekstin, t'i vërejnë dallimet midis iniciativës formale dhe joformale, dhe pastaj ta plotësojnë tabelën që e ka marrë secili nga ta. Për këtë detyrë kanë 10 minuta.

Derisa nxënësit punojnë, mësimdhënësi/mësimdhënësja e vizaton tabelën në tabelë (dërrasë të zezë). Kur nxënësit e përfundojnë, mësimdhënësi/ mësimdhënësja i fton vullnetarët t'i lexojnë zgjidhjet e veta, dhe e plotëson tabelën në tabelë (dërrasë të zezë).

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në këtë pjesë të aktiviteteve, mësimdhënësi/mësimdhënësja i njofton nxënësit me atë se cilat kushte duhet t'i përmbushin qytetarët që iniciativa e tyre të futet në procedurën e vendimmarrjes.

Me fjalë tjera, në orët e mëparshme nxënësit kanë simuluar iniciimin e një iniciative. Kjo iniciativë ndonjëherë mjafton që problemi të zgjidhet (që të riparohen rrugët, të hapet Qendra për rininë, rinovohet kinemaja, organizohen ekspozita, seminare, të rregullohen parqet...). Mirëpo, kur një iniciativë e tillë nuk sjellë zgjidhjen e problemeve, qytetarët mund të shkojnë një hap më tutje dhe të iniciojnë procedurën e vendimmarrjes mbi propozimin e tyre para institucioneve kompetente. Qytetarëve kjo e drejtë u është garantuar me Kushtetutë. *Kushti* i cili duhet të përmbushet që qytetarët të mund të shfrytëzojnë këtë të drejtë, ndërlidhet me numrin e caktuar të qytetarëve (është normuar në Kushtetutë apo ligj) të cilët një iniciativë e tillë duhet ta mbështesin.

Pastaj mësimdhënësi/mësimdhënësja i njeh nxënësit me *formën dhe përmbajtjen* që duhet ta përmbushë propozimi.

- Propozimi që i dërgohet Komunës për shqyrtim duhet të jetë i përpiluar në **formën e shkruar**.
- Në propozim detyrimisht ceket **baza juridike** (neni i caktuar i kushtetutës apo ligjit, norma të cilës i referohet propozuesi kur e parashtron propozimin) për marrjen e vendimit. Nxënësve u ceket se nëse do të kenë rastin që vërtetë të parashtrojnë kërkesën, zakonisht për ndihmë juridike rreth bazës juridike, i drejtohen juristëve të cilët mund t'u ndihmojnë në këtë. Për nevojat e këtij ushtrimi mund të vendosni cilindo numërim.
- **Arsyetimi i propozimit** në të cilin ceken arsyet me të cilët është udhëhequr propozuesi me rastin e propozimit të vendimit (ligjit) dhe **objektivave** që dëshirohet të arrihen me marrjen e vendimit (me ligj).
- **Mjetet financiare** që nevojiten për realizimin e vendimit (ligjit) në qoftë se miratimi i saj kërkon mjete financiare.
- **Nënshkrimet e qytetarëve** të cilët e mbështesin propozim vendimin (ligjin) në qoftë se propozimin e parashtrojnë qytetarët.

Propozimi i formuluar kështu i dërgohet kryetarit të Komunës i cili për shqyrtim të mëtejshëm ua përcjellë deputetëve (këshilltarëve), këshillave komunale dhe Qeverisë (Këshillit Ekzekutiv). Në qoftë se qytetarët nuk mund të mbledhin numër të mjaftueshëm të nënshkrimeve, mund të llojnë tek njëri nga deputetët që në emër të tyre të parashtrojë propozimin.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja ua shpërndan nxënësve Shtojcën nr. 3, që të mund të shohin paraqitjen skematike të procedurës së vendimmarrjes mbi propozimin e qytetarëve.

### **Hapi tretë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Nxënësit marrin detyrën që në grupet e veta kryesore, në formularët (Shtojca nr. 4) e përgatitur paraprakisht të formulojnë propozimet në të cilat kanë punuar gjatë dy orëve të mëparshme.

Dy propozimet e përgatitura në fund të orës lexohen para gjithë klasës.



## Shtojca nr. 1

### INICIATIVA QYTETARE

Iniciativa qytetare është një nga mënyrat e pjesëmarrjes imediate të qytetarëve drejtimin e bashkësisë. Ajo nuk mund të realizohet në mënyrë joformale e formale prandaj ashtu flitet mbi iniciativën joformale dhe formale qytetare.

Iniciativë *joformale* qytetare quhet çdo kërkesë me shkrim a me gojë, propozim, lutje apo kritikë të cilën individi ose grupi i qytetarëve ia parashtron ndonjë organi në përpjekje për të iniciuar ndonjë vendim apo të sugjerojë ndonjë zgjidhje. Ajo që këtë iniciativë e bën joformale, është se *nuk është e thënë të përmbushë çfarëdo kushti të normuar formal* (p.sh. mbi numrin minimal të atyre që e parashtrojnë iniciativën, procedurën veçantë për parashtrimin e iniciativës, si dhe me detyrimet dhe veprimin e organit të cilit i adresohet). Me këtë është lehtësuar adresimi i qytetarëve autoriteteve por edhe detyrimi i pushtetit me rastin e një iniciative të tillë është e vogël. Organi të cilit i është adresuar iniciativa është i detyruar vetëm ta shqyrtojë dhe t'i njoftojë qytetarët mbi atë se çfarë është ndërmarrë lidhur me atë iniciativë, por *nuk është e thënë të iniciojë procedurë të veçantë të vendimmarrjes* lidhur me këtë iniciativë. Kjo formë e iniciativës qytetare është vetëm nxitje ose formë e trysnisë mbi ndonjë organ që është i autorizuar të vendosë (deputetët/këshilltarë ose qeveria) dhe nga vlerësimi i lirë i të cilëve varet nëse proceduara e vendimmarrjes edhe do të iniciohet por për këtë nuk ka detyrim formal- juridik.


Për dallim nga kjo, iniciativa *formale* qytetare, nënkupton që kërkesa ose peticioni (të shpesh të për ndryshimin e ndonjë dispozite apo ligji) me të cilën qytetarët i adresohen ndonjë organi, *duhet të kënaqë kushtet formale* që janë normuar me kushtetutë, ligj apo me ndonjë akt tjetër juridik – e që kanë të bëjnë me numrin e caktuar të qytetarëve të cilët duhet ta mbështesin iniciativën me nënshkrimin e vet, në formën e normuar dhe procedurën e parashtrimit të iniciativës, por edhe të vendimmarrjes lidhur me të. Nëse iniciativa është mbështetur nga një numër më i madh i qytetarëve, ajo automatikisht e inicion procedurën e vendimmarrjes në organin të cilit i është adresuar. Duke qenë se kërkon përmbushjen e kushteve, lidhur me numrin e normuar minimal të qytetarëve të cilët me nënshkrimin e vet do ta mbështesin iniciativën, një iniciativë e tillë realizohet më vështirë nga ajo joformale, sepse nevojitet të nxitet interesimi i një numri më të madh të qytetarëve të cilët do ta mbështesin. Por gjasat për suksesin e kësaj iniciative janë shumë më të mëdha, duke pasur parasysh formalitetin e procedurës e cila e *detyron* organin të cilit i parashtrohet se *duhet patjetër ta iniciojë procedurën e vendimmarrjes*. Një iniciativë e tillë mund t'u adresohet shkalleve të ndryshme të pushtetit (kuvendit komunal, kuvendit republikan...) dhe për secilin nga ato është normuar numri i caktuar i nënshkrimeve (p.sh. për ndryshimin e kushtetutës nevojitet të grumbullohet një numër më i madh i nënshkrimeve se sa për ndryshimin apo nxjerrjen e ligjit, ndërsa për vendimin e kuvendit komunal numri i nënshkrimeve është dukshëm më i vogël), si dhe procedura sipas të cilës parashtrohet iniciativa dhe procedura e vendimmarrjes, me rastin e një iniciative të tillë.

## Shtojca 2

### FORMULAR PËR PLOTËSIM

<i>Kriteret</i>	INICIATIVA JOFORMALE QYTETARE	INICIATIVA FORMALE QYTETARE
FORMA-FORMAT NË TË CILËN PARASHRTROHET:		
PARASHTRUESI:		
DETYRIMET E ORGANIT TË PUSHTETIT:		
PËRPARËSITË:		

**Shtojca nr. 3: Skema e hyrjes së iniciativës qytetare në procedurë**



## Shtojca nr. 4

### FORMULARI PËR PROPOZIMIN E INICIATIVËS QYTETARE

*(baza juridike)*

Na bazë të nenit \_\_\_\_\_ të Statutit të Komunës dhe nenit \_\_\_\_\_ të Rregullores së punës,  
parashtroj:

*(përmbajtja e propozimit)*

#### **PROPOZIMI**

---

---

---

---

---

*(përmbajtja e arsytimit)*

#### **ARSYETIMI**

OBJEKTIVI: \_\_\_\_\_

---

---

---

arsyet: \_\_\_\_\_

---

---

---

---

MJETET E NEVOJSHME FINANCIARE:

---

---

---

---

---

PROPOZUESI:

---

## **Materiali për punë**

### **Propozimi A**

## **FORMULARI I PLOTËSUAR PËR PROPOZIM**

Në bazë të nenit 77 paragrafi 1 i Statutit të Komunës dhe nenit 21 të Rregullores së punës, parashtroj:

### **PROPOZIM**

vendimin mbi zhvendosjen e deponisë nga parcela 12/15 në parcelën 17/a

### **ARSEYTIMI**

**OBJEKTIVI:** pakësimi i ndotjes së ujit të pijshëm, i ajrit dhe tokës

**Arsyet:** Deponia gjendet vetëm 800 metra larg burimit të ujit të pijshëm. Me analizën laboratorike të ujit të pijshëm në NP Standard është vërtetuar se uji përmban 25,6% të materialeve helmuese që është më shumë nga sasia e lejueshme. Sipas analizave të Institutit për Mbrojtjen e Shëndetit, në ajër është vërtetuar prania e karbon monoksidit në sasi të që janë të dëmshme për shëndetin e qytetarëve, kurse ndotja është pasojë imediate e djegies së bërllokut në deponi. Sipas raportit të Institutit të njëjtë në tokë janë zbuluar 3 mg cijanid për 1 m<sup>3</sup>.

### **MJETET E NEVOJSHME FINANCIARE**

Gjithsej nevojiten mjete në lartësinë prej 150.000 dinarë sa edhe janë siguruar me kontributet vullnetare të qytetarëve.

### **PROPOZUESI:**

Natasha Gjuriçiq, qytetarja e nënshkruar e para

Në bazë të nenit 34 të Statutit të Komunës dhe nenit 5, paragrafit 2 të Rregullores së punës, parashtroj:

## **PROPOZIMIN**

për akordimin e mjeteve financiare të mbetura në buxhet për vitin 2003 në shumën prej 1.000.000 dinarë për riparimin e sistemit të ujësjellësit në Qupri, në lokalitetet Grza, Nemanja dhe Strelishte.

## **ARSYETIMI**

**OBJEKTIVI:** furnizimi i rregullt i Komunës së Quprisë me ujë në rregull kimiko - bakteriologjik.

**Arsyet:** 1) ndotja e ujit me baktere është 40% më e madhe nga norma e lejuar 2) vjetërsia e sistemit po shkakton pëlcitjen e tubave në riparimin e të cilëve vetëm gjatë vitit të kaluar janë shpenzuar 217.000 dinarë që paraqet përafërsisht 1/5 e mjeteve të nevojshme për sanimin (shërimin) e përhershëm të sistemit; 3) furnizimi me ujë në muajt e verës është vështirësuar (42% të qytetarëve të Quprisë konsideron se furnizimi me ujë është i keq ose shumë i keq).

## **MJETET E NEVOJSHME FINANCIARE**

1.000.000 dinarë nga buxheti i Komunës

## **PROPOZUESI:**

Petar Petroviq, këshilltar i KK të Quprisë

## **Shtojca B**

Shpjegimi i propozimit si formë formale e iniciativës qytetare

### **PROPOZIMVENDIMI (LIGJI) DHE FORMULARI PËR PROPOZIMVENDIMIN**

#### **1. KUSH KA TË DREJTË T’I PARASHTROJË PROPOZIM KUVENDIT**

- Deputeti/deputetja- këshilltari/këshilltarja
- Qeveria – Këshilli Ekzekutiv
- Qytetarët/qytetaret me kusht që propozimin ta mbështesin një numër i caktuar i qytetarëve

#### **2. FORMA QË DUHET TA PËRMBAJË PROPOZIMI**

- propozimi duhet të përpilohet në formë të shkruar
- në propozim detyrimisht ceket baza juridike (neni i caktuar i kushtetutës apo ligjit, norma të cilët i referohet propozuesi kur e parashtron propozimin) për miratimin e vendimit,
- arsyetimi i propozimit ku ceken arsyet me të cilat është udhëhequr propozuesi me rastin e propozimit të vendimit (ligjit) dhe objektivat të cilat dëshirohet në arrihen me miratimin e vendimit (ligjit);
- mjetet financiare (shuma dhe burimi i mjeteve) që nevojiten për realizimin e vendimit (ligjit) në qoftë se vendimi i miratuar kërkon mjete financiare;
- nënshkrimet e qytetarëve/qytetareve të cilët e mbështesin propozim-vendimin (ligjin) në qoftë se propozimin e parashtrojnë qytetarët/qytetaret.

#### **3. KUJT I ADRESOHET PROPOZIMVENDIMI (LIGJI)?**

- PROPOZIMI I ADRESOHET KRYETARIT TË KUVENDIT

#### **4. KRYETARI I KUVENDIT UA ADRESON PROPOZIMVENDIMIN (LIGJIT)**

- deputetëve/deputeteve- këshilltarëve/këshilltareve
- këshillave të kuvendit (këshillat janë trupa punuese të kuvendit në të cilat shqyrtohet propozimi para se të shtrohet në rendin e ditës të sesionit plenar të kuvendit)
- Qeverisë (Qeverisë i adresohen vetëm propozimet të cilat nuk kanë rrjedhur nga vetë Qeveria)

#### **5. RRJEDHA E VENDOSJES MBI PROPOZIMVENDIMIN (LIGJIN)**

- debati në këshillat e kuvendit (këshilli legjislativ e shqyrton anën formale të propozimit, kurse këshilli amë e shqyrton përmbajtjen e propozimit)
- debati në mbledhjes e Qeverisë (në qoftë se propozimin nuk e ka parashtruar Qeveria)
- debati në sesion plenar të Kuvendit.

#### **6. VENDIMMARJA NË MBLEDHJEN PLENARE TË KUVENDIT**

- debati në parim mbi propozim-vendimin (ligjin)
- debati në hollësi (debati zhvillohet nga neni në nen) njëkohësisht zhvillohet debati mbi: tekstin e propozimit, amendamentet që janë dhënë ndaj propozimit, raportet e këshillave të kuvendit dhe mendimin e Qeverisë 9 në qoftë se propozimi nuk rrjedh nga Qeveria)

## 7 VOTIMI

- me përfundimin e debatit mbi propozim-vendimin (ligjin) votohet për miratimin e vendimit (ligjit) në parim
- me përfundimin e debatit mbi nenin e caktuar të vendimit (ligjit), me amendamente ndaj atij neni dhe me raportet e këshillave të kuvendit e të Qeverisë, votohet për nenin konkret
- me përfundimin e debatit në hollësi, votohet për vendimin (ligjin) në tërësi (atëherë vendimi është miratuar)

## 8. REFERENDUMI I QYTETARFËVE

- në qoftë se mbi vendimin (ligjin) vendoset në referendum, vendimi nxirret në referendum.



## **Punëtorja: KUVENDI – PËRGATITJA PËR SESION**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është njohja me strukturën dhe funksionimin e Kuvendit si një nga institucionet e pushtetit, dhe njohja me rregullat e punës dhe procedurën e vendimmarrjes në Kuvend.

### **DETYRAT:**

- njohja me rregullat dhe procedurat në Kuvend
- ndarja e roleve (Kryetari i Kuvendit, sekretari, kryetari i KE, kryetarët e trupave të kuvendit këshilltarët, vëzhguesit)

### **Materiali për punë:**

- pankartat-përkujtuesit 1-4 (të përgatitur paraprakisht)
- Sesion i Kuvendit (Shtojca nr. 1)
- Rregullat e përgjithshme lidhur me votimin dhe procedurën e votimit (Shtojca nr. 2)
- Kartat me rolet (Shtojca nr. 3)
- Rregullat e punës së Kuvendit (Shtojca nr. 4)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i rikujton nxënësit se në orët e kaluara kanë marrë pjesë në formulimin e iniciativave qytetare. Ata i kanë parashtruar atëherë propozimet e veta Kuvendit të Komunës dhe ato propozime kanë hyrë në procedurën e kuvendit. Mbi ato do të vendoset në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja u thotë nxënësve se në këtë orë do t'i njoftojë me procedurën e vendimmarrjes në Kuvend dhe me rregullat e sjelljes që vlejné gjatë sesionit të Kuvendit. Gjithashtu, nxënësve do t'u ndahen role të caktuara, sepse në orën tjetër do të marrin pjesë në simulimin e sesionit të Kuvendit. Kjo do të jetë mbledhja e Kuvendit të Komunës, në të cilën do të shqyrtohen iniciativat e arritura qytetare dhe do të vendos mbi propozimet e dhëna. Në pjesën e fundit të orës, nxënësit njihen me rregullat e sjelljes që vlejné gjatë sesionit të Kuvendit.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i informon nxënësit se mbledhjen e thërret kryetari i Kuvendit. Ai/ajo e kryeson mbledhjen e Kuvendit dhe kujdeset për përgatitjen e rregullores së punës (rregullat e punës së Kuvendit). Kryetarin në përgatitjen dhe drejtimin e mbledhjes e ndihmon sekretari i Kuvendit.

Pastaj, mësimdhënësi/mësimdhënësja e var në mur pankartën-përkujtuesin nr. 1. “Sesioni i Kuvendit” në të cilën është prezantuar procedura e vendimmarrjes në Kuvend dhe i informon nxënësit se një sesion i Kuvendit të Komunës i përfshin këto elemente:

1. Hapjen e mbledhjes
2. Konstatimi i kuorumit
3. Miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar
4. Përcaktimin e rendit të ditës

5. Shqyrtimin e pikave nga rendi i ditës
  - a. Ekspozeja i propozuesit të parë
  - b. Ekspozeja i propozuesit të dytë
  - c. Paraqitja e qëndrimit të Këshillit ekzekutiv mbi propozimin
6. Diskutimi
7. Votimi mbi pikat nga rendi i ditës
8. Mbyllja e mbledhjes

Secili nga elementet e cekur, mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet t'i sqarojë në vija të shkurta duke u mbështetur me këtë rast në Shtojcën nr. 1.

Pastaj mësimdhënësi/mësimdhënësja e var në mur pankartën-përkujtuesin nr. 2. "Votimi" dhe shkurtimisht i informon nxënësit mbi atë se si zbatohet votimi i Kuvendit rreth propozimeve. Me këtë rast mbështetet në Shtojcën nr. 2. Është qenësore që mësimdhënësi/mësimdhënësja në ekspozenë e vet të vështrojë këto veti të votimit:

1. Në Kuvend vendoset me votimin e këshilltarëve
2. Para çdo votimi konstatohet kuorumi
3. Këshilltarët mund të votojnë "pro" propozimit, "kundër propozimit ose të përmbahen nga votimi
4. Votimi është publik, me ngritje dore
5. Numërohen votat – konstatohet sa këshilltarë kanë votuar për propozimin, kundër propozimit apo kanë qenë të përmbajtur
6. Kumtohen rezultatet e votimit
7. Konsiderohet se propozimi është miratuar në qoftë se për atë ka votuar shumica nga gjysma e këshilltarëve të pranishëm.

### Hapi dytë

(Kohëzgjatja: 20 minuta )

Kur nxënësve ua prezanton procedurën e vendosjes në Kuvend dhe votimin, mësimdhënësi/mësimdhënësja var në mur pankartën- rikujtuesin nr. 3. "Rolet" dhe i informon nxënësit se në simulim do të paraqiten këto role:

- Kryetari i Kuvendit
- Sekretari i Kuvendit
- Kryetari i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit
- Kryetarët e grupeve të këshilltarëve
- Këshilltarët
- Vëzhguesit

Pastaj i fton nxënësit ta propozojnë personat të cilë në simulim do të ushtrojnë rolin e **Kryetarit të Kuvendit, Sekretarit të Kuvendit dhe të Kryetarit të Këshillit Ekzekutiv**. Nxënësit e zgjedhur i marrin rolet e shkruara në kartela (shtojca nr. 3). Detyra e tyre është të njihen me rolet e veta dhe këto role t'ua prezantojnë nxënësve të tjerë

Gjatë asaj kohe, mësimdhënësi/mësimdhënësja i ndan nxënësit e tjerë të paraleles në dy grupe, në mënyrë që secili nxënës të shkojë tek ai grup ku ka qenë me rastin e formulimit të iniciativës qytetare. Mirëpo, nxënësve iu duhet tërhequr vëmendjen se tani janë këto dy grupe të këshilltarëve që do të marrin pjesë në sesionin e Kuvendit. Detyra e secilit grup është të merren vesh dhe ta zgjedhin **kryetarin e grupit të vetë të këshilltarëve** dhe dy persona të cilët gjatë simulimit do të kenë rolin e **vëzhguesit**. Nxënësit e tjerë në simulim do të jenë në rolin e këshilltarit.

Kur grupet e këshilltarëve e zgjedhin kryetarin dhe vëzhguesit, mësimdhënësi/mësimdhënësja ua ndan kartelet me përshkrimin e roleve dhe u thotë se detyra e tyre është që të njihen me rolin që e kanë marrë dhe për këtë kanë 5-10 minuta .

Pason prezantimi i shkurtër i të gjitha roleve (Kryetarit të Kuvendit, Sekretarit të Kuvendit, Kryetarit të Këshillit Ekzekutiv, kryetarit të grupeve të këshilltarëve, të këshilltarëve, të vëzhguesve.

### **Vërejte:**

Duke qenë se kryetarët e grupeve të këshilltarëve në fillim të simulimit do t'i arsyetojnë propozimet, është e nevojshme t'u ceket grupeve që për kryetar t'i zgjedhin ata nxënës për të cilët konsiderojnë se janë folës më të mirë.

### **Hapi tretë:**

(Kohëzgjatja: 10 minuta )

Në vazhdim të orës mësimdhënësi/mësimdhënësja e var në mur pankartën-përkujtuese nr. 4. “Diskutimi në Kuvend- mbi çfarë duhet treguar kujdes” dhe në vija të shkurta e sqaron secilin nga këto rregulla. Në sqarimin e rregullave, mësimdhënësi/mësimdhënësja mbështetet në Shtojcën nr. 4. Gjithashtu, mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet t'ua tërheqë vëmendjen nxënësve në rëndësinë e respektimit të këtyre rregullave gjatë simulimit të sesionit të Kuvendit. Këto rregulla janë:

1. Paraqitja për fjalë
2. Marrja e fjalës
3. Dhënia e fjalës
4. Ekspozeja jashtë radhës
5. Paraqitja e propozimit
6. Kohëzgjatja e ekspozesë
7. Përmbajtja e ekspozesë
8. Ndërprerja dhe tërheqja e vërejtjes folësit
9. Respektimi i folësit
10. Replika
11. Privatësia e folësit

Në fund të orës, mësimdhënësi/mësimdhënësja ua shpërndan nxënësve shtojcën “Sesioni i Kuvendit”, “Rregullat e përgjithshme lidhur për votimin dhe procedura e votimit” dhe “Rregullat e punës së Kuvendit” (Shtojcat nr. 1, 2 e 4) dhe i lut ata që deri në orën e ardhshme me marrjen e roleve t'i studiojnë mirë edhe këto shtojca, që me sukses të mund të marrin pjesë në simulimin e sesionit të Kuvendit që pason.

### **Vërejte:**

Katër pankarta që janë përgatitur dhe shfrytëzuar për këtë orë, duhet të ruhen dhe sërish të varen në mur para fillimit të simulimit të sesionit të Kuvendit.

## **Materiali për punë**

### **Pankarta 1.:**

#### SESIONI I KUVENDIT

- Hapja e mbledhjes
- Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme
- Konstatimi i kuorumit
- Konfirmimi i rendit të ditës
- Shoshitja e pikave të rendit të ditës
  - Ekspozeja i propozuesit të parë
  - Ekspozeja i propozuesit të dytë
  - Paraqitja e qëndrimit të Këshillit Ekzekutiv mbi propozimin
- Diskutimi
- Votimi mbi pikat e rendit të ditës
- Mbyllja e mbledhjes

### **Pankarta 2.:**

#### VOTIMI

1. Në Kuvend vendoset me votimin e këshilltarëve
2. Para çdo votimi vërtetohet kuorumi
3. Këshilltarët mund të votojnë “pro” propozimit, “kundër” propozimit ose të përmbahen nga votimi
4. Votohet hapur, me ngritjen e dorës
5. Numërohen votat
6. Kumtohen rezultatet e votimit
7. Konsiderohet se propozimi është miratuar në qoftë se për atë kanë votuar më shumë nga gjysma e këshilltarëve të pranishëm

### **Pankarta 3.:**

#### ROLET

1. Kryetari i Kuvendit
2. Sekretari i Kuvendit
3. Kryetari i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit
4. kryetarët e grupeve të këshilltarëve
5. këshilltarët
6. vëzhguesit

#### **Pankarta 4.:**

#### **DISKUTIMI NË KUVEND – MBI ÇFARË DUHE TREGUAR KUJDES**

1. Paraqitja për fjalë
2. Marrja e fjalës
3. Dhënia e fjalës
4. Ekspozeja jashtë rendit
5. paraqitja e propozimit
6. Kohëzgjatja e ekspozesë
7. Përmbajtja e ekspozesë
8. Ndërprerja dhe tërheqja e vërejtjes folësit
9. Respektimi i folësit
10. Replika
11. Privatësia e folësit

## Shtojca nr. 1:

### SESIONI I KUVENDIT

- **Thirrja e mbledhjes**

Mbledhjen e thërret Kryetari i Kuvendit

- **Përpilimi i propozimit të rendit të ditës**

Propozimin e rendit të ditës e përpilon Kryetari i Kuvendit në bazë të propozimeve të arritura nga këshilltarët, respektivisht të grupeve të këshilltarëve. Propozimet e grupeve të këshilltarëve shtrohen në rendin e ditës sipas renditjes që kanë arritur.

#### **HAPJA E MBLEDHJES**

Kryetari i Kuvendit e hap dhe e kryeson mbledhjen e Kuvendit. Gjatë mbledhjes ai/ajo kujdeset mbi zbatimin e Rregullores së punës (rregullat e punës së Kuvendit). Sekretari i Kuvendit e ndihmon Kryetarin në përgatitjen dhe drejtimin e mbledhjes.

#### **KONFIRMIMI I KUORUMIT**

Kuorumi konfirmohet në fillim të mbledhjes së Kuvendit dhe para çdo votimi. Kuorumi për punën e Kuvendit ekziston kur në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve. Kuorumin e konfirmon Kryetari i Kuvendit me ndihmën e Sekretarit (i cili i numëron këshilltarët e pranishëm).

- Me rastin e verifikimit të të kuoromit është domosdoshme të shfaqet kujdes mbi atë që Kryetari i Këshillit Ekzekutiv dhe Sekretari i Kuvendit nuk janë anëtarë të Kuvendit, prandaj edhe nuk llogaritet në kuorum, as që votojnë mbi propozimet. Kryetari i Kuvendit është anëtar i Kuvendit, llogaritet në kuorum dhe voton mbi propozimet.

#### **MIRATIMI I PROCESVERBALIT NGA MBLEDHJA E KALUAR**

Me rastin e konfirmimit të rendit të ditës miratohet procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Mbi vërejtjet ndaj procesverbalit të Kuvendit vendoset pa debat. Në fillim të simulimit nuk miratohet procesverbalit duke qenë se nuk ka ekzistuar mbledhja e mëparshme.

#### **KONFIRMIMI I RENDIT TË DITËS**

Rendin e ditës e miraton Kuvendi. Mbi përqafimin e propozimit të rendit të ditës vendosin këshilltarët me votim. Këshilltarët kanë të drejtë t'i propozojnë ndryshimet dhe plotësimet e rendit të ditës. Mbi propozimin për ndryshime e plotësime të rendit të ditës vendos Kuvendi, pas debatit. Kryetari i Kuvendit e nxjerrë propozimin e rendit të ditës në votim. Rendi i ditës është i miratuar nëse për atë votojnë më shumë se gjysma e këshilltarëve të pranishëm. Kryetari i Kuvendit pas votimit mbi rendin e ditës konstaton se rendi i ditës është përqafuar.

#### **SHQYRTIMI I PIKAVE TË RENDIT TË DITËS**

##### **Paraqitja e propozimit**

Kryetari e hap shqyrtimin e pikave të rendit të ditës dhe ia jep fjalën propozuesit. Propozimet paraqiten sipas renditjes që i kanë arritur Kryetarit të Kuvendit. Propozimin e paraqet dhe e arsyeton parashtuesi i propozimit, respektivisht kryetari i grupit të këshilltarëve. Për nevojat e këtij simulimi koha është e kufizuar në 3 minuta. Ai/ajo ka të drejtë të flasë më gjatë nga këshilltarët e tjerë, mund të flasë disa herë gjatë mbledhjes dhe kur lajmërohet për fjalë gjatë diskutimit, ka përparësi karshi këshilltarëve të tjerë.

### **Paraqitja e qëndrimit të Këshillit Ekzekutiv mbi propozimin**

Këshilli Ekzekutiv është “Qeveria e komunës”. Kryetari, respektivisht Kryetari i Këshillit Ekzekutiv e paraqet qëndrimin e Këshillit Ekzekutiv mbi secilin nga propozimet, pasi që ato janë prezantuar, kurse përpara diskutimit mbi secilën nga ato. Qëndrimi i Këshillit Ekzekutiv para se gjithash ka të bëjë me nevojën e Komunës dhe me shumën e mjeteve të cilat i kërkon nga Komuna secili nga propozuesit. Si “Qeveria e Komunës”, Këshilli Ekzekutiv menaxhon buxhetin e Komunës. Këshilli Ekzekutiv mund ta mbështesë propozimin në tërësi apo pjesërisht (respektivisht miraton të gjitha apo pjesën e mjeteve të kërkuara) ose refuzon ta mbështesë propozimin.

### **Diskutimi mbi propozimet**

Këshilltarët lajmërohen për fjalë, Sekretari këtë e shënon dhe ia përcjellë Kryetarit. Kryetari ua jep fjalën këshilltarëve sipas renditjes që janë lajmëruar për fjalë. Sekretari i Kuvendit e mat kohën (secili këshilltar në këtë simulim për ekspozitën e vet ka në dispozicion 1 minutë). Që sa më shumë nxënës të merrnin pjesë në diskutim do t’ua kufizojë këshilltarëve mundësinë e marrjes së fjalës në më së shumti dy herë.

Në simulimin tonë të drejtën për të folur “jashtë rendit” kanë: kryetarët e grupeve të këshilltarëve dhe përfaqësuesi i Këshillit Ekzekutiv. Gjithashtu t’u kufizohet përfaqësuesve të grupeve të këshilltarëve se mund ta marrin fjalën jashtë radhës, më së shumti 2 herë. Kryetari i Këshillit Ekzekutiv do ta marrë fjalën kur ta kërkojë dhe me atë nuk ka të bëjë kufizimi lidhur me kohëzgjatjen për ekspozim.

### **VOTIMI**

Kuvendi vendos me votimin e këshilltarëve. Këshilltarët votojnë “pro” propozimit, “kundër” propozimit ose përmbahen nga votimi. Votohet hapur me ngritjen e dorës. Me kërkesë të këshilltarëve Kuvendi mund të vendosë që votimi të bëhet i fshehtë. Para çdo votimi konfirmohet kuorumi.

- Votimi bëhet i tillë që Kryetari i Kuvendit i pyet këshilltarët: Kush është pro propozimit... (lexohet krejt “titulli” i propozimit). Këshilltarët që janë pro propozimit, deklarohen me ngritjen e dorës. Sekretari i Kuvendit i numëron votat pro dhe i shënon ato. Pastaj Kryetari pyet: Kush është kundër... Këshilltarët deklarohen sipas mënyrës së njëjtë, Sekretari i numëron dhe e shënon numrin e votave kundër. Pastaj Kryetari pyet: A është dikush i përmbajtur? Përsëritet procedura e njëjtë e numërimit.

Grupi i këshilltarëve mund ta caktojë një anëtar të vetin për kontrollin e votimit.

### **PËRFUNDIMI I MBLEDHJES**

Pas votimit Kryetari i Kuvendit e përfundon votimin dhe e kumton rezultatin e votimit. Kryetari konstaton se propozimi është miratuar, respektivisht është refuzuar me X vota pro, Y vota kundër, dhe Z vota abstenim. Vendimi konsiderohet i nxjerrë nëse për atë kanë votuar më shumë se gjysma e këshilltarëve të pranishëm.

Gjatë diskutimit mund të arrihet afrimi i dy propozimeve, në cilin rast mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet ta ndalë diskutimin dhe të sqarojë se nëse ka ndodhur propozimi i ri i cili do t’i bashkonte të dy, deputetët duhet ta tërheqin propozimet e veta dhe sërish të parashtrajnë propozimin e ri mbi të cilin do të diskutohet në mbledhjen e ardhshme.

## Shtojca nr. 2

### RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR VOTIM DHE PROCEDURA E VOTIMIT

1. Kuvendi vendos me votimin e këshilltarëve
2. Këshilltarët votojnë “pro” propozimit, “kundër” propozimit ose përmbahen nga votimi.
3. Votohet hapur me ngritjen e dorës. Me kërkesë të këshilltarëve, Kuvendi mund të vendosë që votimi të jetë i fshehtë.
4. Gjatë cilit votim konstatohet kuorumi
5. Votimi bëhet i tillë që Kryetari i Kuvendit i pyet këshilltarët: “Kush është pro propozimit...” (e lexon tërë “titullin” e propozimit). Këshilltarët që janë pro propozimit, deklarohen me ngritjen e dorës. Sekretari i Kuvendit i numëron votat pro dhe i shënon.
6. Pastaj Kryetari pyet: “Kush është kundër...”. Këshilltarët deklarohen në mënyrë të njëjtë, Sekretari e numëron dhe e shënon numrin e votave kundër.
7. Pastaj Kryetari pyet: “A është dikush i përmbajtur?”. Përsëritet procedura e njëjtë e numërimit.
8. Pas votimit, Kryetari i Kuvendit e përfundon votimin dhe e kumton rezultatin e votimit. Kryetari konstaton se propozimi është miratuar, respektivisht është refuzuar me X vota pro, Y vota kundër dhe Z abstenime
9. Vendimi konsiderohet i miratuar në qoftë se për atë votojnë më shumë se gjysma e këshilltarëve të pranishëm.
10. Grupi i këshilltarëve mund ta caktojë një anëtar të vetin për kontrollin e votimit.



## Shtojca nr. 3

### KARTELAT ME ROLET

#### **Kryetari i Kuvendit**

- Kryetari i Kuvendit e hap mbledhjen e Kuvendit dhe konstaton nëse ekziston kuorumi për punë. Kuorumi ekziston në qoftë se në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e këshilltarëve.
- Kryetari i fton këshilltarët të votojnë për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar (gjatë simulimit ky hap do të kapërcehet duke qenë se mbledhja e mëparshme nuk ka ekzistuar.
- Kryetari e nxjerr në votim propozimin e rendit të ditës (në rastin e këtij simulimi ekziston vetëm një pikë e rendit të ditës – dy propozime që janë formuluar në orën e kaluar). *Para votimit për miratimin e rendit të ditës konfirmohet kuorumi e pastaj deputetët (këshilltarët) votojnë “pro”, “kundër”, “abstenim”.* Rendi i ditës miratohet nëse për atë votojnë më shumë se gjysma e këshilltarëve të pranishëm. Kryetari i Kuvendit pas votimit për rendin e ditës, konstaton se rendi ditës është përqafuar apo jo.
- Kryetari e hap shqyrtimin e pikave të rendit të ditës (në rastin e këtij simulimi ku ekziston vetëm një pikë e rendit të ditës, i jepet fjala propozuesit të parë, e pastaj edhe tjetrit) pas të cilëve Kryetari i Këshillit Ekzekutiv arsyeton qëndrimin e vet.
- Kryetari ua jep fjalën këshilltarëve sipas rendit me të cilin janë lajmëruar për fjalë.

Për rendin në mbledhje kujdeset Kryetari. Ai mund t’ua marrë fjalën, të shqiptojë sanksione në rast të mosrespektimit të rregullave të rendit. Për shkak të shkeljes së rendit në mbledhje ai mund të shqiptojë këto masa: vërejtjen ose marrjen e fjalës. Masën e largimit të deputetit (këshilltarit) nga mbledhja e shqipton Kuvendi me propozim të Kryetarit. Në qoftë se me masa të rregullta nuk mund të mbahet rendi në mbledhje, Kryetari e cakton pauzën me kohëzgjatjen e nevojshme për vendosjen e rendit.

#### **Sekretari i Kuvendit**

Sekretari i Kuvendit e ndihmon Kryetarin në drejtimin e mbledhjes:

- Me rastin e konfirmimit të kuorumit i numëron këshilltarët e pranishëm.
- gjatë diskutimit shënon rendin sipas të cilit këshilltarët lajmërohen për fjalë dhe shfaq kujdes për kufizimet kohore.
- para vetë votimit i numëron këshilltarët.
- me rastin e votimit numëron sa vota janë pro, kundër apo abstenime.

Sekretari nuk është anëtar i Kuvendit, nuk mund të lajmërohet për fjalë, as të votojë për propozimet, sikurse as Kryetari i Këshillit Ekzekutiv.

### **Kryetari i Këshillit Ekzekutiv**

Kryetari i Këshillit Ekzekutiv nuk është anëtar i Kuvendit. Domethënë, nuk llogaritet me rastin e konfirmimit të kuorumit dhe nuk ka të drejtën e votës, as Sekretari. Ai/ajo deklarohet mbi pikat e rendit të ditës, sepse Këshilli Ekzekutiv drejton buxhetin e komunës. Këshilli Ekzekutiv mund ta mbështesë propozimin në tërësi apo pjesërisht (respektivisht të miratojë të gjitha ose pjesën e mjeteve të kërkuara) apo të refuzojë ta mbështesë propozimin. (Në simulim do të bëhet deklarimi mbi një pikë të rendit të ditës - ndarja e mjeteve nga buxheti. Kryetari i Këshillit Ekzekutiv duhet të kumtojë se mund të miratohet pjesa e mjeteve të kërkuara e cila nuk e kënaq asnjë propozim.)

### **Kryetari i grupit të këshilltarëve**

- Kryetarët e grupeve të këshilltarëve kanë tre minuta në fillim të Mbledhjes t'i paraqesin propozimet e veta.
- Gjatë diskutimit kryetarët e grupeve të këshilltarëve mund të flasin disa herë dhe kanë të drejtë ta marrin fjalën jashtë rendit. Kryetarët e grupeve të këshilltarëve mund ta marrin fjalën jashtë rendit më së shumti 2 herë.

(Për nevojat e simulimit e drejta e kryetarëve të grupeve të këshilltarëve ta marrin fjalën jashtë rendit, është e kufizuar në dy herë, që sa më shumë nxënës të kenë rastin të lajmërohen për diskutim.)

### **Këshilltarët**

Këshilltarët në Kuvend mund të lajmërohen për fjalë gjatë diskutimit dhe ta marrin fjalën sipas renditjes së paraqitjeve dhe pas kësaj votojnë mbi pikat e rendit të ditës.

(Këshilltarët në simulim mund të flasin më së shumti 1 minutë, në mënyrë që të kenë rastin të lajmërohen për diskutim sa më shumë nxënës.)

### **Vëzhguesit**

Vëzhguesit gjatë sesionit të Kuvendit përcjellin me kujdes:

- argumentet që shfrytëzohen në debat
- a shtrembërohen faktet, fshehën apo anashkalohen
- cila është esenca e mospajtimit midis grupeve të këshilltarëve
- a respektohen rregullat e procedurës
- a merret në konsideratë mendimi tjetër
- a ka largim nga tema
- a ka pasur të argumente të thëna
- a janë lajmëruar këshilltarët për fjalë në harmoni me procedurën

## Shtojca nr. 4

### RREGULLAT E PUNËS SË KUVENDIT

#### Rregullat e përgjithshme të ndërlidhura me diskutimin:

- 1. Lajmërimi për fjalë**  
Askush nuk mund të flasë në mbledhje para se të lajmërohet për fjalë
- 2. Marrja e fjalës**  
Këshilltarët e marrin fjalën me atë rend sipas të cilit janë lajmëruar, e për të cilin shfaq kujdes Sekretari i Kuvendit.
- 3. Dhënia e fjalës**  
Askush nuk mund t'i afrohet foltores derisa Kryetari nuk ia jep fjalën
- 4. Ekspozeja jashtë radhës**  
Të drejtën për të folur "jashtë radhës" e kanë kryetari i grupit të këshilltarëve dhe Kryetari i Këshillit Ekzekutiv. Kryetarët e grupeve të këshilltarëve në këtë simulim mund ta marrin fjalën jashtë radhës më së shumti 2 herë.
- 5. Paraqitja e propozimit**  
Kryetarët e grupeve të këshilltarëve në simulim kanë 3 minuta në fillim të mbledhjes t'i paraqesin propozimet e veta.
- 6. Kohëzgjatja e ekspozesë**  
Deputetët mund të ekspozojnë më së shumti 1 minutë (mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se koha që këshilltarët e kanë në dispozicion, është e përcaktuar me rregulloren e punës, por për nevojat e simulimit kjo kohë është e shkurtuar).
- 7. Përmbajtja e ekspozesë**  
Folësi mund të flasë vetëm mbi çështjen e cila është në rendin e ditës.
- 8. Ndërprerja dhe tërheqja e vërejtjes folësit**  
Askush nuk mund ta ndërpresë folësin, as t'ia tërheqë vërejtjen, përpos Kryetarit të Kuvendit në rastet që janë të normuara në rregulloren e punës (rregullat e punës të Kuvendit). Kryetari mund të shqiptojë vërejtjen ose masën e marrjes së fjalës. Masat e largimit të këshilltarit nga mbledhja i shqipton Kuvendi me propozim të Kryetarit.
- 9. Konsiderata i folësit**  
Gjatë kohës derisa folësi flet nuk është e lejueshme hedhja e fjalëve ose pengimi i folësit në ndonjë mënyrë tjetër, si dhe çdo procedim tjetër që e rrezikon lirinë e të folurit. Këshilltarët janë të detyruar ta respektojnë dinjitetin e Kuvendit dhe njëri-tjetrit t'i drejtohen me respekt.
- 10. Replika**  
Në qoftë se këshilltari në ekspozenë e vet bën deklaratë fyese për këshilltarin tjetër ose grupin e këshilltarëve, këshilltari ka të drejtën e replikës respektivisht kryetari i grupit të këshilltarëve në qoftë se ekspozeja fyese ka të bëjë me gjithë grupin. Replika nuk mund

të kërkohet në bazë të përmendjes së thjeshtë të emrit të këshilltarit ose grupit të këshilltarëve.

**11. Privatësia e këshilltarit**

Nuk është i lejueshëm shfrytëzimi i shprehjeve fyese dhe as paraqitja e fakteve ose e vlerësimeve që kanë të bëjnë me privatësinë e jetës së personave tjerë.

## **Punëtorja: KUVENDI – SESIONI**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj ore është që me anë të simulimit të sesionit të Kuvendit, nxënësit të njihen me funksionimin e Kuvendit si një nga institucionet e pushtetit dhe me procedurën në bazë të së cilës në Kuvend vendos për propozimet e qytetarëve.

### **DETYRAT:**

- paraqitja e propozimeve të qytetarëve
- diskutimi për propozimet e qytetarëve
- votimi për propozimet e qytetarëve

### **Materiali:**

- Pankartat “Sesioni i Kuvendit”, “Votimi”, “Roli”, “Diskutimi në Kuvend - rregullat e përgjithshme”.

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 35 minuta)

Para fillimit të orës, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja i var në mur pankartat “Sesioni i Kuvendit”, “Votimi”, “Roli”, “Diskutimi në Kuvend – rregullat e përgjithshme”, në mënyrë që gjatë simulimit të sesionit të Kuvendit nxënësve do t’u shërbejnë si përkujtues.

Në fillim të orës, mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja paralajmëron se në këtë orë do të zhvillohet simulimi i sesionit të Kuvendit në të cilin do të vendoset mbi dy propozime të qytetarëve. Pastaj i lut nxënësit që të zënë vendet përkatëse në klasë, në harmoni me rolin që do ta lozin gjatë simulimit.

### **Vërejte:**

Kryetari/Kryetarja e Kuvendit, Sekretari i Kuvendit dhe Kryetari i Këshillit Ekzekutiv (KE) duhet të ulën në “tavolinën kryesuese”, kryetarët e grupeve të këshilltarëve me këshilltarët e vet janë të grupuar në pjesët e kundërta të klasës, ndërsa vëzhguesit duhet të ulën në fund të saj. Përpos “tavolinës së kryesuesve” në klasë lypset të bihet edhe “foltorja” nga e cila do të paraqesin propozimet dhe do të diskutojnë gjatë shqyrtimit të propozimeve.

Pas kësaj mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja e fton nxënësin i cili e luan rolin e Kryetarit/Kryetares së Kuvendit ta hapë dhe kryesojë mbledhjen e Kuvendit. Sesioni i Kuvendit zhvillohet sipas procedurës së dakorduar.

### **Vërejte:**

Me rastin e sesionit të Kuvendit mësimitdhënësi/mësimitdhënësjja ofron ndihmë sipas nevojës.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i lut nxënësit ta komentojnë se në ç' masë janë të kënaqur me punën e Kuvendit dhe rezultatet e votimit. Pas kësaj i fton edhe vëzhguesit të paraqesin vështrimin konkret ndaj sesionit të Kuvendit.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja ua tërheq vëmendjen nxënësve për epilogët e mundshëm të procesit të vendimmarrjes – mbivotimi nga ana e një grupi të këshilltarëve, lobimi i këshilltarëve nga grupi tjetër i këshilltarëve, arritja e kompromisit dhe modifikimi i propozimit me qëllim të arritjes së vendimit optimal.

Gjithashtu, lypset të vihet në pah edhe “raporti i forcave në Kuvend” – në qoftë se njëri nga grupet e këshilltarëve është me numër më të madh, atëherë kjo mund të sjellë miratimin e propozimit për të cilin ata angazhohen, pavarësisht nga vlera dhe esenca e propozimit.

## **Punëtorja: SHOQATAT E QYTETARËVE - E DREJTA PËR VETORGANIZIM**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen me nocionin *shoqata e qytetarëve (organizata joqeveritare)*

### **DETYRAT:**

- Njohja me nocionin, rolin dhe llojet e shoqatave të qytetarëve
- Kuptimi i karakteristikave të shoqatave të qytetarëve

### **Materiali për punë:**

- Lista e shoqatave të qytetarëve - për nxënës (Shtojca nr. 1)
- Organizimi i qytetarëve, llojllojshmëria terminologjike - për nxënës (Shtojca nr. 2)
- Karakteristikat e shoqatave të qytetarëve – për mësimdhënës (Shtojca nr. 3)

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja, me rastin e paralajmërimit të temës së re me të cilën do të merren në punëtoritë që pasojnë, i rikujton nxënësit se tanimë janë ndeshur me nocionin shoqatat e qytetarëve në punëtorinë “*Karakteristikat e shoqërisë civile*”. Atëherë kanë qenë në rolin e qytetarëve të cilët kanë formuar shoqatën e vet për të mbrojtur disa të drejta të veta ose të realizojnë ndonjë nevojë dhe interes të vetin. Me këtë rast ia kanë dhënë emrin shoqatës, janë lidhur me organizatat tjera dhe e kanë ftuar pushtetin për bashkëpunim dhe përgjegjësi në zgjidhjen e problemeve shoqërore.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja përpiket që nxënësit ta rikujtojnë sa më mirë problemin rreth të cilit janë grumbulluar në atë ushtrim dhe aktivitetet që i kanë ndërmarrë. Është me rëndësi që mësimdhënësi/ mësimdhënësja të përmendë se *shoqëria civile* është term i cili shfrytëzohet për qytetarët që veprojnë në funksion të të mirës së përgjithshme, qofshin si individë, qofshin si pjesëtarë të grupit e organizatave, me anë të iniciativës qytetare dhe në kuadër të shoqatave qytetare.

Është e domosdoshme që mësimdhënësi/mësimdhënësja t’i rikujtojë nxënësit se qytetarët tubohen rreth një objektivi, i bashkojnë dhe organizojnë aktivitetet e veta edhe kur ndërmarrin iniciativën qytetare, por që ajo shoqatë të mos ketë karakter të përhershëm dhe formal, si në rastin e formimit të *shoqatave të qytetarëve* – organizatë për formimin e së cilës nevojitet të regjistrohet sipas procedurës së veçantë ligjore. Gjithashtu, mësimdhënësi/ mësimdhënësja përmend se e drejta e qytetarëve për bashkim dhe vetorganizim është garantuar me kushtetutë.

### **Hapi dytë:**

(Kohëzgjatja: 20 minuta)

Në këtë pjesë të aktivitetit, nxënësit tubohen në grupe të vogla (secili grup numëron 4-5 nxënës), kurse mësimdhënësi/mësimdhënësja jep instruksione grupeve të formuara që t’i rikujtojnë shoqatat e qytetarëve (ose, si quhen ato ndryshe, organizatat joqeveritare), për aktivitetet e të cilave kanë mësuar. Nxënësit mund të cekin si organizatat vendore ashtu edhe

ato ndërkombëtare dhe është e domosdoshme të këmbëjnë mendimet e veta dhe të përgjigjen në këto pyetje:

- Çfarë janë shoqatat e qytetarëve?
- Përse krijohen dhe me të cilat aktivitete merren?

Mësimdhënësi/mësimdhënësja pyetjet i shkruan në tabelë dhe u jep nxënësve dhjetë minuta për punë. Kur nxënësit në nivel të grupit e përfundojnë punën, përfaqësuesit e grupeve i paraqesin përgjigjet të cilat mësimdhënësi/mësimdhënësja i shkruan në tabelë. Mësimdhënësi/mësimdhënësja përpiket edhe t'ua thellojë përgjigjet e nxënësve duke bërë edhe pyetje shtesë në harmoni me zhvillimin e diskutimit (p.sh., nëse në pyetjen përse krijohen shoqatat e qytetarëve përgjigjen “Për të zgjidhur problemet”, është e domosdoshme që mësimdhënësi/ mësimdhënësja t'i ftojë ata të mendohen se kush tjetër mund ta zgjidhë atë problem, a është mirë që qytetarët të merren ekskluzivisht me këtë problem apo ekskluzivisht të mbështeten tek shteti etj.)

Në pjesën e këtij hapi, ku nxënësit cekin se me cilat aktivitete merren disa shoqata të qytetarëve, mësimdhënësi/mësimdhënësja e hap mundësinë e klasifikimit të organizatave të qytetarëve, duke theksuar se janë të mundshme klasifikime të ndryshme në bazë të kritereve të ndryshëm:

- fusha e aktivitetit (kultura, arsimit, shëndetësia, mbrojtja sociale, mbrojtja e ambientit të jetesës, zhvillimi ekonomik e social, të drejtat qytetare e ngjashëm.)
- lloji i aktiviteteve (humanitare, aktivitete paqësore e ngjashëm.)
- grupi i fokusit (refugjatët, fëmijët, rinia, gratë, pakicat e ngjashëm.)

Në fund të këtij hapi, mësimdhënësi/mësimdhënësja ua ndan nxënësve Listën e shoqatave të qytetarëve (Shtojca nr. 2).

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 20 minuta )

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i paralajmëron nxënësit se në vazhdim të aktivitetit do të merren me karakteristikat e shoqatave të qytetarëve në atë mënyrë që do përpiqen të përcaktojnë se cilat janë domethëniet e këtyre termave: *organizatat joqeveritare, sektori jo-profit, sektori i tretë, sektori vullnetar.*

Pastaj i fton nxënësit që shkurt të sqarojnë si i kuptojnë ata këto emërtime. Duke mos u ndalur shumë në këtë mësimdhënësi/mësimdhënësja ua shpërndan kopjet e tekstit në të cilat gjenden shpjegime të nevojshme të termave të ndryshme (Shtojca nr. 2) me sqarimin se secili nga këto emërtime cek vetëm një aspekt të këtyre organizatave. Detyra e nxënësve është që ta lexojnë me kujdes tekstin dhe në bazë të tij dhe të gjitha informatave që kanë mësuar nga biseda e mëparshme, të orvatën ta hartojnë listën e karakteristikave të shoqatave të qytetarëve, duke marrë parasysh të gjitha aspektet e përmendura. Pasi nxënësit edhe më tej punojnë në nivel të grupeve që i kanë formuar paraprakisht, është e domosdoshme që të shkruhen ato karakteristika të shoqatave të qytetarëve rreth të cilave merren vesh si grup.

Në këtë mënyrë, nxënësit do ta bëjnë vetë përcaktimin e hollësishtëm të nocionit shoqatat e qytetarëve dhe të cekin karakteristikat e tyre qenësore.

Në fund të aktivitetit, përfaqësuesit e grupeve i prezantojnë konkluzionet kurse nxënësit e tjerë janë ftuar që ekspozetë t'i plotësojnë ose t'i formulojnë më saktësisht.

Është më se e sigurt që nxënësit do të përmendin këto përcaktime të shoqatave të qytetarëve: *Shoqatat e qytetarëve janë organizata të cilat i formojnë qytetarët në dobi të të mirës së përgjithshme, që veprojnë relativisht të pavarura nga shteti, realizojnë sisteminin jo-profit të mjeteve dhe në punën e tyre i inkuadrojnë vullnetarët dhe deponimet vullnetare.*

Me rastin e zhvillimit të këtij aktivitetit, për mësimdhënësin mund të jetë e dobishme shtojca me listën e karakteristikave të shoqatave të qytetarëve (Shtojca nr. 3).



## **Materiali për punë**

### **Shtojca nr. 1**

#### **LLOJET E SHOQATAVE TË QYTETARËVE (ORGANIZATAVE JOQEVERITARE)**

1. Organizatat dhe lëvizjet ekologjike (luftojnë për ambientin e shëndetshëm të jetesës)
2. Organizatat studentore e rinore (i përfaqësojnë interesat e njerëzve të rinj dhe të studentëve)
3. Organizatat humanitare (grumbullojnë dhe shpërndajnë ndihmën humanitare)
4. Organizatat arsimore (i edukojnë njerëzit për tema të ndryshme)
5. Organizatat paqësore (zhvillojnë kulturën e paqes, të mungesës së dhunës e të tolerancës)
6. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe të grupeve marginale – romëve, të refugjatëve e të personave të zhvendosur, grave, fëmijëve, homoseksualëve, etj (mbrojnë të drejtat njerëzore e qytetare)
7. Organizatat ndërkombëtare (Kryqi i Kuq, UNICEF, etj.).

## Shtojca nr. 2

### ORGANIZATAT E QYTETARËVE – LLOJLLOSHMËRIA TERMINOLOGJIKE

Varësisht nga zhvillimi politik kulturor dhe ekonomik, organizatat e qytetarëve quhen ndryshe në vende të ndryshme.

**Spektori jo-profit**, term që më shpesh përqafohet, thekson se këto organizata për dallim nga ato përfituese, nuk ekzistojnë me qëllimin primar për realizimin e profitit. Ato mund të realizojnë profit por ky nuk është qëllimi i tyre parësor. Pas kësaj, profiti i fituar nuk sistemohet midis anëtarëve por përdoret për programe e aktivitete.

**Spektori i tretë** është term i cili si edhe ai i mëparshmi ka lindur në Amerikë, që organizatat e këtij tipi të veçoheshin nga dy sektorët e parë –shtetit dhe tregut. Mirëpo, vetë termi nuk nënkupton pavarësinë e plotë nga shteti dhe tregu. Në kuptimin financiar, këto organizata shpesh janë të varura edhe nga shteti edhe nga ndërmarrësit privat.

**Spektori mirëbërës**, term që shfrytëzohet në Angli, spikat mbështetjen organizatave bamirëse, të dhuruesve (donatorëve) e sponsorëve, ndonëse kontributi i donatorëve nuk është e thënë të jetë i vetmi e shpesh jo burimi kryesor i të ardhurave (hyrave).

**Spektori vullnetar**, term i cili spikat domethënien e aktiviteteve vullnetare të cilat nuk kërkojnë pagesë, punën e vullnetarëve si veti kryesore të këtij sektori. Mirëpo, një numër i madh i aktiviteteve në këtë sektor kërkon punën e ekspertëve dhe të punësuarve të tjerë.

**Organizatat joqeveritare (OJQ)** është term i cili spikat ndarjen e këtyre organizatave nga qeveria dhe ndikimi i shtetit. Më së shumti përdoret në vendet në zhvillim, e kryesisht ka të bëjë me organizatat e angazhuara në ndryshime sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, organizatat joqeveritare nuk marrin pjesë në pushtimin (marrjen) e pushtetit; nuk mund të jenë të angazhuara politikisht për mbështetje kandidatëve në zgjedhje, por mund të jenë të angazhuara në aktivitetet politike.

### **Shtojca nr. 3**

#### **KARAKTERISTIKAT E SHOQATAVE TË QYTETARËVE (ORGANIZATAVE JOQEVERITARE)**

1. I formojnë vetë qytetarët
2. Shoqata vullnetare të qytetarëve
3. Nuk janë qëllim në vetvete – formohen për të krijuar ndryshime në mjedis dhe t'i përmirësojnë kushtet e jetës së qytetarëve
4. Jo-profite – profiti nuk u sistemohet anëtarëve të organizatave por investohet në dobi të realizimit të objektivave të shtruara
5. Joqeveritare – nuk i formon qeveria
6. Nuk marrin pjesë në pushtimin (marrjen e pushtetit) por e kontrollojnë (njëra nga karakteristikat e shoqërisë civile)
7. Vetë i përcaktojnë objektivat dhe i definojnë programet
8. Janë të udhëhequra nga vlerat

## **Punëtorja: SHOQATAT E QYTETARËVE – NJOHJA ME PUNËN E SHOQATAVE LOKALE TË QYTETARËVE**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen me punën e shoqatave lokale të qytetarëve si shembull të praktikës së mirë.

### **DETYRAT:**

- Përfaqësimi i shoqatave lokale të qytetarëve
- Biseda mbi aktivitetet dhe aksionet që këto shoqata të qytetarëve i kanë zbatuar në bashkësinë lokale

### **Materiali për punë:**

#### **Vërejte:**

Është e dëshirueshme që përfaqësuesi i shoqatës lokale të qytetarëve, t'ua shpërndajë nxënësve broshurën mbi punën dhe aksionet e organizatës të cilën e përfaqëson.

---

### **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

#### **Vërejte:**

Për nevojat e kësaj ore nevojitet që mësimdhënësi/mësimdhënësja paraprakisht të kontaktojë shoqatën lokale të qytetarëve dhe të sigurojë një (apo më shumë) përfaqësues të kësaj shoqate. Gjithashtu, është e domosdoshme që në marrëveshje me kryetarin e shoqatës lokale të qytetarëve të përgatiten hapat e nevojshëm për këtë aktivitet.

#### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja ua prezanton nxënësve mysafirin (apo më shumë sosh) nga shoqata lokale e qytetarëve, duke i ftuar ata që ta dëgjojnë prezantimin e tij.

#### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 20 minuta )

Në këtë pjesë të aktivitetit, mysafiri përfaqëson shoqatën lokale të qytetarëve. Sidomos është e rëndësishme që me prezantim të përfshihen këto fusha:

- historiku i shoqatës
- korniza ligjore e punës së shoqatës
- misioni i shoqatës
- aktivitetet konkrete që i ka zbatuar kjo shoqatë

#### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 20 minuta)

Me përfundimin e prezantimit nxënësit fitojnë mundësinë që mysafirit t'i shtrojnë pyetje. Nga mysafiri priten përgjigje konkrete e të shkurta në mënyrë që një numër më i madh i nxënësve të fitojë rastin të shtrojnë pyetje.

Është e mundshme që ky hap të organizohet në disa mënyra:

- Shtruarja spontane e pyetjeve
- Secili nga nxënësit në një copëz letër e shkruan pyetjen për mysafirin
- Të gjithë nxënësit paraprakisht shtrojnë pyetje në mënyrë që mysafiri të mund t'i organizojë përgjigjet e veta në harmoni me mundësitë kohore dhe me interesimet e nxënësve.

**Vërejte:**

Mësimdhënësi/mësimdhënësja mund të organizojë takim me përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve për më shumë klasë në orarin e njëjtë.

## **Punëtorja: PLANIFIKIMI AKSIONIT LOKAL –përzgjedhja e problemit**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit, duke shfrytëzuar përvojat nga viti i mëparshëm dhe dijeninë e fituar në këtë vit, të bëjnë përzgjedhjen e problemit dhe të përgatiten për zgjidhjen e tij

### **DETYRAT:**

- Konfirmimi i “tablosë së gjendjes” të klasës/grupit në raport me planifikimin dhe realizimin e aksionit lokal
- Përzgjedhja e problemit/temës/nejës për shkak të së cilës do të planifikohet dhe realizohet aksioni lokal

### **Materiali për punë:**

- Fletëza të vogla të letrës, nga disa për secilin nxënës (Shtojca nr. 1)

---

## **PËRSHRIMI I AKTIVITETIT**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i rikujton nxënësit se edhe në lëndën “Edukata qytetare 2” gjithashtu kanë planifikuar dhe realizuar aksione lokale. Me këtë rast i fton nxënësit që ta kujtojnë çfarë ka qenë e mirë, çfarë kanë mësuar dhe punuar vitin e shkuar, apo çfarë ka qenë keq, ku kanë qenë lëshimet, çfarë ka mundur të bëhet më mirë. Mësimdhënësi/mësimdhënësja dhe nxënësit duhet bashkë të vijnë deri tek “tabloja e gjendjes” së klasës/grupit të tyre në kontekstin e aktivizimit në ambientin shkollor e lokal.

### **Vërejte:**

Në qoftë se nxënësit, për çfarëdo arsye, vitin e kaluar as që kanë planifikuar as realizuar aksionin lokal, mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet t’i nxitë që të kujtojnë shembujt (nga jeta, filmi, letërsia...) e grupeve të njerëzve të rinj që janë tubuar për të punuar diçka bashkë (Shoqata e Petar Krzhvicës, Shoqata e Pulëbardha e Sinit, Shoqata e poetëve të vdekur...).

Mësimdhënësi/mësimdhënësja këtë aktivitet (duke vlerësuar çfarë është më efektive) ose e drejton frontalisht, me gjithë klasën ose jep instruksionin që në grupe të vogla t’i këmbëjnë kujtimet dhe informatat, që në fund në nivel të gjithë grupit të bëjnë tablonë e përbashkët të raportit të tyre ndaj temës.

Është mirë që të bëhet një shkrim i madh në fund të këtij hapi, në harmoni me atë se në cilin drejtim ka qenë i zbatuar i tërë aktiviteti.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i rikujton nxënësit se edhe gjatë këtij viti shkollor kanë pasur rastin të merren me problemet shoqërore dhe me temat që janë arsye për aksion – kur kanë folur për shoqërinë civile, për iniciativat qytetare, për shoqatat e qytetarëve, me rastin e punimit të anketës...

Është e dëshirueshme që mësimitdhënësi/mësimitdhënësja të përmendë që, sikur se vitin e kaluar i kanë njohur problemet e caktuara si të drejtat e rrezikuara që i kanë sipas Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, problemet shoqërore mbi të cilat flitet këtë vit më shpesh janë të drejtat e rrezikuara të njeriut që i kemi sipas Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut.

Në planifikimin që pason, nxënësit do të mbështeten në të gjithë dijenitë dhe përvojat e veta të deritashme por edhe do të mësojnë teknika dhe metoda të reja të domosdoshme për planifikim më cilësor dhe zhvillimin e aksionit.

Mësimitdhënësi/mësimitdhënësja u shpërndan nxënësve fletëza të ndryshme të letrës (që secili nga nxënësit të marrë nga disa) dhe ju jep instruksionin që në secilën ta shkruajnë nga një problem/temë/ nevojën shoqërore me të cilën mund të merren këtë vit (të cilin mund ta zgjidhin sikur ta planifikonin mirë dhe bashkë do t'i hynin punës). Nxënësit duhet trimëruar t'i shkruajnë se si ato probleme/tema/ nevoja shoqërore që i kanë përmendur deri më tani, ashtu edhe të rejat që për momentin i kanë të afërta, veçanërisht duke pasur parasysh instruksionin se me to do të merren me anë të aksionit të përbashkët, të planifikuar mirë.

Nxënësit i shkruajnë idetë e veta në fletëzat e letrës, ia dorëzojnë mësimitdhënësit/mësimitdhënësës, i cili pastaj secilën e lexon me zë. Është e dëshirueshme që mësimitdhënësi/mësimitdhënësja, në qoftë se problemet/temat/ nevojat shoqërore nuk janë formuluar mirë ose qartë, të përpiqet t'i riformulojë, duke verifikuar vazhdimisht nëse është ajo ideja që nxënësit e kanë pasur ndërmend kur e kanë punuar shkrimin.

Gjatë këtij aktiviteti mësimitdhënësi/mësimitdhënësja i rendit fletëzat e letrës në grumbuj sipas ngjashmërisë. Pastaj, i fton nxënësit që të ndahen në grupe duke zgjedhur grumbullin i cili u konvenon dhe intervenon nëse grupet janë tepër të ndryshme sipas ngjyrës, kështu që numrin e anëtarëve të grupit e barazon sipas ngjyrës.

Secili grup duhet të ketë më së shumti 5 nxënës. Të gjitha grupet marrin detyrë që secili ta formulojë qartë problemin e vet (në bazë të gjithë fletëzave që e përbëjnë grumbullin e tyre) duke vënë në pah domethënien e tij dhe t'i përgatisin prezantimin e vet në mënyrë që ta arsyetojë sa më bindshëm përse do të merret pikërisht me këtë problem/me atë temë.

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta )

Përfaqësuesit e grupeve i ekspozojnë prezantimet e tyre përpara nxënësve të tjerë. Mësimitdhënësi/mësimitdhënësja paralajmëron se duke u nisur nga ora e ardhshme grupet ekzistuese do të punojnë për planifikimin e aksionit lokal me të cilin do të zgjidhen problemet e përzgjedhura.

## Materiali për punë

### Shtojca nr. 1




## **Punëtorja: PLANIFIKIMI I AKSIONIT LOKAL –hapat në planifikim**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është ta spikas domethënien e planifikimit për realizimin me sukses të aksioneve lokale dhe të nisë planifikimi i aksioneve konkrete të klasës.

### **DETYRAT:**

- Thexsimi i domethënies së planifikimit
- -Njohja me hapat në planifikim dhe përcaktimi i radhës së tyre

### **Materiali për punë:**

- Hapat në planifikim (Shtojca nr. 1)
- Hapat në planifikim – shpjegimi i hollësishëm i hapave (Shtojca nr. 2)
- Zarfet me hapat në planifikim dhe me sqarimin e tyre (Shtojca nr. 3)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE**

### **Hapi parë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e nis orën duke i rikujtuar nxënësit se në orën e kaluar e kanë filluar planifikimin e aksioneve konkrete lokale që kanë të bëjnë e problemet nga mjedisi i tyre. Gjithashtu i rikujton se në orën e kaluar i kanë zgjidhur disa probleme me të cilët do të merren deri në fund të vitit shkollor dhe sipas interesimeve të veta janë ndarë në disa grupe në kuadër të të cilave do të punojnë më tutje. Në mënyrë që aksionet të jenë të realizuara më me sukses, është e nevojshme të jenë mirë të planifikuara. Gjatë kësaj ore nxënësit do të kenë rastin të njihen me hapat në planifikimin e aksionit.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 25 minuta )

Nxënësit kthehen në grupet e veta të vogla. Mësimdhënësi/ mësimdhënësja më tutje i jep secilit grup nga një zarf ku gjenden hapat e përzier në planifikim dhe përshkrimi i atyre hapave, duke dhënë këto detyra grupeve që secilin hap ta lidhin me përshkrimin e tij dhe të bëjnë renditjen e mirëfilltë të hapave (Shtojca nr. 1). Grupet kanë 15 minuta për punë. Me përfundimin e punës, përfaqësuesi i grupit e prezanton punën e grupit.

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja bashkë me klasën e analizon punën e grupeve dhe e përcakton renditjen e drejtë të hapave. Gjithashtu bashkë kalojnë nëpër sqarimin e secilit hap.

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e rrumbullakon se çfarë është përpunuar gjatë kësaj ore dhe paralajmëron se në orët e ardhshme nxënësit do të planifikojnë aksionet e tyre sipas hapave nëpër të cilët kanë kaluar sot.

	<b>HAPAT NË PLANIFIKIM</b>
<b>G</b>	<b>Grumbullimi i të dhënave</b>
<b>R</b>	<b>Definimi i problemit</b>
<b>U</b>	<b>Formulimi i objektivave</b>
<b>M</b>	<b>Formulimi i detyrave</b>
<b>B</b>	<b>Planifikimi i mbikëqyrjes dhe i</b>
<b>U</b>	<b>notimit</b>
<b>L</b>	<b>Përcaktimi i grupeve të fokusit</b>
<b>L</b>	<b>Dërtimi i mbështetjes</b>
<b>I</b>	<b>Krijimi i mesazhit</b>
<b>N</b>	<b>Zgjedhja e kanalit të komunikimit</b>
<b>T</b>	<b>Grumbullimi i mjeteve</b>
<b>Ë</b>	<b>Hartimi i planit të aksionit</b>
<b>D</b>	
<b>H</b>	
<b>Ë</b>	
<b>N</b>	
<b>A</b>	
<b>V</b>	
<b>E</b>	

## **Shtojca nr. 2**

### **HAPAT NË PLANIFIKIM**

#### **GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE**

Që të mund të arrijmë përfundimin se me çfarë problemesh ndeshet bashkësia/grupi jonë lokale, duhet të njihemi më mirë me gjendjen ekzistuese, domethënë të grumbullohen të dhëna mbi këtë. Grumbullimi i të dhënave dhe të informatave është aktivitet i cili duhet të zgjasë gjatë gjithë kohës së aksionit tonë. Kur e përcaktojmë problemin ekzistues vazhdojmë të grumbullohen të dhënat të cilat mund të jenë me domethënie për realizimin e aksionit tonë.

#### **DEFINIMI I PROBLEMIT**

Çdo planifikim nis me përkufizimin e saktë të problemit me të cilin ndeshemi në mjedisin tonë. Zgjidhja e këtij problemi duhet të jetë në harmoni me aktivitetet me të cilat merret grupi juaj.

#### **FORMULIMI I OBJEKTIVAVE**

Kur e definojmë problemin, i shtrojmë objektivat. Objektivi paraqet ndryshimin e caktuar që dëshirojmë ta arrijmë me zgjidhjen e problemit ekzistues, dhe atë në ndonjë periudhë afatgjate (3- 5 vjet). Objektivat duhen formuluar të tilla që të jenë të caktuar, të matshëm, të arritshëm, realë/relevantë, të caktuar në kohë.

#### **FORMULIMI I DETYRAVE**

Pas shtruarjes së objektivave, i definojmë detyrat të cilat paraqesin hap drejt realizimit të atij objektivi. Detyrat duhet të shtrohen të tilla që të jenë të caktuara, të matshme, të arritshme, reale/relevante, të caktuara me kohë.

#### **PLANIFIKIMI I MBIKQYRJES DHE I NOTIMIT**

Kur i shtrojmë objektivat dhe detyrat që synojmë t'i realizojmë, duhet edhe t'i caktojmë disa tregues në bazë të të cilave do të dinim nëse ajo që e bëjmë është e suksesshme dhe në ç' masë. I shtrojmë pyetje vetes; çfarë do të bëjmë pasi të përfundojmë ajo që e kemi planifikuar ta bëjmë? Si do të dimë se situata ka ndryshuar? Përcjellja dhe notimi i suksesit të punës tonë është aktivitet që do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës së zhvillimit të aksionit.

#### **NOTIMI I GRUPEVE TË FOKUSIT**

Grupet e fokusit përfaqësojnë marrësit e vendimeve të cilat mund të na ndihmojnë në zgjidhjen e problemit ekzistues, dhe ato grupe/individë në të cilët ne mund të ndikojmë me realizimin e aksionit tonë. Ato mund të jenë grupe njerëzish të cilët mund të ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin e ndryshimit që e dëshirojmë ta arrijmë në mjedisin tonë, e mund të jenë edhe ata të cilët kanë ndikim të marrësit direkt të vendimeve (miqtë ose të afërmit, mediat, përfaqësuesit e bashkësive fetare, ndihmësit, sekretarët, bashkëpunëtorët, etj.). Është me rëndësi të identifikohet mirë se në çfarë mënyre dhe grup mund të ndikojë në realizimin e ndryshimit.

#### **NDËRTIMI I MBËSHTETJES**

Ndërtimi i bazës për mbështetje në zgjidhjen e problemit me të cilin merremi, është me rëndësi të jashtëzakonshme për të pasur sukses. Në këtë kuptim, anëtarët e grupit i cili punon në zgjidhjen e problemit të caktuar duhet të synojnë krijimin e aleancës me bashkëmendimtarët e vet, donatorët, koalicionet, grupet lokale, shoqatat lokale të

qytetarëve, shoqatat profesionale, institucionet lokale dhe me individë të cilët e mbështesin problemin dhe që mund të inkuadrohen në punën për realizimin e objektivit.

### **NDËRTIMI I MESAZHIT**

Mesazhet që i krijojmë duhet të jenë të projektuara në mënyrë të tillë që t'u përgjigjen grupeve të ndryshme të fokusit. Objektivi që dëshirojmë ta arrijmë me mesazhin që e dërgojmë është ta bindim marrësin që ta mbështesë aksionin tonë. Ekzistojnë tri pyetje të rëndësishme në të cilat duhet dhënë përgjigje kur sajohet mesazhi: Kujt i është destinuar mesazhi? Çfarë dëshirojmë të arrijmë me mesazhin tonë? Çfarë dëshirojmë të bëjë marrësi i mesazhit si rezultat i mesazhit tonë (të ndërmarrë aksion/ta ndryshojë sjelljen).

### **PËRZGJEDHJA E KANALIT TË KOMUNIKIMIT**

Përzgjedhja e medias më adekuate për transmetimin e mesazhit varet nga grupi i fokusit të cilit i adresohemi. Kanalet e komunikimit të cilat më shpesh i shfrytëzojnë grupet e qytetarëve janë kompletet për shtyp (fletëpalosjet, pamfletet, afishet, pllakatet...), komunikatat për opinion, konferencat për gazetarë, debatet publike, konferencat, tribunat...

### **GRUMBULLIMI I MJETEVE**

Mjetet ndihmojnë për t'u mbuluar shpenzimet lidhur me realizimin e aktiviteteve të ndryshme të ndërlidhura me zgjidhjen e problemit, si dhe për disa shpenzime teknike (shpenzimet e udhëtimit, punimi dhe shtypja e materialit, organizimi i takimeve dhe seminareve, shpenzimet e telefaksit/ Internetit, etj.). Strategjia e grumbullimit të mjeteve është me rëndësi të krijohet që nga fillimi i planifikimit të aksionit në mënyrë që të identifikohen donatorët potencialë.

### **HARTIMI I PLANIT TË AKSIONIT**

Kur e përpunojmë strategjinë dhe i grumbullojmë mjetet për realizimin e aksionit tonë, duhet ta hartojmë planin e aksionit. Ky plan duhet të përmbajë: listën e aktiviteteve dhe detyrave të domosdoshme, personat e ngarkuar për kryerjen e këtyre aktiviteteve, koha/afatet, mjetet e nevojshme. Plani i aksionit është pjesë shumë e rëndësishme e planifikimit të aksionit, sepse me anë të hartimit të këtij plani mund të shihen anët e mira e të këqija të organizatës tonë më lehtë, që të mund t'i vërejmë dhe korrigjojmë me kohë (të organizojmë më shumë vullnetarë, të sigurohen akoma mjete, të zgjatën afatet, të shtohen aktivitetet që i kemi lëshuar, e kështu me radhë.)

# **Grumbullimi i të dhënave**

Grumbullimi i informatave mbi problemin, analiza e tyre dhe shfrytëzimi.

# Definimi i problemit

Përcaktimi i saktë i problemit në mjedisin tonë të cilin dëshirojmë ta zgjidhim.

# Formulimi i objektivave

Përshkrimi i ndryshimit të përgjithshëm që dëshirojmë ta arrijmë me zgjidhjen e problemit, në mënyrë që ndryshimi të jetë: i matshëm, kohor (i caktuar në kohë), i arritshëm, real dhe i caktuar.

# Formulimi i detyrave

Definimi i hapave që çojnë në realizimin e objektivit tonë e të cilët janë: të matshëm, kohorë, të arritshëm, realë dhe të caktuar.



# **Planifikimi i mbikqyrjes dhe i notimit**

Procesi i grumbullimit të informatave për matjen e përparimit në drejtim të realizimit të detyrave.

Procesi i grumbullimit dhe i analizimit të informatave me qëllim të vlerësimit nëse detyrat dhe objektivat janë realizuar.

# Caktimi i grupeve të fokusit

Identifikimi i marrësit të vendimeve në të cilat përpiqemi të ndikojmë, të cilët do ta mbështesin aksionin tonë.

# Ndërtimi i mesazhit

Formulimi i deklaratave që u janë adoptuar grupeve të ndryshme të fokusit e të cilat e definojnë problemin, i cikin zgjidhjet, e përshkruajnë aksionet që duhet të ndërmerren.

# Ndërtimi i mbështetjes

Ndërtimi i aleancës me grupet tjera, organizatat ose individët që janë të motivuar ta mbështesin aksionin tonë.

# **Përzgjedhja e kanalit të komunikimit**

Zgjedhja e mënyrës me të cilën mesazhi u transmetohet grupeve të ndryshme të fokusit, p.sh., radioja, TV, afishet, pllakatet, konferencat për shtyp, takimet.

# Grumbullimi i mjeteve

Identifikimi dhe sigurimi i  
Mjeteve (të hollat, pajisja,  
volonterët e nevojshëm,  
hapësira) që na nevojiten për  
aktivitetet e caktuara.

# Hartimi i planit të aksionit

Hartimi i planit të aksionit-shfletimi i aktiviteteve, caktimi i personave që janë të ngarkuar për aktivitetin e caktuar, caktimi i afateve kohore, shfletimi i mjeteve të domosdoshme.

## **Punëtorja: PLANIFIKIMI I AKSIONIT LOKAL – grumbullimi i të dhënave, formulimi i problemit, i objektivave dhe detyrave**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen së afërmi me rëndësinë e grumbullimit në vazhdimësi të të dhënave dhe të formulimit të saktë të problemeve, objektivave dhe detyrave.

### **DETYRAT:**

- Definimi i saktë i secili problem
- Formulimi i objektivave në raport me problemet e përzgjedhura
- Formulimi i detyrave në raport me objektivat e shtruara

### **Materiali për punë:**

- Formulimi i objektivit të aksionit (Shtojca nr. 1)
- Shembujt e formulimeve të drejta e jo të drejta të objektivave (Shtojca nr. 2)
- Formulimi i detyrave të aksionit (Shtojca nr. 3)
- Shembujt e formulimit të drejtë e jo të drejtë të detyrave (Shtojca nr. 4)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e nis orën duke ua rikujtuar nxënësve se në orën e kaluar i kanë shfletuar të gjithë hapat në planifikimin e aksionit lokal. Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se gjithmonë kur e përcaktojmë problemin ekzistues, i grumbullojmë të dhënat të cilat mund të jenë me rëndësi për realizimin e aksionit tonë. Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson në veçanti se grumbullimi i të dhënave është aktivitetet që duhet të zgjasë gjatë gjithë kohës së aksionit tonë. Rëndësia e grumbullimit të pareshtur të të dhënave pasqyrohet në faktin se përherë duhet të kemi informata të reja, sepse ato mund të jenë shumë domethënëse për realizimin e planit tonë. Në atë mënyrë mund t'i evitojmë disa situata të paparashikuara të cilat mund ta rrezikojnë aksionin dhe me këtë ta avancojnë vetë punën tonë.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 20 minuta )

Mësimdhënësi/mësimdhënësja u thotë nxënësve se gjatë kësaj ore secili grup do ta vazhdojë veçmas planifikimin e vet sipas radhës së përcaktuar. Mësimdhënësi/mësimdhënësja u jep sqarim gjatë dy hapave të ardhshëm të cilët pastaj do t'i realizojnë në kuadër të grupeve të veta.

I pari nga ato hapat është **definimi i qartë dhe i saktë i problemit**. Shpesh problemi me të cilin merremi është i madh dhe nevojitet një numër i madh i aksioneve që ai të zgjidhet tërësisht. Pikërisht për këtë shkak është shumë qenësore të vlerësohet mirë se cila është ajo pjesë e problemit me të cilin, ne si grup, mund të merremi, cili është ndryshimi i parë që mund ta nxisim. Nga nxënësit kërkohet që të fokusohen në atë pjesë të problemit të cilin ata mendojnë se mund ta zgjidhin me aksionin e vet.



Hapi dytë nënkupton përcaktimin e **objektivit** të aksionit (Shtojca nr. 1). Objektivi paraqet ndryshimin e caktuar që dëshirojmë ta arrijmë me zgjidhjen e problemit ekzistues.

Objektivat duhet t'i formulojmë me MKARC (MKARC është shkurtesa me të cilën udhëhiqemi me rastin e shtruarjes së objektivave) që të jenë të:

- M- matshëm
- K- me afate kohore
- A- arritshme
- R- reale
- C- përcaktuara (specifike)

Me rastin e definimit të objektivave udhëhiqemi nga pyetje ÇFARË?- çfarë dëshirojmë të arrijmë, të ndryshojmë, cila është përgjigja e njëmendët ndaj atij problemi, etj. Që të jemi të sigurt se saktësisht e kemi definuar objektivin, duhet pasur parasysh se lypset që objektivi i definuar mirë të nënkuptojë që të caktojë këto elemente: ndryshimin që dëshirojmë ta arrijmë, grupin e fokusit dhe territorin. Mësimdhënësi/mësimdhënësja pastaj jep shembullin e përcaktimit të drejtë dhe jo të drejtë të objektivit (Shtojca nr. 2).

Nxënësit kthehen në grupet e veta dhe gjatë 10 minutave të ardhshëm punojnë në përcaktimin e problemit dhe të objektivave. Pason hapi i prezantimit.

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Pas shtruarjes së objektivave, mësimdhënësi/mësimdhënësja e sqaron hapin tjetër: shtrimin e detyrave. Detyrat përgjigjen në pyetjen SI, respektivisht në çfarë mënyre do t'i realizojmë objektivat, cilat aktivitete do t'i realizojmë. Secila detyrë paraqet hap drejt realizimit të objektivit dhe nga detyra pasojnë aksionet konkrete. Si edhe objektivat, edhe detyrat duhet të jenë MKARC të shtruara, që do të thotë se duhet treguar kujdes mbi këtë (Shtojca nr. 3):

**Detyrat** duhet të jenë të:

- M- matshme
- K- kohore
- A- arritshme
- R- reale
- C- caktuara (specifike)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja pastaj jep shembullin e definimit të drejtë dhe jo të drejtë të detyrës (Shtojca nr. 4)

Nxënësit kthehen në grupet e veta të vogla dhe i definojnë nga dy detyra. Pasojnë prezantimet e shkurta të punës grupore.

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e rumbullakon muhabetin mbi objektivat dhe detyrat, duke theksuar se nga mënyra se si i përcaktojmë objektivat, varet edhe suksesi i hapave tjerë por edhe suksesi i vetë aksionit.

Shtojca nr. 1

## **OBJEKTIVAT**

**duhet të jenë të:**

**M** matshme

**K** kohore

**A** arritshme

**R** reale

**C** caktuara

# **OBJEKTIVAT**

në këtë përcaktim duhen përfshirë këto elemente:

⇒ ***TË GJITHA NDRYSHIMET QË  
DËSHIROHET TË REALIZOHEN***

⇒ ***GRUPIN E FOKUSIT***

⇒ ***TERRITORIN NË TË CILIN PUNOHET***

## Shtojca nr. 2

### Definimi i objektivave

#### OBJEKTIVI I FORMULUAR MIRË:

Ngritja e vetëdijes të të rinjve mbi problemet ekologjike në qytetin tonë gjatë vitit të ardhshëm shkollor.

#### **Vërejte:**

Rekomandohet që mësimitdhënësi/mësimitdhënësja në vend të “qytetit tonë” ta vërë emrin e qytetit në të cilin jetohet.

Ky objektivi është i mirë sepse është:

**M matshëm** - mund të vendoset si do ta verifikojmë më vonë nëse vetëdija e të rinjve mbi problemet ekologjike do të shtohet apo jo.

**K kohor** - shtrohet korniza reale kohore

**A arritshëm** - objektivi nuk duket i parralizueshëm, i paramenduar tepër ambicioz

**R real** - nxënësit mund ta realizojnë, nuk i tejkalon fuqitë e tyre

**C caktuar** - saktësohet grupi i fokusit dhe territori, cilat ndryshime dëshirohet të arrihen

#### OBJEKTIVAT E FORMULUARA KEQ:

Qyteti i pastër.

Zhvillimi i vetëdijes së njerëzve.

Shtimi i demokratizimit tek qytetarët.

Më pak kriminalitet në qytet.

Rritja e standardit të jetesës tek qytetarët.

Shtojca nr. 3

## **DETYRAT**

**duhet të shtrohen që të jenë të:**

**M** matshme

**K** kohore

**A** arritshme

**R** reale

**C** caktuara

## Shtojca nr. 4

### Përcaktimi i detyrave

#### DETYRA E FORMULUAR MIRË

Organizimi i aksionit përrues ekologjik të pastrimit të oborrit të shkollës “*Petar Drapshin*”, më 4 maj 2004, në periudhën prej ora 12-17.

#### **Vërejte:**

I rekomandohet mësimitdhënësit/mësimitdhënëses që ta përmendin në vend të shkollës “*Petar Drapshin*” emrin e shkollës të cilën e vijnë nxënësit.

Detyra është e mirë sepse është:

**M matshëm** - mund të vërtetohet sa ka zgjatur vërtetë aksioni dhe sa njerëz kanë qenë të përfshirë në të.

**K kohor** - Kohëzgjatja e aksionit është përcaktuar saktë.

**A arritshëm** - aksioni nuk është paramenduar si tepër ambicioz.

**R real** - nxënësit mund ta organizojnë këtë aksion.

**C caktuar** - është saktësuar ku zhvillohet aksioni dhe nga çfarë përbëhet.

#### DETYRA E FORMULUAR KEQ:

Pastrimi i qytetit

Organizimi i aksioneve të përhershme të pastrimit të oborreve të shkollave.

Organizimi i tribunave me temën e demokracisë në Zajeçar.

## **Punëtorja: PLANIFIKIMI I AKSIONIT LOKAL - Plani i mbikëqyrjes dhe i notimit të suksesit**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen së afërmi me domosdoshmërinë e verifikimit në vazhdimësi se sa po zhvillohet me sukses aksioni dhe cilat janë rezultatet e tij.

### **DETYRAT:**

- Njohja e nxënësve me domethënien e mbikëqyrjes dhe notimit të suksesit
- Njohja me mënyrën e notimit të suksesit (evaluimit) të aksionit lokal.

### **Materiali për punë:**

- Hapat në planifikim (Shtojca nr. 1)
- Shembulli i planit të mbikëqyrjes dhe i notimit të suksesit – për mësimdhënës (Shtojca nr. 2)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT**

### **Hapi parë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e nis orën ashtu që bashkë me nxënësit kalon nëpër të gjithë hapat në planifikim, duke kërkuar nga nxënësit që ta përsërisin renditjen e hapave dhe të japin përshkrimin e shkurtër të secilit hap.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 20 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se para fillimit të realizimit të aksionit lokal, është me rëndësi të caktohen treguesit me ndihmën e të cilëve do të dimë nëse punojmë me sukses dhe në ç' masë, dhe a ia kemi dalë t'i realizojmë objektivat që i kemi shtruar vetvetes në fillim.

**Mbikëqyrja (përcjellja e realizimit)** na e jep pasqyrën reale si dhe mundësinë për ndryshimin e aktiviteteve nëse tregohet se ato nuk po zbatohen sipas planit. Notimi i suksesit të aksionit të zbatuar për ne paraqet burimin e informatave se në ç' masë kemi arritur objektivat e shtruar. Në bazë të atyre të dhënave mund të avancohet puna jonë në të ardhmen. Prandaj paraprakisht i shtrojmë pyetje vetvetes: çfarë do të jetë ndryshe pasi të përfundojë ajo që e kemi planifikuar ta bëjmë? Si do ta dimë se situata ka ndryshuar?

Gjyqi ynë se a po zhvillohet me sukses aksioni, nuk duhet të mbështetet vetëm në përshtypjen tonë e cila mund të jetë edhe e gabueshme, por duhet të mbështetet në të dhënat objektive që do t'i grumbullojmë. Prandaj më herët edhe është thënë se grumbullimi i të dhënave të ndryshme zhvillohet pareshtur gjatë aksionit.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se edhe para fillimit të vetë aksionit duhet planifikuar si do të përcillet sukcesi i realizimit dhe si do të do të notohet në fund të aksionit realizimi i objektivave, e më vonë duhet vepruar sipas planit të konfirmuar. Thekson se përpos grumbullimit të të dhënave edhe përcjellja e realizimit lypset të zgjasë pareshtur.

Që nxënësit të kuptojnë më mirë se çfarë nënkuptohet me mbikëqyrjen, notimin dhe treguesit, mësimdhënësi/mësimdhënësja e ilustron ekspozenë e vet me shembullin e dhënë në Shtojcën nr. 2. Planifikimin e mbikëqyrjes dhe të notimit, mësimdhënësi/mësimdhënësja e tregon në mënyrë interaktive duke kërkuar mendimet dhe propozimet e nxënësve.

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 20 minuta)

Në këtë pjesë, mësuesi/mësuesja u jep detyra nxënësve që ta shkruajnë se si do t'i grumbullojnë të dhënat dhe do ta notojnë suksesin e aksionit të tyre. Pas punës grupore, nxënësit prezantojnë idetë (në qoftë se s'ka kohë, në vend të prezantimit mund të bëhet galeria).



	<b>HAPAT NË PLANIFIKIM</b>
<b>G</b>	<b>Grumbullimi i të dhënave</b>
<b>R</b>	<b>Definimi i problemit</b>
<b>U</b>	<b>Formulimi i objektivave</b>
<b>M</b>	<b>Formulimi i detyrave</b>
<b>B</b>	<b>Planifikimi i mbikëqyrjes dhe i</b>
<b>U</b>	<b>notimit</b>
<b>L</b>	<b>Përcaktimi i grupeve të fokusit</b>
<b>L</b>	<b>Dërtimi i mbështetjes</b>
<b>I</b>	<b>Krijimi i mesazhit</b>
<b>N</b>	<b>Zgjedhja e kanalit të komunikimit</b>
<b>T</b>	<b>Grumbullimi i mjeteve</b>
<b>Ë</b>	<b>Hartimi i planit të aksionit</b>
<b>D</b>	
<b>H</b>	
<b>Ë</b>	
<b>N</b>	
<b>A</b>	
<b>V</b>	
<b>E</b>	

## Shtojca nr. 2

### Shembulli i planit të mbikëqyrjes dhe notimit të suksesit

#### OBJEKTIVI:

Të shtohet numri i seksioneve dhe të shtohet numri i nxënësve të përfshirë në seksione në gjimnaz, në vitin e ardhshëm shkollor.

**Vërejte:** Objektivi i aksionit mund të jetë edhe tjetër lloj. Për shembull, objektivi mund të jetë vetëm shtimi i numrit të seksioneve ose vetëm shtimi i numrit të nxënësve të përfshirë në seksione apo vetëm formimi i seksionit të përcaktuar sikurse është seksioni i dramës, etj.

#### NOTIMI I SUKESIT (REALIZUESHMËRIA E OBJEKTIVIT)

Si do ta dimë në fund të aksionit tonë sa ka qenë i suksesshëm aksioni? Treguesit e mundshëm janë:

- Para fillimit të aksionit do të konstatojmë sa seksione ka për momentin në shkollë. Në fund të vitit të ardhshëm shkollor, kur aksioni ynë do të përfundojë, sërish do të konstatojmë sa ka në atë moment seksione në shkollë. Treguesi i suksesit do të ishte shtimi i numrit të seksioneve me përfundimin e aksionit, në raport me fillimin e aksionit.
- Para fillimit të aksionit do të konstatojmë sa nxënës në shkollë janë përfshirë në seksione të ndryshme. Në fund të vitit të ardhshëm shkollor kur aksioni ynë do të përfundojë, sërish do të konstatojmë sa nxënës janë përfshirë në atë moment në seksione të ndryshme. Treguesi i suksesit do të ishte shtimi i numrit të nxënësve të cilët i vijnë seksionet shkollore me përfundimin e aksionit, në raport me fillimin e aksionit.
- Para fillimit të aksionit do të pyesim se sa herë është takuar secili nga seksionet ekzistuese për momentin dhe sa orë pune përafërsisht ka pasur, dhe do të llogarisim numrin e orëve të punës të seksioneve shkollore në vitin vijues shkollor. Në fund të aksionit tonë, ose më mirë edhe gjatë zgjatjes së aksionit, do të shënojmë numrin e orëve të punës së seksioneve në vitin e ardhshëm shkollor. Treguesi i suksesit është shtimi i numrit të përgjithshëm të orëve të punës së seksioneve.

**Vërejte:** Disa informata të domosdoshme për vlerësimin e suksesit të Aksionit duhet t'i grumbullojmë edhe **para** fillimit të aksionit.

#### DETYRAT:

- me ndihmën e anketës gjatë shtatorit të hulumtohen interesimet dhe nevojat e të gjithë nxënësve në shkollë
- t'i dërgohet në fillim të shtatorit këshillit të arsimtarëve lista e seksioneve për të cilat është treguar interesimi i të paktën 10 nxënësve
- marrëveshje në fillim të tetorit me drejtorin e shkollës për sigurimin e hapësirës dhe të kohës
- organizimi i miqësisë të seksionit të dramës nga shkolla fqinje gjatë gjysmë-vjetorit të parë

#### PËRCJELLJA E REALIZIMIT (MBIKËQYRJA E KRYERJES SË DETYRAVE)

Gjatë aktiviteteve grumbullojmë në vazhdimësi informata të cilat na tregojnë nëse aksioni ynë po rrjedh sipas planit dhe në cilat probleme eventualisht po has, për shembull:

- A është zbatuar në mënyrë korrekte anketimi? Sa nxënës janë anketuar? A jemi të aftë t'i përpunojmë vetë të dhënat, apo na nevojitet ndihma?
- A ia kemi dalë ta realizojmë komunikimin me drejtorin dhe këshillin e arsimtarëve? A është hartuar plani i seksioneve i cili u përgjigjet interesimeve dhe kohës në dispozicion të nxënësve?
- A ia kemi dalë të organizojmë miqësinë, etj.

## **Punëtorja: PLANIFIKIMI I AKSIONIT LOKAL – caktimi i grupeve të fokusit, analiza e ambientit dhe ndërtimi i mbështetjes**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen me rëndësinë e sigurimit të mbështetjes nga ana e individëve, grupeve dhe organizatave që janë të interesuara për zgjidhjen e problemeve dhe të cilët mund të kontribuojnë në suksesin e aksionit lokal.

### **DETYRAT:**

- Caktimi i grupeve fokus
- Analiza e ambientit me qëllim të identifikimit të gjithë atyre organizatave, institucioneve dhe individëve të cilët mund të kontribuojnë në suksesin e aksionit lokal
- Planifikimi i ndërtimit të mbështetjes

### **Materiali për punë:**

- Analiza e ambientit (Shtojca nr. 1)
- letër-paketimi (për secilin grup nga një)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE**

### **Hapi parë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e fillon orën duke rikujtuar nxënësit se deri ku kanë arritur në planifikimin e aksionit. Hapi i ardhshëm në të cilin do të punojë është caktimi i grupeve të fokusit. Për suksesin e aksionit është shumë qenësore të konstatohet se cilat grupe të fokusit ekzistojnë, respektivisht të konstatohen të gjitha ato organizata, institucione dhe individët që gjenden në mjedisin përreth dhe që janë domethënës për realizimin e aksionit. Për këtë qëllim nevojitet të analizohet mirë ambienti.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja më tutje tregon me anë të një shembulli si analizohet më mirë mjedisi. Mësimdhënësi/mësimdhënësja e vizaton rrethin në qendrën e të cilit e vë grupin e nxënësve, pastaj i shënjon shfrytëzuesit e aksionit (grupin primar të fokusit) e këta janë grupet/ individët në të cilët dëshirojnë të ndikojnë nxënësit me aksionin e vet.

Pastaj i vizaton grupet e tjera të fokusit. Këto janë të gjitha ato grupe të cilët përfaqësojnë vendimmarrësit që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e problemit ekzistues dhe/ose ata që kanë ndikim në vendimmarrësit imediat.

Këto grupe i quajmë edhe grupe të interesuara, sepse të gjitha ato në njëfarë mënyre janë të interesuara për zgjidhjen e problemit me të cilin ka të bëjë aksioni. Gjithmonë ekziston interesi i ndërsjellë midis grupeve të nxënësve dhe grupeve të interesuara nga ambienti (rrethina) dhe është me domethënie të konstatohet interesi i përbashkët për secilin grup.

Në këtë mënyrë nxënësit krijojnë një tablo të qartë se cilat grupe janë të interesuara për zgjidhjen e problemit dhe përse. Në bazë të këtyre njohurive, nxënësit më tutje planifikojnë ndërtimin e mbështetjes, respektivisht nxënësit planifikojnë se në çfarë mënyre secilit nga këto grupe mund të krijohet aleanca dhe si secili nga këto grupe të përfshihet në zgjidhjen e problemit/aksionit. Ndërtimi i bazës për mbështetje në zgjidhjen e problemit me të cilin merret grupi i caktuar, është i një rëndësie të jashtëzakonshme për suksesin e aksionit. Sa më e gjerë të jetë mbështetja, aq më të mëdha janë shanset për sukses. Gjatë ndërtimit të mbështetjes nxënësit shfrytëzojnë të gjitha ato njohuri që i kanë fituar gjatë orëve të kaluara, para se gjithash me lobim dhe fushatë.

**Vërejte:**

Me rastin e sqarimit të analizës së ambientit, mësimdhënësi/ mësimdhënësja zgjedh shembullin që është i njohur për nxënësit. Është e mundshme t'u referohet aksioneve të mëparshme që janë realizuar gjatë klasë së II. Është qenësore që në atë shembull të veçohen sa më shumë grupe të ndryshme/ të interesuara. Si ndihmesë shfrytëzohet Shtojca nr. 1.

**Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në hapin e radhës nxënësit kthehen në grupet e veta të vogla dhe vazhdojnë punën në planifikimin e aksionit. Detyra e tyre është ta analizojnë ambientin (rrethinën) në raport me problemet e tyre, dhe në atë mënyrë t'i konfirmojnë të gjitha grupet/ e interesuara të fokusit në mjedisin (rrethin) e tyre. Gjithashtu është e nevojshme që të definohen qartë interesat e secilit nga këto grupe për zgjidhjen e problemit. Rezultatin e punës në grupe nxënësit duhet ta tregojnë në një letër të madhe.

**Hapi tretë**


(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në hapin e radhës puna e secilit grup tregohet si në galeri, kurse nxënësit thirren që disa minuta të kalojnë nëpër galeri dhe t'i shikojnë rezultatet e punës së grupeve të vogla. Pastaj, mësimdhënësi/mësimdhënësja bashkë me klasën e komenton punën e secilit grup.

## Shtojca nr. 1

### ANALIZA E MJEDISIT

Që të mund të veprojmë më me sukses në mjedisit tonë, nevojitet të konstatojmë se çfarë gjendet në të, në çfarë mënyrë mund të bashkëpunojmë me secilin nga grupet/institucionet që janë të rëndësishme për realizimin e aksionit dhe zgjidhjen e problemit. Ajo çfarë duhet ta mendojmë mirë dhe ta definojmë saktë është: cili është ai interes i ndërsjellë që na lidh me grupet nga mjedisi e lidhur me punën tonë. Prandaj këto grupe edhe i quajmë **grupe të interesuara**.



## **Punëtorja: PLANIFIKIMI I AKSIONIT LOKAL- sajimi i mesazhit dhe përzgjedhja e kanalit të komunikimit**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen më afër me nocionin dhe domethënien e komunikimit me opinionin si dhe me karakteristikat e mesazhit të mirë.

### **DETYRAT:**

- Përzgjedhja e grupit të fokusit dhe të kanalit të tij përkatës të Komunikimit
- Sajimi i mesazhit i cili i dërgohet grupit përzgjedhës të fokusit që të zgjohet interesimi i tij për zgjidhjen e problemit

### **Materiali për punë:**

- Karakteristikat e mesazhit të mirë (Shtojca nr. 1)
- Pankartat, lifletat - shembuj të grupeve të definuara mirë (Shtojca nr. 2)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE**

### **Hapi i parë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja u thotë nxënësve se në këtë orë do të merren me sajimin (projektimin) mesazheve dhe me përzgjedhjen e kanalit të komunikimit. Pastaj i thërret nxënësit të rikujtohen se cilat janë krejt ato grupe të interesuara i kanë veçuar në ambientin (rrethinën) e vet në orën e kaluar, dhe u thotë se me secilin nga ato duhet komunikuar vazhdimisht mënyrë adekuate që t'i inkuadrojë në aksionin e tyre.

Gjithashtu është shumë me rëndësi të tregohet kujdes se në çfarë mënyre komunikojmë me secilën nga këto grupe, respektivisht si krijohet mesazhi dhe si zgjidhet mënyra e adresimit grupeve të interesave, domethënë publikut.

Gjatë krijimit të mesazhit është shumë me rëndësi që mesazhi t'i përshtatet grupit që i adresohet, shprehive të tij, qëndrimeve si dhe gjuhës që e kupton grupi. Duhet pasur parasysh se mesazhi duhet të jetë i shkurtër dhe i qartë, si dhe ta tërheqë vëmendjen, të ngjallë interesim dhe të motivojë për aksion. Mësimdhënësi/mësimdhënësja ua ndanë nxënësve Shtojcën nr. 1 dhe shkurtimisht ua ritregon.

Gjithashtu, mesazhi duhet t'i përshtatet edhe mënyrës së adresimit, pra kanalit të komunikimit (p.sh. nëse duam t'ua sqarojmë bashkëqytetarëve si do të duket aksioni i caktuar, është më mirë që për këtë qëllim të organizohen takime ose tribuna se sa kjo të sqarohet me pankartë). Këtu është me rëndësi që mësimdhënësi/mësimdhënësja të sqarojë se kanalet e komunikimit nuk janë gjë tjetër veçse mjet ose mënyrë me të cilën i drejtohem opinionit (takimet, letrat, afishet, pankartat, kumtesat për opinion, TV, radio emisionet, takimet me komunarët, prindërit ose me shoqatat lokale të qytetarëve, etj.).

### **Vërejte:**

Do të ishte e dobishme t'u tregohen nxënësve shembujt e definimit të mirë të mesazheve në pankarta/lifteve të cilat mësimdhënësi/mësimdhënësja i përgatit vetë ose i referohet Shtojcës nr. 2.

## **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 20 minuta)

Në këtë hap nxënësit kthehen në grupet e veta të vogla me detyrë që ta zgjedhin një grup të interesuar nga mjedisi i tyre, të rikujtohen çfarë kanë cekur se është interesi i tyre për zgjidhjen e problemit, të cilin e ka zgjedhur grupi dhe në bazë të kësaj të saktësojnë se cili duhet të jetë kontributi i atij grupi për planifikimin e aksionit.

Pastaj, nxënësit duhet ta caktojnë mënyrën, domethënë mjetin e komunikimit me të cilin i drejtohen atij grupi të fokusit (pankarta, afishet, spoti, e tj.) dhe ta definojnë mesazhin më të mirë me të cilin i drejtohen atij.

Pasi nuk ka shumë kohë për punë, nga nxënësit pritët që ushtrimin ta përfundojnë me mesazhin e formuluar pjesërisht dhe me skicë apo përshkrimin e mjeteve të komunikimit. Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se në mënyrë të pavarur, në kuadër të secilit grup, do të vazhdojnë të punojnë për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre skicave si dhe në zhvillimin e mesazheve të reja dhe zgjedhjen e mënyrës së komunikimit edhe për grupet tjera të interesuara.

### **Vërejte:**

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i rikujton vazhdimisht nxënësit se është e nevojshme që mesazhi t'i përshtatet grupit të fokusit dhe mjetit që e kanë zgjedhur. Gjithashtu i rikujton se mesazhi lypset të jetë i shkurtër edhe i qartë, si dhe të tërheqë vëmendjen, të zgjojë interesim dhe të motivojë për aksion.

## **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në këtë hap pason prezantimi i rezultateve të punës së grupeve. Mësimdhënësi/mësimdhënësja bashkë me klasën me anë të diskutimit grupor, sugjeron ndryshime të mundshme. Në diskutim, mësimdhënësi/ mësimdhënësja udhëhiqet nga kjo: sa mesazhe i konvenojnë grupit të fokusit (a i kupton ajo), a është mesazhi i shkurtër dhe i qartë, motivues dhe interesant për grupin e fokusit, si është zgjedhur mjeti i komunikimit dhe sa i konvenon mesazhi mjetit. Këtu duhet pasur kujdes që nxënësit të mos i drejtojnë kritika njëri tjetrit që kanë të bëjnë me estetikën, respektivisht me vetë zgjidhjen kreative të pankartës/fletëpalosjes, veç në kriteret e cekura më sipër.

## Shtojca nr. 1

### KARAKTERISTIKAT DHE FORMULIMI I MESAZHIT TË MIRË

Thënë më thjeshtë, **mesazhi** është informata të cilën dërguesi dëshiron t'ia kumtojë marrësit. Ai mund të jetë i shkruar ose i folur, në formë të kumtesës, shenjës, simbolit ose sloganit.

Karakteristikat themelore të mesazhit të mirë janë që ai të jetë i **shkurtër dhe i qartë**, duhen shmangur fjalët e huaja, zhargoni, simbolet që mund të interpretohen dykuptimshëm. Mesazhi duhet t'i **përshtatet marrësit** domethënë, grupit të fokusit të cilit i drejtohem (t'i përgjigjet moshës së tyre, arsimimit, shprehive, qëndrimeve, nevojave), por edhe **kanalit të komunikimit** (nga lloji i kanalit varet sa informata do të mund të dërgohen, p.sh., nuk mundemi në etiketë ta vendosim përmbajtjen e tribunës që e organizojmë), dhe **mjeteve** që disponojmë.

Mesazhi i formuluar mirë duhet ta **tërheqë vëmendjen, të zgjojë interesimin dhe të motivojë për aksion.**

Ekziston rregulli i marketingut i cila thotë se mesazhi që dërgohet me anë të pankartave, bilbordeve, tabelave të ndryshme të shpalljeve dhe pllakateve që janë vënë në vendet publike, duhet ta tërheqin vëmendjen, të zgjojnë interesim dhe të motivojnë për aksion në afatin prej katër deri gjashtë sekonda (sa nevojitet që derisa kalojmë pranë atij materiali të ndalemi, lexojmë dhe e "kuptojmë krejtësisht")

Kjo kohë tek afishet zgjatet sepse marrësi ynë i mesazhit mund ta marrë afishen dhe ta lexojë më vonë, kështu që në afishe mund të vëmë edhe më shumë tekst dhe sqarime shtesë. Megjithatë, një afishe mesatarisht mund të arrijë tek një deri tre veta, kurse pankartën e shikojnë disa herë më shumë njerëz. Tek shfrytëzimi i mediave të tjera, në shembullin televizionit e të radios mesazhin tonë e shohin/dëgjojnë më shumë njerëz ama çmimi është më i lartë kurse kontrolli nëse i drejtohem grupit të dëshiruar është më i vogël.

Të gjithë këta janë faktorë ndaj të cilëve duhet treguar kujdes me rastin e dërgimit të mesazhit tonë.



## **Punëtorja: PLANIFIKIMI I AKSIONTI LOKAL – grumbullimi i mjeteve dhe plani i aktiviteteve**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit të njihen së afërmi me domethënien dhe mënyrat e grumbullimit të planifikuar të mjeteve dhe të planifikimit të hollësishëm të aktiviteteve.

### **DETYRAT:**

- Kuptimi i procesit të grumbullimit të mjeteve
- Puna në planin kohor të aksionit

### **Materiali për punë:**

- Tabelat për planin kohor të aksionit (Shtojca nr. 1)

---

## **PËRSHRIMI I AKTIVITETEVE**

### **Hapi parë:**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e nis orën duke thënë do të punojë planin e grumbullimit të mjeteve dhe planin e zbatimit të aksionit.

Procesi i grumbullimit të mjeteve ka të bëjë me planifikimin e mënyrës së grumbullimit të mjeteve të domosdoshme për realizimin e aksionit. Mjetet nevojiten për të realizuar aktivitete të ndryshme lidhur me zgjidhjen e problemeve, si dhe për mbulimin e shpenzimeve teknike (p.sh. shpenzimet e udhëtimit, hartimi dhe shtypja e materialit, organizimi i takimeve dhe seminareve, të faturave telefonike, shpenzimet e internetit, etj.). Me grumbullimin e mjeteve këtu nuk nënkuptohet vetëm sigurimi i parave, por edhe gjetja e lokalit për aktivitete të caktuara, cedimi (lëshimi) i mjeteve të caktuara teknike në shfrytëzim gjatë përgatitjes së aksionit (p.sh., nëse grupi nuk ka kompjuter mund at huazojë kompjuterin e dikujt gjatë përgatitjes së aksionit), kontributet në prodhime, materiale etj.

Që nxënësit të mundën të parashikojnë në mënyrë të drejtë të gjitha shpenzimet e mundshme dhe në mënyrën më të mirë të planifikojnë grumbullimin e mjeteve, e shfrytëzojnë tabelën për planin kohor të aksionit. Mësimdhënësi/mësimdhënësja e prezanton tabelën të cilën ua shpërndan nxënësve (Shtojca nr. 1) dhe e sqaron secilën kolonë:

1. aktivitetet që do të kryhen përfshirë edhe përgatitjen dhe aktivitetet pas përfundimit të aksionit
2. mjetet e nevojshme
3. personat e përgjegjshëm për kryerjen e disa aktiviteteve
4. caktimi kohor i secilit aktivitet të planifikuar

E gjithë kjo organizohet për të ekzistuar bashkërendimi në zbatimin e secilit aktivitet të planifikuar, si dhe për shkak të efikasitetit të shfrytëzimit të resurseve – njerëzve, kohës dhe mjeteve. Që nxënësit ta kenë më të qartë, mësimdhënësi/mësimdhënësja duke shfrytëzuar shembujt konkretë kalon nëpër tabelë (dërrasë të zezë).

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Në këtë hap, nxënësit kthehen në grupet e veta të vogla ku orvatën që në bazë të tabelës të planifikojnë shpenzimet për kryerjen e secilit nga aktivitetet, të definojnë interesimin e grupeve të cilat mund t'i mbulojnë ato aktivitete, ta caktojnë kornizën kohore dhe personin përgjegjës nga grupi. Në bazë të diskutimit në grupe të vogla, nxënësit e plotësojnë tabelën për planin kohor të aksionit (Shtojca nr. 1).

### **Hapi tretë**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Në këtë pjesë pason prezantimi i shkurtër i tabelës së secilit grup dhe informata kthyese e mësimdhënësit/mësimdhënëses.

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e përmbyll duke theksuar se me këtë orë e mbaron planifikimin e aksionit dhe hapi i serishëm nëpër të cilin kanë kaluar nxënësit me rastin e planifikimit të aksionit. Mësimdhënësi/ mësimdhënësja u thotë atyre se ajo që pason është prezantimi publik i projektit të grupeve të vogla. Në prezantimin publik, i cili do të mbahet në shkollë, nxënësi duhet që projektin e vet/planin aksionit t'ua prezantojnë të gjitha atyre grupeve të cilat mund të kontribuojnë që të realizohet aksioni.



## **Punëtorja: PLANIFIKIMI I AKSIONIT LOKAL – përgatitja për prezantimin publik**

### **OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është organizimi i prezantimit publik në shkollë.

### **DETYRAT:**

- Përzgjedhja e grupeve të fokusit, të cilat do të thirren në prezantim publik
- Organizimi i prezantimit publik të projektit
- Përgatitja e planit të aktiviteteve lidhur me organizimin e prezantimit publik

### **Materiali për punë:**

- Analiza e ambientit (**mjedisit**) (Shtojca nr. 1)
- Tabela për planin kohor të aksionit (Shtojca nr. 2)
- Letër paketimi (për secilin grup nga një)

---

## **PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE**

### **Hapi parë**

(Kohëzgjatja: 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e nis orën duke paralajmëruar se një nga mënyrat e promovimit të aksionit lokal opinionit të gjerë është **prezantimi publik i aksionit të planifikuar**. Në këtë mënyrë, projektet e nxënësve mund t'u prezantohen para se gjithash grupeve të interesuara të cilat mund të ndihmojnë në realizimin e aksionit. Prezantimi publik paraqet hap të rëndësishëm në sigurimin e mbështetjes për secilin projekt. Pikërisht objektivi i këtij projekti është që t'u ndihmohet nxënësve që ta përgatisin më mirë këtë ngjarje.

### **Hapi dytë**

(Kohëzgjatja: 40 minuta)

Nxënësit me ndihmën e mësimdhënësit/mësimdhënësës e nisin planifikimin e prezantimit publik. Gjatë përgatitjes është me rëndësi të shfaqet kujdes mbi këto aktivitete: Mësimdhënësi/mësimdhënësja thekson se planifikimin e prezantimit publik duhet ta fillojmë duke përgatitur **planin e aktiviteteve lidhur me organizimin** e kësaj ngjarje. Përgatitjet nënkuptojnë sa vijon:

#### **a. . përzgjedhja e grupeve të fokusit të cilat do të thirren në prezantim publik**

Në bazë të analizës së mjedisit, nxënësit duhet të marrin vendimin se kë do ta thërrasin në prezantim dhe në harmoni me këtë dhe ta sajojnë prezantimin.

#### **b. sajimi i promovimit të prezantimit publik**

Nxënësit duhet ta sajojnë promovimin e kësaj ngjarje para se gjithash duke shfrytëzuar dijeninë mbi atë si të komunikohet me opinionin. Kujdes të veçantë duhet kushtuar mënyrës së thirrjes së secilit nga grupet e identifikuar të interesuara (me ftesë, kontakte personale, pllakate, fletëpalosje etj.). Mësimdhënësi/mësimdhënësja i fton nxënësit që t'i shfrytëzojnë

shtojcat që i kanë marrë në orën “Planifikimi i aksionit lokal- sajimi i mesazhit dhe përzgjedhja e kanalit të komunikimit”.

### **c. përgatitja e prezantimit të projektit**

Nxënësit lypset ta formulojnë (se në çfarë mënyre do ta prezantojnë projektin e vet. Prezantimi i projektit duhet të jetë i përgatitur që t’i përfitojë përfaqësuesit e grupeve të interesuara për ndihmë në realizimin e projektit. Nga prezantimi varet edhe suksesi i sigurimit të mjeteve të domosdoshme dhe të mbështetjes. Nxënësit duhet të tregojnë kujdes mbi këtë:

- se ngjarja përbëhet nga prezantimi i projektit dhe diskutimi pas rezantimit
- se për prezantim duhet zgjedhur personi që ka shkathtësi të mira prezantuese dhe i cili e zotëron shkëlqyeshëm temën/problemin
- se duhet zgjedhur personin i cili do ta drejtojë ngjarjen dhe diskutimin pas prezantimit
- se duhen caktuar qartë objektivat e prezantimit
- se duhet planifikuar kohëzgjatja e prezantimit (jo më gjatë se 20 minuta) dhe të lihet kohë për diskutim dhe pyetjet e nxënësve
- se duhen shfrytëzuar mjete të ndryshme teknike, të cilat e bëjnë prezantimin atraktiv dhe e mbajnë vëmendjen e pjesëmarrësve

### **ç. Përgatitja e planit të aktiviteteve lidhur me organizimin e prezantimit publik**

Nxënësit i planifikojnë aktivitetet lidhur me organizimin e ngjarjes duke filluar nga sigurimi i lokalit për prezantim, përgatitja e atij lokali, sigurimi i materialit, tingëlluesve, freskime, etj. Mësimdhënësi/mësimdhënësja përgatit letrën e madhe të paketimit në të cilën vizatohet Tabela për planin kohor të aksionit (Shtojca nr. 2) dhe në të cilën nxënësit i shkruajnë detyrat e dakorduara, personat përgjegjës dhe planin kohor.

#### **Vërejte:**

Është e mundshme që puna e përgatitjes së prezantimit publik kërkon më shumë se një orë . Në këtë rast me ndihmën e mësimdhënësit/ mësimdhënësës, nxënësit vazhdojnë përgatitjen edhe jashtë kësaj ore.

<b>Punëtorja: PLANIFIKIMI I AKSIONIT LOKAL – prezantimi publik në shkollë</b>
---

**OBJEKTIVI:**

Objektivi i kësaj punëtorie është që nxënësit t'ia prezantojnë opinionit planet e aksioneve lokale dhe në atë mënyrë të sigurojnë mbështetjen për aktivitetet e veta.

**DETYRAT:**

- Prezantimi i projektit të nxënësve
- Sigurimi i mbështetjes për realizimin e aksionit lokal

**Materiali për punë:**

- Materiali i përgatitur për prezantim

---

**PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:**

Kjo orë është parashikuar për zbatimin e prezantimit publik në shkollë.

## Ora përfundimtare: ÇFARË BART ME VETE

### OBJEKTIVI:

Objektivi i kësaj punëtorie të fundit është që nxënësve t'u ofrohet rasti të vlerësojnë programin si tërësi dhe të këmbëjnë përvojat e veta për përcjelljen e këtij programi.

### DETYRAT:

- këmbimi i mendimit mbi orët e Edukatës qytetare dhe efektet e tyre
- këmbimi i mendimeve mbi përvojat personale në Edukatën qytetare
- ofrimi i mbështetjes reciproke

### Materiali për punë:

- Letrat e formatit A 3 për secilin nxënës
- Pyetësi (Shtojca nr. 1)
- Letrat e formatit A 4 për secilin nxënës
- Ngjyrat, stilolapsat
- Shiritat ngjites

---

### PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE:

#### Hapi parë:

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Secili nxënës duhet t'i kujtojë më parë të gjitha temat dhe aktivitetet me të cilat është njohur gjatë këtij viti shkollor në lëndën Edukata qytetare dhe t'i shënojë në letër.

Secili pjesëmarrës pastaj e merr letrën e formatit A 3, në të e vizaton trastën e madhe. Secili në trastën e vet e shkruan ose e vizaton diçka nga dijenia dhe shkathtësia për të cilën i duket se në të ardhmen do të jetë e dobishme. Në secilën pjesë (dijenja dhe shkathtësia) të futura në trastë, nevojitet që në formë të etiketës të shënojë në cilat situata dhe në çfarë mënyre mendojnë ta përdorin.

#### Vërejte:

Mësimdhënësi/mësimdhënësja gjithashtu merr pjesë në këtë aktivitet dhe në trastën e vet "paketon" dijenitë dhe shkathtësitë, të cilat sipas tij janë domethënëse për qytetarin aktiv.

#### Hapi dytë

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Disa nxënës e tregojnë përmbajtjen e trastës së vet, pastaj të tjerët shtojnë elemente të reja, në qoftë se ka në trastat e tyre. Nxënësit raportojnë si do t'i shfrytëzojnë "sendet" e marra dhe bisedohet për destinimet tjera të mundshme.

#### Hapi tretë

(Kohëzgjatja: 15 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja ua shpërndan nxënësve pyetësin e shkurtër mbi programin (Shtojca nr. 1). Nxënësit, secili për vete, e plotësojnë pyetësin dhe ia kthejnë mësimdhënësit/mësimdhënësës.

### **Hapi katërt**

(Kohëzgjatja: 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja të gjithë nxënësve ua ngjit në shpinë letrën boshe të formatit A4. Pastaj ua ndan stilolapsat dhe u thotë se me këto letra duhet tu shkruajnë diçka të mirë shokëve dhe shoqëve të tyre, diçka që e çmojnë tek ata, diçka që u pëlqen e që deri më tani nuk kanë pasur rastin t'ua thonë. Është me rëndësi t'u thuhet nxënësve të mundohen, që të gjithë mesveti të shkruajnë dhe të marrin mesazhe. Nxënësit nuk duhet të nënshkruhen në mesazh por nevojitet që kohë pas kohe dhe të ndërrohen stilolapsat në mënyrë që autorët e mesazheve të mos njihen sipas ngjyrës së stilolapsit.

#### **Vërejte:**

Edhe në këtë aktivitet merr pjesë aktivisht Mësimdhënësi/mësimdhënësja.

Kur mësimdhënësi/mësimdhënësja vlerëson se të gjithë i kanë këmbyer mesazhet, e ndërpret këtë aktivitet. Nxënësve u thotë se mund t'i heqin letrat dhe të lexojnë çfarë gjendet në to.

Në fund të orës duhet cekur se këto mesazhe të bukura në letër njëherësh janë dhuratë dhe kujtim nga orët e Edukatës qytetare që i kanë kaluar bashkë.



## Shtojca nr. 1

<b>Pyetësi</b>
Çfarë u ka pëlqyer veçanërisht në orët e Edukatës qytetare?
A do të donit që diçka të ishte më ndryshe dhe çfarë?
Çfarë veçoni si përfitimin tuaj më të madh?
Sikur të kishit rastin që lëndën ta përshkruani me një fjali, si do ta përshkruanit?

Botues  
Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Serbisë

Për botuesin  
Dr Zharko Obradoviq, ministër

Udhërrëfyesin për mësimdhënës e kanë përgatitur dhe përshtatur për programin mësimor të Edukatës qytetare:

Prof. dr Dragan Popadiq  
Prof. Dr Ilija Vujaçiq  
mr Danijela Petroviq  
Milenko Dereta  
Zagorka Aksentijeviq  
Radmilla Goshoviq  
Marija Rudiq  
Tanja Azanjac  
Natasha Gjuriçiq  
Vera Ociq

Doracaku është përgatitur në bashkëpunim me Inicativat Qytetare

Doracaku në gjuhën serbe është botuar në vitin 2004. nën patronatin e Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, përkthimi në gjuhën shqipe është botuar në vitin 2011, nën patronatin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës

Përkthyes në shqip  
Fahri Musliu

Lektore  
Alma Lama

Thyerja  
Malisha Vuçkoviq

ISBN978-86-7408-051-1

Përkthimin e këtij publikimi e ka financuar, nëpërmjet grantit që ua ka ndarë Inicativace Qytetare, Ministria e Punëve të Jashtme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Mendimet, qëndrimet dhe përfundimet në këtë publikim, janë paraqitur nga ana e autorëve dhe detyrimisht nuk e pasqyrojnë mendimin e Ministrisë së Jashtme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.